ISSN 2308-6106

AUDITIMI PUBLIK

KLSH

KËRKIMORE

SHKENCORE

INFORMATIVE

REVISTË 4-MUJORE Nr. 21

2019

ALSAI

EUROSAI

INTOSAI

Seria : botime KLSH - 02/2019/104

Tiranë, 2019

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Experentia mutua omnibus prodest

AUDITIMI PUBLIK

REVISTË 4 -MUJORE

kërkimore-shkencore-informative

shqip-anglisht

Nr. 21 /2019, Tiranë

ISSN 2308-6106

Viti i VIII-të i botimit 2019

Shtator - Dhjetor 2018

Seria: botime KLSH - 02/2019/104

Titulli:

Revistë 4- Mujore

Auditimi Publik Nr. 21

Redaktore:

Irena Islami

Amantja Patozi

Art Design:

Elisa Metaj

Seria: botime KLSH - 02/2019/104

Shtypur në ”Jupiter Group”

Tiranë 2019

ALBANIAN SUPREME AUDIT INSTITUTION

Experentia mutua omnibus prodest

PUBLIC AUDIT

Every four Month Magazine
of research, science and information
in Albanian and in English

No. 21/2019, Tirana
ISSN 2308-6106
September - December 2018
Series: Publications ALSAI - 02/2019/104

BORDI SHKENCOR

Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH	Kryetar
Prof. Dr. Omer Stringa Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Dhori Kule, Dekan, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Jorgji Bollano, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve	Anëtar
Prof.Dr. Skënder Osmani, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Anëtar
Prof. Dr. Ardian Nuni, Fakulteti i Drejtësisë	Anëtar
Prof. Dr. Sotiraq Dhamo, Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit FE (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Akademik, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Argita Berisha, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Lindita Lati, ZV/Kryetare, KLSH	Anëtar
Prof. Dr. Heinz-Dieter Wenzel, Profesor, Universiteti i Bambergut, Gjermani	Anëtar
Dr. Igor Soltes, ish-President i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë	Anëtar
Dr. Sang M. Lee, Universiteti i Nebraskës, SHBA	Anëtar
Prof. Dr. Tonin Kola, Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. As. Dr. Sazan Guri, Instituti " G& G Group"	Anëtar
Prof.As. Dr. Manjola Naço, Drejtore e Përgjithshme, KLSH	Anëtar
Prof.As.Dr. CPA Hysen Çela, Kryetar i IEKA**,** Managing Partner,nH EuroConsult	Anëtar
Prof. As.Dr. Flutura Kola, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar

SEKRETARIATI

Irena Islami	Sekretare Kolegjiumi

Adresa e redaksisë

Kontrolli i Lartë i Shtetit, Rruga "Abdi Toptani"nr. 1,

I NDERUAR LEXUES !

Numri i 21-të i Revistës Kërkimore shkencore të KLSH-së është botimi i dytë për vitin 2019 dhe i 104-t i kolanës së botimeve të KLSH-së.

Në këtë numër të Revistës kanë kontribuar me shkrimet e tyre Dr.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së, Prof.Dr.Skënder Osmani, Kryeauditueja Valbona Gaxha, etj. Gjithashtu janë prezent me intervistat dhe shkrimet e tyre personalitete të auditimit të jashtëm publik si z.Klaus-Heiner Lehne, President i ECA, drejtues të ECA dhe të INTOSAI-t, etj. Në këtë numër të revistës mund të gjeni dhe shkrime me interes të revistave evropiane të fushës së auditimit, etj.

Janë të ftuar të publikojnë punimet dhe opinionet e tyre kontabilistë, financierë, ekonomistë të përgjithshëm, specialistë të enteve publike dhe private, akademikë, ekspertë të shoqërisë civile, profesionistë të pavarur si dhe çdo i interesuar që gjen me vend trajtimin e një çështjeje të caktuar me interes në auditimin dhe vlerësimin e administrimit publik të vendit, bazuar në moton e INTOSAI *"Experentia mutua omnibus prodest (Eksperienca e Përbashkët ju shërben të gjithëve)".*

Bordi Shkencor i Revistës ju fton të shprehni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në funksion të përmirësimit, të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të saj me qëllim që kjo Revistë Shkencore, të jetë një mundësi më shumë për zhvillimin e debatit në fushën e auditimit dhe më gjerë.

Adresa e redaksisë

Kontrolli i Lartë i Shtetit, Rruga "Abdi Toptani"nr. 1,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: revista@klsh.org.al, klsh@klsh.org.al

PËRMBAJTJA

TITULLI	AUTORI	FAQE
Strategjia kombëtare, sfidë e madhe gjithëpërfshirëse dhe komplekse. Dijet dhe burimet në epiqendër të strategjisë	Prof.Dr.Skënder Osmani Dr.Bujar Leskaj Kryetar, KLSH	**11**
Riorganizimi i sektorit publik në Shqipëri- Çfarë mungoi!?	Valbona Gaxha, Kryeauditueseë KLSH	**19**
Bashkëpunimi funksionon më mirë kur është i dobishme për palët	Intervistë me z.Klaus- Heiner Lehne, President, ECA. Nga Gaston MOONEN, Drejtoria e Presidencës, ECA. *ECA Journal Nr.11, Nëntor/Dhjetor 2018*	**31**
Auditimi i SDG-ve: Sfidat dhe Mundesitë për SAI-t Roli i INTOSAI-t në mbështetjen e SAI-ve për implementimin e SDGs	Gjykata Austriake e Auditimit. Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t. *Revista e EUROSAI-t*	**37**
Qëndra e GAO-s për Ekselencën në Auditim ndërton në mbarë botën kapacitetet për mirëqeverisjen	*INTOSAI Journal,* Dimër 2018	**41**
Auditimi i performancës, si pjesëmarrje e qytetarëve në auditimet e KLSH	Sali Agaj Redi Ametllari KLSH *INTOSAI Journal,* Dimër 2018	**47**

SIGMA mbështet institucionet publike drejt anëtarësimit në BE	Bianca BRETECHE Programi SIGMA ,OECD. *ECA Journal Nr.08-09, Gusht/Shtator2018*	**51**
Auditimi Publik në Bashkimin Europian Një manual në proces hartimi	Derek Meijers Drejtoria e Presidencës, ECA. *Revista e EUROSAI-t*	**55**
Parashikimi për transportin dhe lëvizshmërinë: forcat, faktorët dhe sfidat e së ardhmes	Andreas Bolkart Drejtoria e Presidencës, ECA. *ECA Journal Nr.1/2019*	**59**
Info nga vendi	Aktivitete të KLSH-së (Shtator 2018 - Shkurt 2019)	**65**
Zyra e Kontrollit të Përgjithshëm të Republikës së Kilit	Profil	**133**
Zyra Shtetërore e Llogaridhënies së Egjiptit	Profil	**135**

TABLE OF CONTENTS

Title	AUTHOR	PAGE
National strategy, a huge, inclusive and complex challenge. Knowledge and resources in the epicentre of the strategy	Prof. Dr. Skënder OSMANI Dr. Bujar LESKAJ Chairman, AL-SAI	**139**
Reorganizations in Albanian public sector– What was missed!?	Valbona GAXHA AL-SAI	**147**
Cooperation Works best if beneficial to both parties	Interview with Klaus- Heiner Lehne, ECA President. By Gaston MOONEN, Directorate of the Presidency, ECA. *ECA Journal No.11, November-December 2018*	**159**
Auditing the SDGs: Challenges and opportunities for SAIs	Austrian Court of Audit General Secretariat of INTOSAI *EUROSAI Magazine*	**165**
GAO center for Audit Excellence builds Worldwide Capacity, Good Governance	*INTOSAI Journal, Winter 2018*	**169**

Performance Audit to communicate, Incorporate, better serve Stakeholders	Sali Agaj Redi Ametllari AL-SAI *INTOSAI Journal, Winter 2018*	**173**
SIGMA fostering strong public institution towards EU membership	Bianca BRETECHE SIGMA Programme at the OECD. *ECA Journal No.08-09, August/September 2018*	**177**
Public Audit in the European Union- A book in the making	Derek Meijers Directorate of Presidency of the European Court of Auditors. *EUROSAI Magazine*	**181**
Foresight for transport and mobility: force, factors and future challenges	Andreas Bolkart Directorate of Presidency of the European Court of Auditors. *ECA Journal No.1/2019*	**185**
Events and activities of ALSAI during September 2018- February 2019	INFO	**191**
The General Comptroller of Republic of Chile	Profile	**253**
The accountability State Audit Authority of Egypt	Profile	**255**

STRATEGJIA KOMBËTARE, SFIDË E MADHE GJITHËPËRFSHIRËSE DHE KOMPLEKSE. DIJET DHE BURIMET NË EPIQENDËR TË STRATEGJISË

Në strategji, të gjitha burimet janë të lidhura dhe bashkëveprojnë. Lidhjet e tyre kanë struktura të ndryshme(kategori matematike) dhe u nënshtrohen ligjeve shkencore të ndryshimit (burime që proçesohen: energji, minerale, informacione dhe burime që proçesojnë: teknologji, teori, metoda, etj).

Nga: Prof.Dr.Skënder Osmani

Dr.Bujar Leskaj, Kryetar, KLSH

Në vitet e fundit, jeta ka shfaqur një sërë problemesh të qënësishme projektimi në shumë fusha, siç janë reforma e arsimit të lartë, e ndarjes administrative, projektet e infrastrukturës, rruga e Kombit, Tiranë – Elbasan, rruga e Arbërit, po kështu ato të përmbytjeve në zonën e veriut, të partneritetit publik-privat, sektorit të shëndetësisë, etj. Përmendim gjithashtu që ka patur jo pak raste të projekteve pa alternativa, optimizim, vlerësim sigurie.

Siç dihet, zbatimi i strategjisë kombëtare është tërësia e projekteve strategjike që zbatohen në një kohë të caktuar. Që këtej, del se dobësitë, mangësitë, risqet, etj, të shfaqura në projekte, e kanë zanafillën në strategjinë e zhvillimit të sektorit përkatës, në të dhënat, metodat e instrumentat e përdorura, alternativat, etj. Për shembull, nga kërkesat e lëvizjes studentore, del menjëherë në pah që projekti i zhvillimit të arsimit të lartë ka patur të meta serioze, të paktën në parashikimin dhe vlerësimin e treguesve themelorë të tij, të burimeve njerëzore, financiare, burimeve të informacionit,etj.

Po kështu, edhe në projekte të tjera ka patur dobësi në zbatimin e metodave të përparuara, që fillojnë nga përgatitja e bazës së të dhënave, seleksionimit e përpunimit të tyre apo strukturës së reformave, nënstrategjive të përdorura, etj. Në punimin *"Performanca, sistemi, risku dhe vendimmarrja fazi në grup me shumë kritere",* botuar në një nga numrat e Revistës Shkencore *"Auditimi Publik ",* reforma e arsimit të lartë është cilësuar si veprimtari me risk të madh.

Në qoftë se, me marrëveshje, ***të gjitha objektet që marrin pjesë në një strategji i konsiderojmë burime*** (p.sh. energjia, burimet minerale, tekonologjia, metodat, etj), del që strategjia është konstruksion mendor i ndryshimit të burimeve të "shportës kombëtare". E thënë pak më ndryshe, strategjia, si bashkësi

alternativash të mundshme që realizojnë objektiva dhe qëllime të caktuara nga sektorë të ndryshëm, është *masa e ndryshimit të burimeve të "shportës kombëtare" në një kohë të caktuar.*

Shprehja "*bashkësia e të gjitha alternativave të mundshme*" tregon që strategjia ka karakter gjithëpërfshirës, pra për hartimin e strategjisë, diskutimin e objektivave të saj, etj, janë të interesuara të gjitha shtresat e popullsisë që janë të afta për të punuar. Shkurt, strategjia është objekt interesi për një masë të madhe të popoullatës.

Në strategji, të gjitha burimet janë të lidhura dhe bashkëveprojnë. Lidhjet e tyre kanë struktura të ndryshme(kategori matematike) dhe u nënshtrohen ligjeve shkencore të ndryshimit (burime që proçesohen:burime energji, minerale etj.,informacione dhe burime që proçesojnë: teknologji, teori, metoda, etj). Pra, kuptimi i fjalëve kyçe, burim, teknologji, strukturë, teori, bashkëveprim, kategori, ndryshim, model, proces, etj., dhe pohimet përkatëse logjike, matematike, fizike, menaxhim burimesh, projekti, informacioni, etj, që mbështeten në to, janë komplekse ose shumë komplekse.

Përmendim kalimthi që, në kushtet ekzistuese, objektivat e zhvillimit shkencor në strategjinë që do të hartohet, kanë një natyrë më të vështirë se në të gjitha strategjitë e hartuara më parë e për këtë mjafton të kihen parasysh objektivat shkencore të strategjisë, kërkesat për natyrën e të dhënave, strukturat e tyre dhe të algoritmave optimalë, risku i projekteve, kërkesat e BE-së në fushën e bashkëpunimit dhe të vlerësimit të projekteve, përfshi këtu natyrshëm edhe ato të strategjive të reformave eventuale.

Në vijim, po bëjmë një marrëveshje tjetër që ka të bëjë me zbatimin e strategjisë: alternativën që realizon me më të mirën e mundshme sigurinë dhe përmbajtjen e kërkuar, të cilën e quajmë projekt zbatimi. Kësisoj, strategjia ngërthen dy projekte, atë të hartimit dhe atë të zbatimit. Shkurt, strategjia është projekt dhe, si i tillë, duhet t'i përgjigjet pyetjeve dhe kërkesave që bëjnë "baballarët e menaxhimit", si p.sh., çfarë është aktiviteti, kush e bën atë, pse e bën atë, si e bën atë, kur e bën atë, etj.

Po kështu, duhet t'i pergjigjet edhe nënvarianteve të pyetjeve të mësipërme, p.sh. a) sa burime që proçesohen: burime njerëzore, nëntokësore, energjie, nafte, etj, ose b) sa burime që proçesojnë: teknologji, teori, metoda, instrumente, pajisje, etj. Në këtë kontekst, po të analizosh të paktën studimet e fizibilitetit të reformave (p.sh. ndarjen administrative) rezultojnë të meta që fillojnë nga të dhënat për çdo qark (siguria e tyre, etj), pa përmendur teknologjitë që kanë përdorur më parë vende të huaja që kanë zbatuar këto reforma. Të paktën nga përvoja jonë, rezulton që, në përgjithësi, sigurimi i të dhënave dhe i informacionit të domosdoshëm në shumë projekte ka qenë dhe mbetet një nga problemet e dorës së parë në hartimin dhe zbatimin me sukses të tyre.

Në përfundim të zbatimit të një strategjie kombëtare ngrihet pyetja: cilët ishin faktorët negativë të strategjisë që çuan në mospërputhje të realizimit të objektivave

me parashikimin e tyre? Këtu menjëherë të shkon mendja tek faktori njeri, përgatitja profesionale, shkencore e stafit të strategjisë dhe tek pritja matematikore e vogël dhe në përgjithësi e kulturës së shtresave të ndryshme të popullatës që morën pjesë në hartimin e strategjisë dhe zbatimin e saj në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë, si arsim, burime energjie, minerale, mjedisore, teknologji informacioni, ICT, metoda e teori optimizimi, risku. Pra, risku themelor i një strategjie i takon njeriut, jo vetëm si subjekt, por edhe si objekt, pak më ndryshe e në rradhë të parë stafit të përgatitjes së objektivave, hartimit e zbatimit të strategjisë dhe projekteve përkatese.

Duke patur parasysh që jemi në vigjilie të pranimit të mundshëm si vend kandidat për anëtar të BE, përpara strategjisë së re kombëtare dalin edhe shumë detyra të tjera, që janë objekt i institucioneve të specializuara, madje edhe i atyre që mund të ngrihen, apo edhe i bashkëpunimit me institucione nga shtete të tjera europiane. Në kuadrin e një bashkëpunimi të mundshëm me institucionet e BE, po përmendim sistemin SWOT, i cili ka 4 fjalë kyçe: *forcë* (strength), *dobësi* (weakness), *alternativë* (opportunity) dhe *kanosje* (threats). Historikisht ky sistem është zbatuar në sektorin e marketingut, kur më pas ai u fut si domosdoshmëri në çdo sektor prodhues (projekt) të Komunitetit Europian.

Lind pyetja: ç'do të thotë SWOT, cila është përmbajtja e tij në një sistem, në të cilin ai operon (p.sh. arsim, industri, shëndetësi, etj)?

Forcë (fuqi) do të thotë të jemi të vëmendshëm që sistemi ku operon SWOT të përdoret në mënyrën më të mirë të mundshme.

Dobësi do të thotë të kalohet çdo dobësi e mundshme e sistemit.

Oportunitet do të thotë nevojë për të rritur fuqinë e sistemit, në të cilin ai operon, dhe për të zvogëluar dobësitë e identifikuara, shkurt seleksionimi i alternativave më të përshtatshme.

Kanosje do të thotë që, kudo dhe kurdoherë të zvogëlohen në sistem sa të jetë e mundur faktorët e riskut, me qëllim që ata të mos rrezikojnë sistemin, e aq më pak ta shkatërrojnë atë.

Siç vërehet, SWOT është një skaner i çdo aktiviteti në fushën e optimizimit, për të rritur forcën e sistemit dhe për të zvogëluar sa të jetë e mundur dobësitë (risqet, etj.).

Pak më ndryshe, SWOT, në sistemin (aktivitetin) ku operon, mendojmë se ka dy kërkesa të forta (të heshtura, të pashtjelluara) për çdo aktivitet, që janë *optimizimi* dhe *risku*. Nga një pikëpamje, sipas SWOT, *kemi pika të forta dhe pika të dobëta.*

Përmendim që, në Fakultetin Gjeologji Miniera (F.Gj.M) dhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH) janë bërë përpjekje për optimizimin e aktiviteteve dhe zvogëlimin e riskut (kurikula, studime, artikuj, kurse të veçanta, etj.). Kësisoj në projektin e vendburimit Gorisht (viti 1975-1980) për problemin e optimizimit dhe riskut janë analizuar 13 alternativa. Në KLSH janë organizuar konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, janë botuar artikuj,etj. Në

F.Gj.M, prej dhjetë vitesh, është hapur dhe ka funksionuar specialiteti i menaxhimit, kurikula e të cilit ka përfshirë riskun e burimet e proçeseve, teknologjitë, procedura të përparuara, etj. Gjithashtu, në KLSH është hapur një kurs i përkohshëm në fushën e riskut, jane organizuar konferenca për riskun, etj.

Në kushtet aktuale të vendit, ne mendojmë që hartimi i strategjisë së re kombëtare duhet të përshpejtohet jo vetëm nga përmbajtja e saj (që ndryshon mjaft nga strategjia e sotme në zbatim), por edhe nga faktorë të tjerë, si më poshtë:

- pranimi si vend kandidat për anëtar në BE (përmbajtja e marrëdhënieve të bashkëpunimit në çdo aktivitet, projekt, strategji, etj.)
- afati i përfundimit të strategjisë ekzistuese, që është deri në vitin 2020. Kesisoj përvoja e vendit tonë dhe e shumë vendeve të tjerë tregon se periudha për përgatitjen e strategjisë së re, deri në miratimin përfundimtar, konsumon një periudhë 2-3 vjeçare, gjë që tregon se duhet të fillojë hartimi i strategjisë së re.

Por natyrisht ka edhe faktorë të tjerë që mund ta sforcojnë këtë përshpejtim e që në rradhë të parë, kur konsiderohen, janë përgjegjësi e institucioneve përkatëse. E në këtë mes mund të kihet parasysh edhe përvoja e vendeve të huaja.

Kesisoj përmendim kalimthi që, ka strategji kombëtare të vendeve anëtare të BE që janë hartuar 3 vite përpara miratimit të tekstit përfundimtar nga legjislativi përkatës, madje përpara saj, ka patur raste që janë hartuar edhe nënstrategji të reja (dixhitale), me qëllim që t'i vihet në ndihmë strategjisë kombëtare; apo vende të tjera që përpara hartimit të strategjisë kombëtare kanë ngritur institucione të veçanta për t'i ardhur në ndihmë strategjisë kombëtare. I përmendim këto fakte, pasi ndoshta duhet të mendojmë edhe për investime suplementare që do të kërkojë strategjia e re, veçanërisht në kualifikim, metoda, teknologji, procedura, sigurim të burimeve dhe bazave të të dhënave, programe eventuale, etj.Dhe në këtë aspekt mund të bëhen edhe studime për raportin e investimeve shkencore dhe zvogëlimit të riskut prej tyre, pak më ndryshe ndërmjet dijeve me nivel të lartë dhe optimalitetit dhe riskut nga ana tjeter.

Në këtë kontekst, mendojmë se strategjia e re do të përmbajë dy nënstrategji themelore (atë vendore dhe atë të bashkëpunimit me BE) dhe që në kushtet ekzistuese strategjia do të jetë sfidë e madhe për të ndryshuar vendin nga një stad i prapambetur në të përparuar. Kjo sfidë do të jetë cilësore, duke patur parasysh treguesit aktualë në shumë sektorë të ekonomisë, veçanërisht në fushën e arsimit të lartë, burimeve, kërkimit, studimit e zhvillimit shkencor; po kështu "ku duhet të arrijmë", "si duhet të arrijmë" e të tjera pyetje menaxheriale.

Natyrisht, kërkohen studime të thelluara nga ekipet përkatës me bazë institucione, departamente, universitete, institucione akademike, të qeverisjes qendrore e lokale dhe instituteve të tjera. Kemi mendimin që, në dallim nga strategjitë ekzistuese, hartimi i strategjisë së re të bëhet në

struktura me ***bazë projekti*** (p.sh. arsimi i lartë, burimet, energjia e sigurimi i tyre) e jo mbi bazë treguesish të përgjithshëm ekonomiko-shoqerorë, sepse projektet (me strategjitë e tyre) puqen më mirë me kërkesat e optimizimit, riskut e, në përgjithësi, me ato të SWOT, sepse analiza e treguesve të strategjisë mbi baza treguesish të përgjithshëm teknikë ekonomikë, shoqërore, etj është e vështirë, të paktën analitikisht, sepse kërkon që "të bredhësh" nga proçesi në proçes specifik, kur vetë burimet kanë natyrë të ndryshme burimore.Në këtë kontekst, psh meqënëse specifikat teknologjike, makroekonomike, etj., të veçuara e vështirësojnë së tepërmi strategjinë e re që hartohet mbi bazën e tyre, mendojme se strategjia duhet të hartohet mbi bazën e burimeve.

Në këtë vështrim është gjendja ekzistuese e burimeve njerëzore, natyrore, energjitike, minerale, mjedisore, etj, e teknologjive të ndryshimit, e përpunimit të burimeve, veçanërisht në fushën e arsimit të lartë, të studimit e kërkim-zhvillimit në përgjithësi, të metodave e procedurave shkencore rigoroze me bazë matematike, informatike, shkenca kompjuterike, teknologji dixhitale, si dhe të teorive bashkëkohore në fushën e menaxhimit të projekteve, veçanërisht ato të dy dekadave të fundit, që akoma nuk janë dukur në auditoret tona të nivelit pasuniversitar, është një nga çështjet e para te strategjisë së re që duhet të formulohet e drejtohet në nivel qeveritar.

Kemi mendimin që, hartimi i strategjisë së re do të zvogëlojë në përgjithësi riskun kombëtar dhe në veçanti riskun politik, sepse një strategji shkencore do të bëjë që, disa parime themelore kardinale të zhvillimit, ne disa projekte (politikat) psh në fushën e arsimit, burimeve, teknologjisë, mjedisit, do të jenë ***standarte të paprekshme*** për diskutim politik në Kuvendin e Shqipërisë apo edhe jashtë tij. Kësisoj, politika e deritanishme, pavarësisht nga partia në pushtet ose jo, do të kthehet më tepër nga zhvillimi me projekte e alternativa se sa me diskutime të zgjatura. Në këtë drejtim, ka shumë përvoja që mund e duhet të merren, p.sh. tërë vendet skandinave, duke filluar nga viti 2001, kanë një strategji të përbashkët, gjë që do të thotë që, disa parime themelore të kësaj strategjie janë tabu (të paprekshme) nga politikat e ndryshme të shteteve dhe që mund të zbatohen njëherë e përgjithmonë, si të pavarura nga kërkesat e partive të ndryshme apo programet politike të tyre. Po kështu, ekipi i hartimit të një strategjie 20-30 vjeçare, në një vend te caktuar të BE-së, me ligj nuk ndryshon (me përjashtime natyrale) deri në përfundimin e saj, pavarësisht se, gjatë periudhës në fjalë, në pushtet kanë ardhur parti të ndryshme ose disa të tjera janë larguar.

Ne mendojmë, gjithashtu, që nënstrategjia e arsimit të lartë dhe i kërkim-zhvillimit duhet të jetë fokusi themelor i strategjisë së ardhshme, me shtrirje e veprim edhe në shumë strategji të tjera, madje ndoshta edhe me zë të veçantë në Buxhetin e Shtetit për rritjen e vazhdueshme të pjesës së produktit kombëtar, që i takon, sepse ka ardhur koha të vendosim sa më shpejt e më mirë për përgjigjen e pyetjes: më mirë vezën sot apo pulën mot? (më mirë të dish

apo të kesh?). Koha po tregon, dhe më shumë do të tregojë, për gabimet që kemi bërë në të shkuarën, sidomos në strategjitë e kaluara ne vite e dekada.

Duke patur parasysh që Strategjia kombëtare, është sfidë e madhe gjithëpërfshirëse dhe komplekse, mendojmë që në gjashtë mujorin e parë të këtij viti, mund të bëhen përpjekjet për përcaktimin e objektivave të strategjisë së re e diskutimin me qytetarët e më pas dhe ato të strukturave të hartimit të nënstrategjive dhe projekteve. Po kështu, meqenese nënstrategjia me BE do të ngërthejë edhe shumë objekte të vështirë për t'u realizuar, puna në këtë drejtim mund të fillojë me parë se të fillojë hartimi i strategjisë kombëtare. P.sh. strategjia kombëtare e Rumanise për 20 vitet në vazhdim, është paraprirë nga një nënstrategji dixhitale që ka filluar te operojë që në vitin 2014 në disa objektiva të caktuara në teknologji, kualifikim stafi, metoda të reja e të përparuara, etj. Estonia, 3-4 vite përpara se të pranohej si vend kandidat për anëtar në BE, ka ndërmarrë krijimin e 3-4 institucioneve të reja, etj.

Nga sa më sipër, hartimi i strategjisë kombëtare përballet me dy nënstrategji themelore, që janë vetë strategjia me objektiva pa BE dhe nënstrategjia e objektivave qe cakton BE. Për të mënjanuar ndonjë konfuzion në këtë shkrim, këto dy nënstrategji i quajmë nënstrategji vendi dhe nënstrategji me BE. Theksojmë që nënstrategjia me BE supozohet se përfshihet në nënstrategjinë e vendit, pra bën pjesë në strategjinë kombëtare. Përmendim kalimthi që, ka strategji të vendeve të caktuara, të cilat përfshihen edhe nga nënstrategji të tjera, si reforma ose aktivitete, që ishin parashikuar më parë, por që nuk janë realizuar, prandaj pjesa e mbetur e tyre vazhdon me strategjinë e re.

Në kushtet e vendit tonë, kur kemi mungesa të instituteve shkencore për ekonominë, biznesin, etj, ndoshta mund të ngrihet mendim që departamentet universitare në disa shkolla të larta të jenë mbështetje kryesore apo themelore e hartimit të strategjive, sepse aktualisht, ato kanë, përgjithësisht, nivelin më të lartë të dijeve, të studimit, kërkimit e zhvillimit të metodave e teorive bashkëkohore. Përveç kësaj, ato kanë një potencial universitar dhe pasuniversitar, të përgatitur më parë, që mund e duhet të shfrytëzohet direkt në rrethana të caktuara ose edhe të fillojë puna, në rast se shikohet e arsyeshme, për ngritjen dhe kualifikimin e stafit menaxherial, strategjik e projektues me forca të brendshme universitare ose dhe te huaja nga intitucione europiane.

Duke qenë se risku i projektit të strategjisë është përafërsisht shumë (integrale) e të gjithë risqeve specifike të projekteve nga të gjithë sektorët e zhvillimit, rezulton qe ka peshë të rëndë në prapambetjen që shkakton. Për rrjedhim, kualifikimi i stafit, sigurimi i teknologjive përkatëse, futja e metodave të reja për menjanimin ose zvogëlimin e riskut, duke filluar nga sigurimi i të dhënave, seleksionimi, trajnimi e bashkërendimi shkencor për metoda e struktura të reja teorike, teknologjike, aplikative, etj , që janë nga disa drejtime themelore, ku duhet e mund të rritet pesha

e investimeve të reja në fushën e strategjisë.

Në fund, theksojmë që, ***aktiviteti i strategjisë, në kushtet e vendit tonë, është një nga më të rëndësishmit në fushën e investimeve, që ka efektivitetin më të lartë***.

Që këtej, dijet dhe burimet duhet të jenë epiqendra e strategjisë së re.Natyrisht pergjigje presin edhe shume pyetje për çështje parimore, të përgjitheshme :

Psh, kush duhet ta përgatisë hartimin e strategjisë?

Ka përvoja të ndryshme:

- nga specialistë të institucioneve vendore e te të huaja, si Banka Botërore;
- nga Profesorati universitar dhe institucionet shkencore (psh Rumania);
- nga Qeveria, biznesi, specialistë nga shoqeria civile (psh Izraeli), etj.

Ka edhe çështje të tjera për përgjigje:

- Si do të jetë struktura e strategjisë, mbi baza projektesh të burimeve themelore apo raportesh të përgjithshme, si në vitet e kaluara?
- Çfarë përmbajtje do të ketë strategjia, globale apo jo globale? A do të përmbajë ajo edhe krijim institucionesh të reja, nënstrategji që domosdoshmërisht do të fillojnë përara saj, p.sh. ajo dixhitale? A do të përmbajë ajo edhe reforma për periudha të caktuara?
- Cili do të jetë projekti për futjen dhe zbatimin e SWOT në projektet (nënstrategjitë) themelore të strategjisë kombëtare?
- A jemi të përgatitur që të përballojmë investime të posaçme për strategjinë (siç kanë bërë disa vende të BE)?
- Çfarë duhet të bëjmë për sigurimin e bazës së të dhënave, përvetësimin e metodave dhe procedurave të propozuara, të teknologjive bashkëkohore, etj?

Përmendim në fund se kërkesa për specialistëve të mirëfilltë në fushën e strategjisë dhe të zbatimit të saj) është një nga sfidat më të vështira në vendin tonë sepse strategjitë e mëparshme janë mbështetur kryesisht në përvojën e punonjësve tanë dhe të Bankës Botërore, e cila në kushtet e tanishme nuk mjafton.

Literatura

1. Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Strategjia Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020. Tiranë 2015;
2. National Strategy for Development and Integration Albania. Draft 2013;
3. L. Bertalanffy (1969) – General System Theory, Canada;
4. J. Karppi, M. Kokkonen, L. Smith (2001) SWOT analysis for regional strategies, Norway;
5. Academia Romana (2017) Strategia de dezvollare a Romanier in Uzmatirii 20 de ani (Bucuresti, Romania);
6. Th. L. Saaty, K. Pernwak (internet) Planning the future with risk and uncertainty. The forward and backward processes of planning;
7. Interreg Europe (2018) Programme Manual. EU;
8. EC (2011) Implementation of Digital Agenda;

9. Ministry of Public Administration (2015) e-Croatia 2020 strategy;
10. Ministerul pentin societate informatinata (2014). National Strategy on Digital Agenda for Romania (2014);
11. Republic of Kosovo, National Strategy for European Integration, Kosovo 2020. A participatory approach;
12. Regional Cooperation Council, South East Europe 2020, Job and Prosperity in European Perspective;
13. Federal Ministry of Education and Research, China Strategy 2015-2020. Strategy framework for Cooperation with China in Research, Science and Education;
14. Department of Education and Skills, Ireland (2011) National Strategy for Higher Education to 2030. Dublin, Ireland;
15. Ministry of Transport, Croatia. Transport Development Strategy of the Republic of Croatia, 2014;
16. Ministry of Public Administration, Croatia. Croatian Strategy for the Development of Public Administration 2015-2020;
17. Estonian Education Strategy 2012-2020. Five Challenges;
18. Department of Rural and Development. The failure of the Estonian Energy Sectory in relation to EU 2050 low carbon economy readmap;
19. A. Kirch (2012) Process of Implementation of Knowledge Triangle in Estonia;
20. Research and Development Strategy of Moldova by 2020, Academy of Sciences;
21. Grand Strategy for Israel (2017), prepared by The Samuel Neaman Institute;
22. University of Zagreb. Strategic Program of Scientific Research Faculty of Pharmacy and Biochemistry 2014-2019;
23. Austrian Community College. SWOT Manual AY13;
24. V. Isoherramen. Strategy Analysis Framework for Strategy orientation and focus (Thesis) Oulu, Finland;
25. Ministry of Education, Science and Technology. Strategy for education development in Serbia 2020, published by Z. Obradovic;
26. Strategy for development of higher education in the Republic of Bulgaria 2014-2020;
27. S.Osmani, B.Leskaj. Teoria e kategorisë matematike me plotësime(Përgatitur për botim,2019);
28. S.Osmani, B.Leskaj Optimizimi.Pjesa e pestë, 2017;
29. Revista nr.14, “Auditimi Publik”, botim i KLSH-së. Shkrimi “Performanca, sistemi, risku dhe vendimmarrja fazi në grup me shumë kritere”.

Shënim: Në literaturën e STRATEGJISË KOMBËTARE ka edhe disa materiale të tjera që nuk janë referuar.

Nga: Prof.Dr.Skënder Osmani

Dr.Bujar Leskaj, Kryetar, KLSH

RIORGANIZIMET NË SEKTORIN PUBLIK TË SHQIPËRISË - ÇFARË MUNGOI?

Në botën e auditimit, një strategji e mirë që rezulton në një numër të konsiderueshëm gjetjesh, nuk është ajo ç'ka do të quanim "punë të mbaruar". Siç vërente Lonsdale (2000), SAI-t e vlerësojnë si tepër të rëndësishme që vlera dhe impakti i punës së tyre të njihet nga të tjerët.

Nga: Valbona Gaxha, Kryeauditues, KLSH

Abstrakt

Transparenca dhe llogaridhënia janë përbërës të rëndësishëm të qeverisjes së mirë dhe SAI-t janë institucionet kyçe për të garantuar zbatimin e vazhdueshëm të këtyre dy shtyllave të domosdoshme. Në këtë kontekst dhe në një mjedis gjithmonë në ndryshim ku SAI-t operojnë, ata duhet të jenë të vëmendshëm, të përshtaten vazhdimisht me ndryshimet dhe të përcaktojnë strategji të reja për probleme të qeverisjes së mirë që lindin nga këto ndryshime. Në botën e auditimit, një strategji e mirë që rezulton në një numër të konsiderueshëm gjetjesh, nuk është ajo ç'ka do të quanim "punë të mbaruar". Siç vërente Lonsdale (2000), *SAI-t e vlerësojnë si tepër të rëndësishme që vlera dhe impakti i punës së tyre të njihet nga të tjerët.*

Për këtë dokument është rishikuar literatura e përshtatshme, e kombinuar me analizën e të dhënave sasiore dhe cilësore të marra nga raportet e auditimit të KLSH. Literatura dhe provat, theksojnë se riorganizimet në sektorin publik udhëhiqen nga faktorë të ndryshëm që shihen në kontekst socialo-politik, në mënyrë që të vlerësohen rezultatet e kërkuara të riorganizimit dhe të lejohen audituesit të vlerësojnë pajtueshmërinë dhe performancën e operacionit.

Ky dokument analizon reformën administrative, të vënë në jetë në Shqipëri, në vitin 2014, bazuar në rezultatet e auditimeve të kryera nga KLSH. Duke marrë në konsideratë që kjo është reforma e dytë më e madhe e ndërmarrë në 10 vitet e fundit, në strukturat e qeverisjes vendore: nga "ndarja" në "bashkim", ne theksojmë faktin se rekomandimet e KLSH-së, në 2013, u morën gjërësisht parasysh nga qeveria. Këto rekomandime theksuan nevojën për riorganizim të qeverisjes vendore në formë bashkimi dhe konsolidimi, që e ndjekur nga një proces vigjilent, solli vendimin për një reformë të dytë vetëm një vit më pas. Motivimet e

shfaqura për këtë riorganizim ishin ulja e kostove, rritja e efiçencës, ekonomi më të mirë që sjell qeverisje më të mirë, bazuar në ekonominë e shkallës.

Për ta mbyllur, bazuar në gjetjet e auditimeve dhe konkluzionet e nxjerra në projektet e fundit të auditimit nga KLSH, objektivat kryesore të reformës së re nuk u arritën. Tani, detyra për të përcjellë e për të komunikuar rezultatet administratës dhe qeverisjes vendore ngre një sfidë tjetër për KLSH-në, e cila, siç dhe thuhet në këtë artikull, synon përcaktimin e treguesit për vlerësimin e këtyre reformave, me qëllim të shtojë vlerë në zbatimin e qeverisjes së mirë dhe mbajtjen në transparencë dhe llogaridhënie të saj.

Fjalë kyçe: *qeverisje vendore, reformë, bashkim, motive dhe rezultate, vlerë publike, vlera e shtuar e SAI-t.*

Hyrje

Gjatë shtatorit të 2013, qeveria shqiptare shpeshtoi diskutimet në lidhje me riorganizimin e qeverisjes vendore, të cilat u finalizuan në 31 korrik 2014, me miratimin nga Parlamenti të Ligjit 115/2014 "Për Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", duke ulur numrin e njësive të qeverisjes vendore nga 373 në 61 bashki. Qëllimi i këtij riorganizimi, i quajtur "Reforma Administrativo-Territoriale e 2014-ës", ishte rritja e efiçences së njësive të qeverisjeve vendore me më pak kosto, për të siguruar shërbim më të mirë dhe për t'i dhënë qytetarëve dhe komuniteteve akses me të madh tek këto shërbime, duke krijuar kështu vlerë publike me sloganin "promovim të demokracisë vendore". Si fenomen ekonomik, ky riorganizim është një formë bashkimi, bazuar në parimet e ekonomisë së shkallës, duke deleguar më shumë shërbime tek qeverisja vendore, e cila do të ketë më shumë kapacitet për të ushtruar një sërë funksionesh me kosto më të ulët shërbimi. Duke parë eksperiencat ndërkombëtare nëpër Europë dhe Amerikën e Veriut, riorganizime të ngjashme kanë ndodhur duke bashkuar njësi të vogla të qeverisjes vendore, me qëllim forcimin e demokracisë vendore, rritjen e efiçencës në shërbimet vendore dhe rritjen e numrit të këtyre shërbimeve. Edhe pse faza përgatitore është ndihmuar dhe kryer nën një projekt të veçantë, ai vazhdimisht ndoqi një proçes të masave shtesë, si përfundimi i kuadrit ligjor me miratimin e Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" dhe një sërë aktesh rregullatore.

Nga ana tjetër, SAI, si një institucion i pavarur në shërbim të qytetarit dhe "...për kontribut në qeverisje të mirë", synon të shtojë vlerën e punës së tij duke promovuar përgjegjshmërinë në fondet publike në mënyrë efikase dhe ekonomike. Prandaj, në ligjin organik të SAI-t të vitit 2014, ai mori pjesë në kontributin për një auditim performance të kryer në drejtim të efikasitetit dhe efektivitetit të qeverisjes vendore. Gjetjet ishin në përputhje me konkluzionin se qeverisja aktuale vendore me disa njësi të vogla ishte shumë e fragmentuar dhe joefikase dhe për disa

njësi të vogla ajo u kthye vetëm në barrë në buxhetin e shtetit dhe qeverisjes vendore, pa aftësinë për të ofruar shërbime. Duke marrë parasysh kohën dhe vëmendjen në këtë çështje, rezultatet dhe rekomandimet e këtij auditimi janë marrë parasysh dhe kanë kontribuar në ngritjen dhe theksimin e çështjes për të tërhequr vëmendjen e ligjvënësve për të zbatuar ndryshimet afatgjata për një organizim dhe administrim bazuar në parime të demokracisë dhe qeverisjes së mirë. Tre vite pas zbatimit të reformës, KLSH kreu një auditim tjetër, me qëllim vlerësimin nëse objektivat e reformës së vitit 2014 ishin arritur dhe nëse ishte krijuar ndonjë vlerë publike në fund.

Duke konsideruar rolin e SAI-t në zbatimin e qeverisjes së mirë, bazuar në rritje të llogaridhënies, ata hasin sfida në komunikimin efikas dhe në shpërndarje të rezultateve të auditimit. Cilësia e auditimit dhe mesazhi i qartë janë thelbësore, por sidoqoftë cilësia e rekomandimeve është ajo që garanton impaktin e punës audituese, ose atë që quhet vlera publike e shtuar nga SAI. Në rastin e një transaksioni të tillë ekonomik të madh dhe kompleks, si reforma administrativo-territoriale, me shumë palë të përfshira, shumë faktorë të brendshëm duhet të merren në konsideratë, në mënyrë që, jo vetëm të identifikohen, por edhe të kontribuojnë në zgjidhje. Në këtë kontekst, qëllimi i këtij dokumenti është të prezantojë dhe të analizojë rezultatet e punës audituese, duke përdorur modelin e trekëndëshit strategjik të Moore-it ne synimin e krijimit te vlerës publike për të identifikuar më mirë përbërësin që mungon në zbatimin e një reforme të suksesshme.

Teoria dhe rishikimi i literaturës

Një literaturë e gjërë ka hulumtuar potencialin demokratik të bashkimit të qeverisjes vendore (Dahl 1967; Sharpe 1970; Dahl dhe Tufte 1973; Newton 1982; Wollman 2008; Denters 2014; Lassen dhe Serritzlew 2011; Lewis 2011; Warren 2011).

Wollman (2008) identifikon dy strategji të ndryshme që ndiqen në ristrukturimin territorial dhe organizativ të qeverisjes vendore: Në një alternativë, reformat kanë për qëllim rritjen e kapacitetit administrativ dhe efikasitetin duke zgjeruar bazën territoriale të autoriteteve vendore nëpërmjet bashkimit të tyre, duke krijuar kështu njësi më të mëdha territoriale të qeverisjes vendore. Studimet empirike të efekteve ekonomike të bashkimit të qeverisjes vendore kryesisht fokusohen në efektet e shkrirjes në shpenzime dhe nuk ka tregues të qartë për matjen e efektivitetit, që nënkupton se si madhësia e juridiksionit ka ndikuar në cilësinë e shërbimeve vendore. Modeli i 3 E-ve, i cili fokusohet në ekonomi, efikasitet dhe efektivitet të shërbimeve publike, përcakton ekonominë si kosto e prodhimit të shërbimeve publike, efikasiteti si teknik (kosto e njësisë) i përfaqësuar në tre kategori: rritja e të ardhurave, ulja e kostove dhe mundësitë e rritjes së mëtejshme, dhe efektiviteti si arritje aktuale e objektivave të shërbimit zyrtar (Boyne 2002). Gjithashtu, konceptet e eficiencës dhe efektivitetit dhe sfidat per t'i matur ato, i gjejmë të diskutuara në

kontekstin e konceptit të vlerave publike si një formë e llogaridhënies në qeveri.

Krijimi i vlerës publike sa i përket Mark Moore

Trekëndëshi Strategjik



Siç u tha, libri i Mark Moore (1995) shënoi fillimin e fushës së kërkimit të vlerës publike. Moore (1995) e bën të qartë, në fillim, se teoria e tij është një teori normative e sjelljes menaxheriale. Ai ofron një kornizë strategjike të menaxhimit, sipas së cilës një trekëndësh strategjik që bazohet në konceptin se menaxhimi strategjik në sektorin publik duhet të harmonizojë tre komponentë: Së pari, çdo strategji duhet të jetë e vlefshme në substancë, pra duhet të prodhojë vlera publike. Së dyti, strategjia duhet të konsiderohet politikisht e ligjshme nga mjedisi autorizues, i cili përbëhet nga individë dhe grupe që mund të kontrollojnë flukset e burimeve (p.sh. autorizimet, paratë, bashkëprodhimet, etj.) që nevojiten për arritjen e rezultateve të vlefshme. Së treti, strategjia duhet të jetë e zbatueshme në aspektin e kapacitetit operacional, pra organizata duhet të jetë në gjëndje të japë rezultatet e deklaruara (Moore, 1995).

Krijimi i vlerës publike në SAI

Roli i SAI-ve në kontekstin e vlerës publike vjen përmes misionit dhe objektivave të tij për të siguruar qytetarët dhe taksapaguesit që paratë e taksuara janë shpenzuar mirë dhe për qëllimin të cilin ato buxhetohen. Këto objektiva realizohen përmes përputhshmërisë dhe auditimit të performancës. Rëndësia e krijimit të vlerës publike është njohur edhe nga INTOSAI, që ka vendosur dhe dokumentuar parimet e lidhura me standardin ISSAI 12 në vitin 2013: "Vlera dhe benefitet e SAI-t – të bësh ndryshim në jetët e qytetarëve". Duke parë përmbajtjen e parimeve të ISSAI 12, ato mund të jenë lehtësisht të transpozuara në trekëndëshin strategjik të Moore. Grupi i parë i parimeve: forcimi i llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të qeverisë dhe subjekteve të sektorit publik. Grupi i dytë i parimeve është demonstrimi i rëndësisë së vazhdueshme për qytetarët, parlamentin dhe palët e tjera të interesit. Ndërsa grupi i tretë i parimeve të qenit një organizatë model përmes udhëheqjes nëpërmjet shembullit.

Historia e qeverisjes vendore në Shqipëri

Zgjedhjet e para vendore në 1992, vulosën decentralizimin e qeverisjes në Shqipëri, duke supozuar autonomi administrative dhe fiskale në sajë të delegimit të më shumë përgjegjësive. Ratifikimi pa kushte i Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore (8548/1998) dhe miratimi i Ligjit per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore (8652/2000) shënojnë momentin e dytë më të rëndësishëm në decentralizimin e qeverisjes, duke krijuar decentralizimin e plotë të kuadrit

administrativ dhe fiskal (Gazeta Co-PLAN)[1]. Ligji "Për Ndarjen Administrative dhe Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore (8653/2000)" u miratua si pjesë e reformës për decentralizimin e qeverisjes. Ndarja administrative e vitit 2000 ndoqi kufijtë historikë të komunave, rretheve e prefekturave. Numri relativisht i lartë dhe sipërfaqet e vogla të shumicës së njësive të qeverisjes vendore, së bashku me shqetësimet mbi efikasitetin dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve, gjithnjë e më shumë janë konsideruar si një pengesë serioze për qeverisjen dhe zhvillimin lokal dhe është hasur në debatet e politikave kombëtare që nga fillimi i vitit 2003. Në këto kushte, në vitin 2003 u rivendos diskutimi mbi reformën administrativo-territoriale dhe duke iu referuar një dokumenti politik të përgatitur nga Këshilli i Evropës, në vitin 2004 u hartua një ligj për riorganizimin administrativ dhe territorial të shteteve.

Viti 2005 është një tjetër moment i rëndësishëm në procesin e decentralizimit të qeverisjes, me një qasje të re strategjike për procesin e decentralizimit fiskal, duke transformuar sistemin e transferimit ndërqeveritar të granteve, duke sjellë pothuajse barazi fiskale. Kjo reformë duhej të zgjidhte problemin e njësive vendore të vogla dhe atyre shumë të vogla, për të gjeneruar të ardhura dhe për të ofruar shërbime te qytetarët. Megjithatë, diskutimi për gjetjen e njësive më të mëdha të qeverisjes vendore që ofrojnë shërbime më pranë qytetarëve dhe përdorin burime financiare në mënyrë efikase, shpesh u soll në tryezë, por pa konkluzion të qartë. Në të vërtetë, këto çështje morën vëmendje të veçantë vetëm në vitin 2013. Më në fund, përfunduan me ligjin e ri mbi reformën e qeverisjes vendore në vitin 2014, që hyri në fuqi në korrik 2015.

Reforma e "ndarjes" e vitit 2000 dhe gjetjet e auditimit

Modeli i reformës territoriale të vitit 2000 ishte një ndarje bazuar në decentralizim simetrik, duke krijuar 373 komuna ose njësi zgjedhore, që do të thoshte se qytetarët ishin të përfaqësuar në nevojat e tyre lokale dhe kishin akses të drejtpërdrejtë në vendimarrje. Gjatë diskutimit të problemeve që ky lloj riorganizimi solli në lidhje me efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të qeverisjes vendore, KLSH nisi një auditim performance me temë "Ndarja territoriale administrative në Republikën e Shqipërisë" në fillim të vitit 2013. Auditimi u mbyll ne fund të shtatorit 2013, duke arritur në konkluzionin se, si rezultat i reformës administrative territoriale të vitit 2000, qeverisja vendore shqiptare ishte shumë e fragmentuar dhe joefikase, duke patur 373 njësi me popullsi mesatare 7579 banorë, 75% e njësive të qeverisjes vendore kishin më pak se 5000 banorë për njësi, 62% këshilltarë të zgjedhur që mbulonin vetëm 19% të popullsisë, 18% e kryetarë të zgjedhur që përfaqësojnë 45% të popullsisë, 70 njësi kishin zero investime kapitale, në 230 njësi nga 373, pjesa më e madhe e shpenzimeve ishin paga (60%), 44% e tatim-fitimit të biznesit të vogël gjeneroheshin nga vetëm

[1] *Gazeta Co-PLAN nr.6, shkurt 2014, Instituti për Zhvillimin e Habitatit*

25 njësi ose 7% e të gjitha njësive të qeverisjes vendore, ndërsa 63 njësi raportuan zero të ardhura nga tatim-fitimi i biznesit të vogël[2].

Thelbi i këtij studimi ishte se: "*Ndarja aktuale administrativo-territoriale ka sjellë një ngadalësim të zhvillimit lokal dhe varësinë e NJQV-së nga të ardhurat e buxhetit të shtetit. Shqipëria ka nevojë për një ndarje të re administrativo-territoriale bazuar në kritere të qarta, me qëllim rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të NJQV-ve në arritjen e objektivave, për të rritur cilësinë e shërbimeve ndaj komunitetit*".

Në këtë studim, KLSH formulon rekomandimet dhe këshillon të përdoren tregues konkretë kur të dizajnohet struktura e re e qeverisjes vendore, si madhësia e NJQV-ve, numri i banorëve për njësi, dendësia e popullsisë, raporti i shpenzimeve administrative me shpenzimet totale (%), të ardhurat nga buxheti i përgjithshëm, kostoja e shërbimeve, të tilla si ndërtimi i infrastrukturës kundrejt sipërfaqes dhe densitetit të popullsisë, duke zbatuar raportin minimal: numri i të punësuarve/ 1000 banorë. Këta tregues më vonë do të përdoren për të matur performancën e qeverisjes vendore të strukturuar rishtazi.

KLSH	Konferenca Kombëtare	Vendimi për ministrinë e çështjeve të qeverisjes vendore	Kriteret Teknike Përgatitjet	Konsultim public	Miratimi per hartën e re TAR	Miratimi final	Data efektive
Dhjetor 2012	Tetor 2013	Nëntor 2013	Mars 2014	Prill-Maj 2014	22 Maj	17 Korrik	
Raporti i parë **Tetor 2013**	**4 Muaj**		**2 muaj**				Shtator 2015
	Më pak se një vit përgatitje						

Me një mesazh auditimi konciz dhe të qartë, shoqëruar me treguesë specifikë dhe konkretë, rekomandimet e KLSH-së u bënë pjesë e propozimit të projektligjit "Për Ndarjen Administrative dhe Territoriale të Njësive të Qeverisjes

[2]*Raport përfundimtar auditimi, dhjetor 2013, Departamenti i Auditimit të Performancës, KLSH*

Vendore në Republikën e Shqipërisë". Duke marrë parasysh kohën, auditimi dhe rezultatet e tij erdhën si një kontribut "ex ante" duke shtuar vlerë në proces, edhe pse duhet theksuar se mjedisi politik kishte të gjithë fokusin dhe mbështetjen e të gjithë faktorëve politikë që ishin të vendosur të vazhdonin me reformën më të madhe administrativo-territoriale.

Reforma e "bashkimit" e vitit 2014 dhe gjetjet e auditimit

Ndikimi i performancës së reformës së qeverisjes vendore është theksuar pas shumë gjetjeve dhe rekomandimeve në disa auditime përputhshmërie ose financiare të kryera gjatë 2015-2018. Kryesisht, këto gjetje ishin në kontekst të auditimit të zbatimit të buxhetit në lidhje me mbledhjen e të ardhurave, menaxhimin e aseteve, mbledhjen e borxheve të mbartura, duke theksuar çështje të tilla si niveli i lartë i centralizimit në planifikimin e buxhetit, sistemi i dobët i kontabilitetit dhe raportimi financiar, mungesa e llogaridhënies në çështjet e menaxhimit të aseteve, apo shuma e shtuar e borxheve të reja të krijuara për shkak të planifikimit të dobët e ndikimeve politike. Shumica e bashkive kanë një program buxhetor afatmesëm, por nuk kanë analiza të duhura, sisteme të kontrollit financiar, kontabilitet dhe raportim, dobësi që vazhdojnë të mos trajtohen siç duhet dhe plotësisht.

Si pjesë e planit të auditimit, u planifikua një tjetër auditim performance me temën "Funksionimi i bashkive në kuadër të reformës administrativo-territoriale", me qëllim vlerësimin e funksionimit të bashkive të reja, bazuar në konceptin 3E. Duke iu referuar objektivave të bashkimit, u vendosën pyetjet e auditimit dhe auditimi konkludoi në këto gjetje:

Objektivat e reformës	Pyetjet e auditimit	Gjetjet e auditimit
• **Efikasiteti**: Kursimet nga kostot e shkurtuara të operimit dhe proceseve të efektshme; • **Menaxhimi financiar**: Më shumë rritje të ardhurash dhe shpërndarje shërbimi në territor; • **Cilësia e shërbimit**: Aftësi të zgjeruara për të siguruar më shumë shërbime më cilësi më të mirë dhe kosto më të ulët; • **Decentralizimi**: Planifikim i integruar afatgjatë i përmirësuar, që përfshin menaxhimin e aseteve; • **Autonomia**: Rritje të kapacitetit për të thithur fonde shtetërore dhe donacione dhe partneritet me biznese për projekte komunitare.	• A është **kuadri ligjor** i plotë, transparent dhe lehtësisht i aksesueshëm? • A e ka përmirësuar riorganizimi **cilësinë e shërbimeve funksionale** për qytetarët? • Si shkojnë **shpenzimet** e bashkive? • A është **autonomia** financiare e garantuar si rezultat i reformës së vitit 2014? • Cili është efekti i bashkimit sa i përket **mbledhjes së të ardhurave**? • A e ka përmirësuar bashkimi **menaxhimin financiar publik** në nivel të qeverisjes vendore?	• **Kuadri ligjor**: Mungesë e përshtatjes, kohë jo e koordinuar, "zona gri" në kompetencat e bashkive; • **Efikasiteti dhe cilësia**: Funksionet e reja përfshijnë shërbime të amortizuara dhe barrë buxhetore të rëndë për bashkitë. Treguesit e performancës mungojnë dhe monitorimi i tyre çalon; • **Decentralizimi**: Raporti midis shpenzimeve kapitale dhe shpenzimeve aktuale është i njëjtë si në 2010-2011. Të ardhurat kanë rënë në norma më të ulëta se të ardhurat e qeverisjes qendrore; • **Autonomia**: Ndërhyrjet e shpeshta dhe të pabazuara në analiza fiskale të qeverisjes

		qendrore kanë destabilizuar të ardhurat lokale.

Burimi i të dhënave: Raport përfundimtar auditimi, dhjetor 2013, KLSH

Duke parë gjetjet kryesore, bashkimi i njësive të qeverisjes vendore pritej të shoqërohej me reduktim të kostove administrative, si rezultat i konsolidimit të 373 njësive të qeverisjes vendore të fragmentuara në vetëm 61 bashki dhe me rritje të shpenzimeve për investime publike. Me fjalë të tjera, ndarja e re administrative duhet të ndryshonte mënyrën e organizimit të qeverisjes vendore, me qëllim rritjen e burimeve financiare dhe rritjen e eficiencës dhe efektivitetit të përdorimit të tyre, bazuar në autonomi dhe rritje të llogaridhënies e transparencës. Duket se asnjë nga këto objektiva nuk u arrit deri në vitin 2018 dhe për më tepër, raporti i auditimit arriti në përfundimin se rreziku i mospërmbushjes së objektivave të reformës është shumë i lartë, duke fajësuar periudhën e shkurtër kohore të përgatitjes ligjore dhe procedurale (më pak se një vit), duke e lidhur kohën efektive të reformës me zgjedhjet elektorale, duke e kthyer transaksionin më së shumti si një zbatim të reformës politike në vend të asaj menaxheriale dhe administrative.

Mesazhi kryesor i auditimi ishte se: "*Reforma administrativo-territoriale nuk i ka përmbushur objektivat: legjislacioni nuk zbatohet plotësisht, procesi i thithjes së funksioneve të reja, punonjësve, aseteve dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve nuk është arritur me sukses. Në shumicën e komunave rezulton një nivel i ulët i efektivitetit në mbledhjen e të ardhurave të veta dhe përdorimin e fondeve në dispozicion. ...ekziston një mospërputhje ndërmjet objektivave të reformave e politikave fiskale dhe buxhetit të qeverisjes qendrore që kanë shkelur autonominë lokale*" [3].

Trekëndëshi Strategjik i Vlerës Publike. Çfarë mungoi?

Teksa rezultatet e auditimit dolën në përfundimin se objektivat e reformës nuk ishin arritur, duke testuar dhe vlerësuar çdo objektiv individualisht, në thelb përfundimi i auditimit mund të përkthehet në *asnjë vlerë publike të krijuar*. Procesi i auditimit filloi më shumë se 2 vjet nga data efektive e riorganizimit të qeverisjes qendrore, duke menduar se ishte kohë e mjaftueshme për të parë frytet e para të reformës në lidhje me 3E. Për qëllimin e këtij dokumenti, mesazhi i fortë i auditimit nuk lë hapësirë për diskutime të mëtejshme apo analiza për pyetjen nëse ka ose nuk ka vlerë publike të krijuar, kryesisht "duke fajësuar" mungesën e autonomisë financiare. Megjithatë, duke pasur parasysh se bashkimi i qeverisjes vendore është një transaksion ekonomik shumë kompleks, i përzier me faktorë

[3] *Raport përfundimtar auditimi, tetor 2018, KLSH*

politikë dhe socialë, duke përdorur të dhënat e mbledhura nga auditimi, do të përpiqemi t'i lexojmë ato në përputhje me trekëndëshin strategjik të Moore-it, në mënyrë që të identifikojmë komponentin që mungon.

Sipas modelit të Moore, *së pari*, çdo strategji duhet të jetë në thelb e vlefshme. Në fillim të këtij dokumenti kërkimor, pranojmë se komponenti i parë ekziston, duke pasur parasysh periudhën e gjatë të diskutimeve dhe përpjekjeve, që nga mesi i viteve 2000, finalizuar me marrëveshjen e të gjitha palëve, që reforma ishte e pashmangshme. Në tetor 2013, Ministri për Çështjet e Brendshme krijoi grupin e ekspertëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë për reformën. I gjithë procesi dhe strukturat që përfshiheshin u mbështetën nga asistenca teknike dhe financiare e projektit STAR, financuar nga qeveria e SHBA, qeveria suedeze, qeveria zvicerane, qeveria italiane, UNDP, Këshilli i Evropës, OSBE, ambasada e Mbretërisë së Holandës, ambasada e Austrisë, etj.

Së dyti, strategjia duhet të konsiderohet politikisht e ligjshme nga mjedisi autorizues, që ngre pyetjen e rradhës, nëse procesi i bashkimit kishte gjithë mbështetjen me resurset dhe autoritetitin e nevojshëm për të krijuar vlerë publike. Duke u kthyer te rezultatet e auditimit, elementi i autonomisë për NJQV-të nuk ishte siguruar, pavarësisht shpërndarjes së buxhetit për pushtetin lokal, që në 2016 arriti në 3.2% të GDP-së. Kjo ende konsiderohet e pamjaftueshme për të mbuluar zonat më të mëdha demografike dhe më shumë funksione e shërbime të deleguara për to, pa ndërhyrje të vazhdueshme nga nivelet më të larta qeverisëse. Sidoqoftë, gjatë këtyre tre viteve, Ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe Ligji "Për Financat e Pushtetit Vendor" hynë në fuqi, respektivisht në janar 2016 dhe qershor 2017, rezultatet e të cilëve pritet të shihen gjatë 2018, edhe pse procesi i dhënies së granteve për financimin e projekteve nga "Fondi i Zhvillimit Rajonal" është ende një problem, për shkak të shpërndarjes jo të barabartë dhe ndonjëherë të padrejtë të investimeve nëpër bashkitë e mëdha e të vogla.

Së treti, sipas trekëndëshit të Moore, strategjia duhet të jetë e realizueshme në aspektin e kapacitetit operacional, pra organizata duhet të jetë në gjëndje të japë rezultatet e deklaruara. Ajo që i bashkon të gjitha pjesët është elementi i performancës së menaxhimit strategjik, që do të thotë se agjencitë qeveritare do të kërkojnë përgjegjësi organizative gjatë zbatimit të të gjithë komponentëve të strategjisë. Ata duhet të krijojnë sisteme të kontabilitetit dhe të matjes që monitorojnë kontrollin e tyre mbi pasuritë, pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat dhe rezultatet e organizimit. Vlen të përmendet se, si çdo transaksion bashkues, që ka nevojë për përgatitjen e duhur me qëllim planifikimin e fazës së tranzicionit dhe sigurimin e një zbatimi të suksesshëm, përgatitja është mbështetur si pjesë e projektit "Mbështetje për Reformën Territoriale & Administrative-

STAR I and II"[4]. Ata mbuluan të gjithë procesin e zbatimit të reformave financiare dhe operacionale për një bashkim të kënaqshëm. Gjithashtu hartuan procedurat e shkrirjes nëpërmjet pilotimit dhe testimit, fillimisht në disa NJQV të përzgjedhura; shpërndarjen e modelit konsensual për pjesën tjetër të NJQV-ve përmes trajnimit, stërvitjes dhe ngritjes së kapaciteteve për palët e interesuara dhe përfituesit e bashkimit. Sidoqoftë, gjatë zbatimit u shfaqën shumë probleme të ndryshme, si transferimi i aseteve, mungesa e hartimit të bilanceve të konsoliduara, mosveprimi i inventarëve, në pamundësi për të mbledhur borxhet, konkludojnë për një sistem të kontrollit të brendshëm financiar.

Të tre këto komponentë janë themelet për krijimin e vlerave publike, që në rastin e qeverisjes vendore përkthehet në cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët dhe rritjen e investimeve publike. Nëpërmjet mesazhit të auditimit, çështja e cilësisë së shërbimit është nënvizuar, pasi nuk është e mundur të matet, së paku pa caktuar disa tregues. Gjithashtu, rekomandimet e auditimit flasin për mungesën e decentralizimit, duke drejtuar gishtin vetëm tek pushteti qendror për buxhetim të dobët dhe vonesa në ligjet e reja që do të garantonin autonominë, pra efektivitetin e reformës. Megjithatë, me ndihmën e modelit të Moore, ne mund të nxjerrim në pah faktorë "të brendshëm" që mungojnë, si vetë menaxhimi i pushtetit vendor, nëse marrim në konsideratë komponentët e fizibilitetit operacional, ka shumë për t'u bërë në brendësi, siç ka filluar me zbatimin e kontrollit të sistemit financiar, duke aplikuar qeverisjen e mirë, për të shfrytëzuar fondet e disponueshme, bazuar në llogaridhënie dhe transparencë.

Përfundime

Qeverisja vendore është transformuar nga bashkimet dhe shkrirjet kudo nëpër botë. Shtrirja tipike e njësive të pushtetit vendor është rritur ndjeshëm, duke synuar forcimin e demokracisë, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe efikasitetin. Në rastin e Shqipërisë, reforma e dytë më e madhe e vitit 2014, synonte krijimin e njësive më të mëdha lokale, që ofronin shërbime në mënyrë më efikase, duke shfrytëzuar më mirë burimet financiare. Duke marrë parasysh kompleksitetin e reformës, rëndësinë dhe ndikimin e saj te qytetarët, KLSH ka luajtur rolin e tij në rritjen e ndërgjegjësimit për mungesën e rezultateve të zbatimit të reformave, kryesisht duke theksuar mungesën e autonomisë financiare të qeverisjes vendore. Përmbledhja e rezultateve të auditimit, bazuar në trekëndëshin strategjik të vlerave publike të Moore, mund të themi se, përveç vëmendjes dhe procesit të kujdesshëm të përgatitur për një tranzicion sa më të butë, gjërat u nxituan për shkak të kohës së zgjedhjeve. Që atëherë, kuadri ligjor ka qenë vazhdimisht në proces përmirësimi dhe përshtatjeje, duke shkaktuar shtyrjen e progresit të komponentëve të tjerë, si

[4] *Projekti STAR përafërsisht. $ 3.5 milion, 30 ekspertë, 1 anketim me 16000 të marrë në pyetje, 37 takime me Shoqeritë Civile, 5 takime me bizneset, 60 ditë për ankesa dhe kundërshtime*

mbledhja e të ardhurave dhe investimet publike. Sidoqoftë, trekëndëshi i Moore tregon se komponenti i tretë, që lidhet me kapacitetet operacionale, është një pjesë tjetër e madhe që mungon për të garantuar realizimin e objektivave të reformës, që më vonë u përkthyen në vlerë publike. Në përfundim, niveli i përmirësimit që pritet, pra efektiviteti i riorganizimit, 3 vjet pas ndryshimit, është ende i paqartë dhe ende vlerësohet bazuar në performancën financiare dhe përmirësimin jo të njëtrajtshëm të cilësisë së shërbimit. Faktorët politikë, mungesa e politikave makro fiskale, mungesa e sistemit të kontrollit financiar, kapacitetet e stafit dhe motivimi janë aspekte që gjithashtu duhet të kuptojnë ndikimin e tyre në reformë dhe të identifikojnë mundësi për përshpejtim.

Në këtë kontekst, nëpërmjet mesazhit të auditimit, KLSH synon të theksojë boshllëqet dhe dobësitë e punës së NJQV-ve, si dhe të rekomandojë zgjidhje, që mund të sjellin përmirësimin e performancës së këtyre strukturave, në drejtim të forcimit të qeverisjes së mirë. Në auditimin e parë të performancës, para zbatimit të reformës, ndikimi i punës së auditimit u mor në konsideratë nga ligjvënësit, pasi ai erdhi si kontribut "ex-ante", ndërkohë që të gjitha palët e përfshira ishin të gatshme të bënin një ndryshim. Në auditimin e dytë të performancës, të kryer pothuajse tre vjet pas hyrjes në fuqi të reformës, mesazhi i auditimit theksonte fuqimisht se objektivat e reformës nuk ishin përmbushur. Rekomandimet e ndërlidhura tanimë vinin si kontribut "ex-post" në procesin e zbatimit të reformës, që duket se vazhdon të mbetet në proces. Duke marrë parasysh se pushteti lokal është në prag të zgjedhjeve të reja, faktorët politikë do të kenë një ndikim të madh në prioritetet për çfarë ndryshimesh do të bëhen, ndaj KLSH përballet me sfidën për të komunikuar më mirë rezultatet e auditimit. Për këtë qëllim, ata duhet të jenë adekuat me ndryshimet e fundit dhe të drejtohen te palët përgjegjëse. Prandaj, përpos problemeve dhe identifikimit të komponentëve që mungojnë, nuk e dimë nëse vala e shkrirjes dhe bashkimit ka kontribuar në përmirësimin e performancës së qeverisjes vendore. Megjithatë, nga këto përvoja dhe nga kërkimi, heqim faktin se auditimi ose analiza e një transaksioni të tillë të madh dhe kompleks si shkrirja dhe bashkimi i njësive të qeverisjes vendore duhet të jetë i planifikuar mirë dhe i dizajnuar duke mbajtur parasysh idenë e vlerës publike, duke garantuar mundësinë për të lidhur vlerën që një administratë krijon për shoqërinë. Sidoqoftë, vlera publike nuk mund të krijohet thjesht, aktivitetet duhet të kenë ndikim dhe të njihen në nivel individual (Meynhardt, 2009).

Përktheu: Delor Prosi

Drejtoria e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Valbona Gaxha, Kryeauditues, KLSH

BASHKËPUNIMI FUNKSIONON MË MIRË KUR ËSHTË I DOBISHËM PËR PALËT

Kontaktet personale janë të domosdoshme për të krijuar besim dhe mirëkuptim dhe mund të ndihmojnë në zgjidhjen më efikase të problemeve. Nivelet e larta institucionale nuk bëjnë përjashtim nga ky rregull.

Intervistë me z.Klaus Heiner Lehne, President, ECA. Botuar në nr.11, Nëntor/Dhjetor 2018, ECA Journal.

Realizuar nga Z.Gaston Moonen, Drejtoria e Presidencës, ECA

Kontaktet personale janë të domosdoshme për të krijuar besim dhe mirëkuptim dhe mund të ndihmojnë në zgjidhjen më efikase të problemeve. Nivelet e larta institucionale nuk bëjnë përjashtim nga ky rregull. Presidenti i ECA-s, Klaus-Heiner Lehne, është i vetëdijshëm për rëndësinë e ruajtjes së marrëdhënieve të mira me homologët e tij, si dhe benefitet e bashkëveprimit ndërkombëtar në përgjithësi. Gaston Mooren dhe Derek Meijers kanë intervistuar zotin Klaus-Heiner Lehne lidhur me eksperiencën dhe rëndësinë e bashkëveprimit ndër-kombëtar për një institucion si ECA.

Ndërtimi i imazhit të ECA-s

Klaus-Heiner Lehne është President i ECA prej më shumë se dy vitesh dhe një nga gjërat e para që bëri sapo mori mandatin ishte vizita nëpër kryeqytetet e Shteteve Anëtare të BE. Aty, ai u takua me ministrat e Financave dhe të Marrëdhënieve me Europën, zyrtarë të tjerë të qeverive, deputetë, shtypin kombëtar e përfaqësues të institucioneve audituese. Klaus-Heiner Lehne: *"Dy arsyet kryesore të këtij 'rrugëtimi' ishin strategjia jonë e re 2018-2020 dhe qëllimi ynë për të zhvilluar performancën e auditimit dhe për të ndryshuar qasjen tonë për Deklaratën e Sigurisë (Statement of Assurance). Ishte e nevojshme që kjo t'u shpjegohej partnerëve tanë të Shteteve Anëtare. Përpos kësaj, ky rrugëtim ka rritur dukshëm popullaritetin e ECA-s."* Ai shpjegon: *"Ne zakonisht kemi pak kohë për të prezantuar raportet tona tek palët kryesore të interesuara në Parlamentin Europian dhe në Këshillin e Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, të paktën jo mjaftueshëm sa për të përçuar probleme më komplekse që lidhen me punën tonë."*

Në këtë drejtim, vizitat e tij në Shtetet Anëtare të BE janë mjaft të ngjashme me aktivitetet e tjera të bashkëveprimeve ndërkombëtare. Klaus-Heiner Lehne veçanërisht synon të rrisë imazhin pozitiv të ECA-s dhe të rrisë ndërgjegjësimin mbi atë çfarë ECA bën. Pasi, siç thotë dhe Klaus-

Heiner Lehne shpesh: 'Ne jemi një institucion 'i fshehtë', jo në qendër të vëmendjes së mediave. Jo shumë njerëz na njohin, ose janë në dijeni të punëve që ne bëjmë e produkteve tona.' Ai vazhdon: 'Mendoj se është koha që ne të jemi më shumë prezentë në Shtetet Anëtare dhe te njerëzit. Vizita e Presidentit të një institucioni të BE, sidomos në vende më të vogla, mbetet një ngjarje që tërheq goxha vëmendjen e medias, duke e sjellë ECA-n më pranë njerëzve'.

Kontakti me homologët

Gjatë "rrugëtimit" të tij, Klaus-Heiner Lehne gjithashtu vizitoi shumicën e SAI-ve të BE-së, të cilat, siç shpjegon ai, janë partnerë të rëndësishëm të ECA: 'Brenda çdo shteti, SAI-t kombëtarë janë partnerët tanë kryesorë. Ata kuptojnë rolin dhe punën tonë, pasi bëjnë edhe vet të njëjtën punë. Ne bashkëpunojmë me ta në kuadër të Contact Commitee të SAI-ve të BE-së, dhe për një numër problemesh të caktuara ne bashkëpunojmë ngushtësisht. Neve na duhet ndihma e tyre, dhe atyre mund t'u duhet ndihma jonë.' Ai shton: 'Kur një anëtar i ECA-s shkon në një kryeqytet të caktuar, ai ose ajo, normalisht, do të vizitojë parlamentin dhe, zakonisht, edhe SAI-n kombëtar gjithashtu. Kjo nuk është një çështje mirësjelljeje. SAI-t, zakonisht, kanë marrëdhënie të ngushta me komisionet parlamentare, si Komisioni për Buxhetin dhe Financat, i cili mund të ketë ndikim në qeveri.' Dhe: 'Këto kontakte mund të na ndihmojnë të përçojmë mesazhin tonë te Këshilli, si dhe në Parlamentin Europian, në mënyrë indirekte'!

Klaus-Heiner Lehne: 'Fakti që është pothuajse e pamundur për të kryer një auditim të shtrirë në BE, ku mund të përdorim në mënyrë të drejtpërdrejtë informacionin që marrim nga njëri tjetri, ishte një tjetër temë që diskutuam me SAI-t kombëtare. Arsyeja për këtë është se SAI-t, zakonisht, operojnë me standarte, metodologji dhe korniza ligjore të ndryshme'. Ai vijon: 'Kjo është problematike, sepse, për tema auditimi të caktuara, psh. shëndeti publik ose problemet mbi sigurinë, do të ishte interesante të dinim saktësisht situatën aktuale në të gjithë Shtetet Anëtare, në vend të një shembulli të limituar, siç ndodh zakonisht në auditimet tona'.

Auditimet paralele

Presidenti i ECA-s shpjegon se auditimet paralele janë aktualisht instrumentat më të dobishëm dhe efektivë të disponueshëm për SAI-t e BE-së, në rast se ata duan të bashkëpunojnë në auditimet e tyre. 'Gjatë një auditimi paralel, disa SAI njëkohësisht shohin të njëjtin problem, e më pas, institucionet pjesëmarrëse mund të bëjnë një shkëmbim informacioni. Bashkëpunimi në auditim nuk përbën një cënim për pavarësinë e SAI-ve pjesëmarrëse, por ai ndihmon të shohësh si është situata në Shtetet e tjera Anëtare'. Klaus-Heiner Lehne shpjegon se, mbi të gjitha, auditimet paralele i mundësojnë SAI-ve informacione me vlerë, të cilat mund të ndihmojnë për të krijuar një bazë të dhënash më të mirë për raportet e tyre të auditimit. 'Shkëmbimi i informacionit dhe vlerësimi i tij sjell përfitim për të gjitha palët, sikurse idetë dhe mësimet e nxjerra nga fqinjët tanë mund të na ndihmojmë të përmirësojmë menaxhimin financiar dhe politikëbërjen tonë.

Klaus-Heiner Lehne shton se ka një interes të qartë, madje dhe nevojë për një bashkëpunim ndërkufitar brenda BE-së. 'Këtë vit, në kuadër të bashkëpunimit me Contact Commitee, ne hartuam një përmbledhje të parë të auditimit mbi papunësinë e të rinjve. Kjo përmbledhje bashkonte raportet e auditimit nga SAI të ndryshëm dhe krahasonte përfundimet dhe rekomandimet, duka siguruar një pasqyrë të situatës në BE. Ky produkt unik tregon vlerën e shtuar në Contact Commitee. Shpresoj që të na krijohet mundësia të hartojmë një botim të dytë të kësaj përmbledhjeje në 2019.

Përfitimet e ndërsjellta të bashkëpunimit

Për Klaus-Heiner Lehne, objektivi kyç i çdo aktiviteti bashkëpunues ndërkombëtar duhet të jetë shkëmbimi dhe ndërveprimi. 'Qëllimi është të shikosh problemin nga një perspektivë tjetër. Si punojnë SAI-t e tjerë? Cilat janë problemet e tyre? Zgjidhjet e tyre? Dhe, mbi të gjitha, si përshtaten me ndryshimet dhe si i parashikojnë zhvillimet e mëtejshme'? Ai shpjegon se, nga vetë natyra e SAI-ve, është shpeshherë më e lehtë t'i diskutosh këto tema personalisht me krerët e SAI-ve. 'Ne jemi institucione të pavarura dhe institucionet e tjera të BE janë, ose subjekte të auditimeve tona, ose institucione në të cilat ne raportojmë, ose të dyja njëkohësisht. Personalisht, duke qenë kreu i një SAI, veç anëtarëve të tjerë të ECA-s, homologët e SAI-ve partnere janë personat që kontaktoj, në rast se dua të diskutoj një problem.' Pastaj, duke qeshur: 'Dhe shpresoj të përmbush të njëjtin rol për krerët e SAI-ve të tjerë'!

Ky shkëmbim është thelbi i takimeve të Forumit të Lidershipit Global të Auditimit (GALF), i fundit i zhvilluar në ECA në Luksemburg, gjatë prillit të kaluar. Këto takime jozyrtare u zhvilluan për t'i dhënë krerëve të SAI-ve (dhe zëvendësve të tyre) nga çdo vend i botës një forum, ku mund të diskutonin probleme me interes të përbashkët në kontekst global me homologët e tyre, të cilët e kuptojnë më së miri sferën e aktivitetit të secilit dhe pasojat e të qënit një institucion i pavarur. Klaus-Heiner Lehne: 'Për mua, gjëja më e rëndësishme e GALF është se përmasat e tij mundësojnë diskutime të gjëra problemesh dhe formati i tij lejon dhe shtyn pjesëmarrësit të sjellin tema diskutimi, pavarësisht axhendës. Kjo stimulon shkëmbimin e pikëpamjeve dhe na ndihmon të vijmë me ide të reja'.

Të luash rolin tënd përfshin globalizimin

Presidenti i ECA-s vazhdon duke shpjeguar se, përpos funksionit të tyre si partnerë diskutimi, SAI-t e tjerë gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm kur ECA-s i nevojitet ndihmë në fusha, ku has vështirësi për vazhdimin e punës. Klaus-Heiner Lehne: 'Shembulli më i mirë është Banka Qendrore Europiane, ku mund të dallohet një boshllëk i dukshëm në auditimin për mbikqyrjen bankare pas ndryshimeve rregulluese të kohëve të fundit. Në rast se duam ta mbushim atë boshllëk, ne kërkojmë ndihmën e kolegëve tanë nga SAI-t kombëtarë për ta sjellë këtë problem në nivel të ministrive dhe parlamenteve kombëtare. Dhe kjo është pikërisht ajo ç'ka ka bërë Contact Commitee, së fundmi në nëntor 2018, kur pati një deklaratë të përbashkët të të gjithë krerëve të SAI-ve të BE-së mbi këtë çështje'. Iniciativa të tilla të përbashkëta janë një mënyrë efikase për të adresuar probleme që ndikojnë te të gjithë Shtetet Anëtare. Klaus-Heiner Lehne: 'Për

çështjet e lidhura me BE, është e nevojshme të punohet me një rrjet, të tillë si Contact Commitee, ku mund të diskutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të detajuar me persona që mund të kenë mundësi të bëjnë diçka për të ndihmuar'.

Krahasuar me Contact Commitee të BE-së, rrjete globale si INTOSAI kanë kufizimet e tyre, edhe për një institucion relativisht të madh, si ECA. Klaus-Heiner Lehne thotë: 'Merrni, psh, kongresin e INTOSAI (INCOSAI). Pavarësisht se ato janë takime shumë interesante, ato janë shumë më formale dhe kanë një axhendë strikte. Nuk është për t'u habitur, pasi aty janë mbi 1000 persona në një sallë.' Ai shpjegon se, në evente të tilla, diskutimet e vërteta zhvillohen në takime bilaterale jashtë kongresit.

Sidoqoftë, pjesëmarrja e ECA-s në aktivitetet e INTOSAI-t është e rëndësishme. 'Në rast se i hedhim një sy përmasave dhe rolit tonë në strukturën kontinentale, është mjaft e logjikshmë përfshirja jonë në këto nivele. Europa luan një rol global dhe është e qëllimshme, pasi ajo duhet ta luajë atë rol. Dhe pastaj mendoj se ECA, gjithashtu, duhet ta luajë atë rol. Pra, mendoj se është e qartë që ne duhet të marrim pjesë dhe, gjithashtu, duhet të përpiqemi të luajmë një rol udhëheqës.

'Takimet në nivele INTOSAI gjithashtu ofrojnë mundësinë për të takuar përfaqësues nga vende jo anëtare të BE me struktura më pak ose jo demokratike. Bashkëpunimi ndërkombëtar është kyç për Europën e gjithashtu për ECA-n. Ai na lejon ne të vëmë në dukje probleme si kushtet e punës dhe pavarësia, të cilat mund të kenë impakt te ato shtete. Dhe duke luajtur rolin tonë atje, ECA promovon qeverisjen e mirë dhe vlerat demokratike'.

Një dimension i munguar në bashkëpunimin ndërkombëtar?

Pavarësisht se ECA është përfshirë në shumë aktivitete të ndryshme në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, të cilat mbulonin segmente të ndryshme të auditimit publik, Klaus-Heiner Lehne mendon se ka akoma struktura pontenciale që mund të zhvillohen. 'Aspekti rajonal – pra, rajonet mes Shteteve Anëtare – është akoma i pazhvilluar. Mendoj se kjo është një mangësi, sidomos për shtetet e mëdha. Ky është problem. Jo aq për institucionet rajonale, sa për marrëdhëniet tona me to'. Ai shpjegon: 'Po marr shembull shtetin që unë e njoh më së miri, Gjermaninë. Paratë që vijnë nga BE, në rastet më të mëdha, nuk shpenzohen në nivel federal, por në nivel rajonal të Landeve. Si rezultat, fondet e BE auditohen edhe nga institucionet rajonale të auditimit, që janë plotësisht të pavarura. Pra në situatën aktuale, në rast se neve na duhet informacion nga këto rajone, ne gjithmonë duhet të komunikojmë nëpërmjet SAI-t Gjerman në nivel federal, në vend që të kontaktojmë drejtpërdrejt me audituesit rajonal'.

Si një zgjidhje të mundshme për këtë, Klaus-Heiner Lehne sugjeron përfshirjen e ECA-s si një të ftuar të përhershëm në konferencën e institucioneve rajonale të auditimit, ose gjetjen e një mënyre për t'i integruar institucionet rajonale të auditimit në Contact Commitee. Duke pranuar se do të ishte praktikisht e pamundur të ftoheshin qindra përfaqësues nga të gjithë institucionet rajonale që

ekzistojnë në Shtetet Anëtare të BE-së, ai argumenton se do të ishte e dobishme të shtohej një përfaqësues rajonal në delegacionet e SAI-ve kombëtarë në Contact Commitee.

Ai shton: 'Mund të ngrihet dhe një sekretariat ose një strukturë e përafërt për të bashkëpunuar me institucionet rajonale të auditimit. Kjo gjë do të përmirësonte situatën dhe mendoj se ato do të merrnin pjesë, pasi ato përballen me të njëjtat probleme si ne, sidomos kur bëhet fjalë për fondet që vijnë nga BE, ku ato luajnë një rol të rëndësishëm. Organizimi me anë të një ekipi të veçantë, sikurse ndodh me Contact Commitee, është një mundësi që mund ta konsiderojmë. Për ta përmbledhur, Klaus-Heiner Lehne shton se të pasurit e një strukturë të tillë për shkëmbimin e informacionit do të ndihmonte dhe shmangien e auditimeve të duplikuara, dhe do të siguronte që audituesit publikë në të gjithë BE-në do t'i interpretonin njësoj ligjet e BE-së.

'Kjo është e nevojshme, pasi shumë shpesh unë marr ankesa nga zyrtarë të qeverive rajonale, pasi interpretimi ligjor i institucioneve të tyre rajonale të auditimit ndryshon nga interpretimi ynë'. Dhe: 'Pyetja e tyre e rradhës është nëse ne mund të bëjmë diçka rreth këtij problemi, por, fatkeqësisht, ne nuk mund të ndihmojmë shumë. E vetmja gjë që mund të bëjmë në raste të tilla, është t'u sugjerojmë institucioneve rajonale audituese të na kërkojnë mendim zyrtar mbi pyetje specifike'. Duke qeshur: 'Pastaj, sigurisht, do të ishte në dorë të tyre ta merrnin parasysh ose jo. Do të ishte një ndihmë e madhe njëhsimi i te kuptuarit të rregullave të BE-së, për të evituar opinione që bien ndesh ose pozicionime të kundërta midis ECA-s, SAI-ve kombëtare dhe institucioneve rajonale audituese. Pra, besoj se koordinimi duhet të përmirësohet, pasi situata aktuale nuk ndihmon.

Dyer të hapura dhe entuziazëm

Klaus-Heiner Lehne nuk ka dyshim se vizitat e tij në kryeqytetet e BE-së, si dhe aktivitetet e tjera bashkëpunuese, në të cilat ECA ka marrë pjesë, kanë qenë frytdhënëse. 'Reagimet kanë qenë mjaft pozitive. Unë kam qenë duke predikuar tek të konvertuarit gjithkund. Kudo që kam diskutuar rreth reformës dhe qëllimeve të strategjisë 2018-2020, kam hasur mbështetje.' Ai vazhdon: 'Gjatë dy viteve të fundit nuk kam takuar asnjë ministër të financave ose drejtues te SAI-ve, që të vënë në pikëpyetje qëllimet tona. Të gjithë thonë: "Kjo lëvizje për më shumë auditim performance, ky ndryshim që po bëni është me vend, na ndihmon, na jep më shumë informacion." Pra reagimi ka qenë tej mase pozitiv deri tani, por ne duhet të plotësojmë pritshmëritë'.

Për më tepër, ai thotë: 'Bashkëpunimi midis SAI-ve garantohet nga vetë Traktati, por duhet të funksionojë në praktikë gjithashtu. Skeptikët mund të thonë se trupat kombëtare reagojnë vetëm kur kanë interesa të vetat. Por, bazuar në eksperiencën time, kjo nuk është e vërtetë'! Ai shton: 'Edhe në rast se kjo do të ishte çështja, bashkëpunimi realisht funksional karakterizohet nga përfitimi i ndërsjelltë i të dyja palëve. Pra, po, mendoj se aktivitetet e bashkëpunimit ndërkombëtar të ECA-s po funksionojnë shkëlqyeshëm. Dhe kjo është veçanërisht e vërtetë për bashkëpunimin midis 29 SAI-ve

të BE-së, dhe më specifikisht në kuadër të Contact Commitee'.

Klaus-Heiner Lehne përmbledh: 'Ju gjithashtu mund të shihni se bashkëpunimi po shkon mjaft mirë duke parë mjaft grupe pune – dhe goxha produktivë – nga organizata ndërkombëtare në të cilat ECA është e përfshirë. Ne jemi të pozicionuar më së miri, sikurse të kualifikuar për të luajtur rolin dhe për të dhënë kontributin tonë'. Ai i referohet pjesëmarrjes së ECA-s në komisionet e INTOSAI ose, për shembull, në seksionin e tij rajonal Europian, EUROSAI. 'Këto janë rrjete të gjëra, në të cilat SAI-t nga e gjithë bota janë bashkuar për të zhvilluar standartet dhe metodologjitë, për të garantuar ndihmë ndaj institucioneve në vendet në zhvillim, etj. Presidenti i ECA-s thekson se këto organizata drejtojnë mjaft grupe pune me tematika interesante si auditimi dhe etika, komuniki qytetar ose auditimi mjedisor. 'Në këto grupe pune, pjesëtarët e stafit nga institucione të ndryshme diskutojnë çështje auditimi dhe draft rregulla, të cilat më pas ndahen me të gjithë SAI-t e rrjetit. Duke vepruar kështu, ne përpiqemi të promovojmë ndërkombëtarisht parimet thelbësore të auditimit të entiteteve publike dhe të ndihmojmë SAI-t e tjerë të luajnë rolin e tyre duke garantuar fakte domethënëse për qytetarët e tyre.

Përktheu: Delor Prosi
Drejtoria e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Klaus Heiner Lehne, President, ECA. Botuar në nr.11, Nëntor/Dhjetor 2018, ECA Journal.

AUDITIMI I SDG-ve: SFIDAT DHE MUNDËSITË PËR SAI-t

ROLI I INTOSAI-t NË MBËSHTETJEN E SAI-ve PËR IMPLEMENTIMIN E SDGs

Zbatimi i suksesshëm i Axhendës 2030 dhe SDG mund të kenë sukses vetëm nëse institucionet janë efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse.

Nga: Gjykata Austriake e Auditimit, Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t.

Botuar në Revistën e EUROSAI-t

Kanë kaluar tre vjet kur shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë miratuar Axhendën 2030 për Zhvillimin dhe Objektivat e Qëndrueshme (SDGs). Kjo axhendë gjithëpërfshirëse dhe ambicioze ofron mundësi të mëdha, por gjithashtu sfida për Institucionet Supreme të Auditimit.

Për shkak të fushëveprimit të gjerë të SDG-ve, shumë prej çështjeve që ata adresojnë i takojnë fushës së kompetencave të auditimit të SAI-ve.

Për këtë arsye, komuniteti i SAI-ve ka punuar shumë për të rritur ndërgjegjësimin për kontributin që mund të japin SAI-et për rishikimin dhe ndjekjen e procesit të implementimit të SDG-ve dhe synimin e INTOSAI-t në mbështetje të SAI-ve në këtë detyrë të rëndësishme.

Qasja e INTOSAI-t për zbatimin e SDGs

INTOSAI i jep rëndësi të madhe rolit të SAI-ve në zbatimin e Axhendës 2030, ku veçanërisht është e dukshme në Planin Strategjik të INTOSAI-t për periudhën 2017-2022, për shkak të një prej pesë prioriteteve ndërsektoriale të këtij Plani Strategjik "Kontributi në përcjelljen dhe shqyrtimin e SDG-ve në kontekstin e përpjekjeve specifike të zhvillimit të qëndrueshëm të secilit vend dhe të mandateve individuale të SAI-ve ".

Në këtë kontekst, Plani Strategjik identifikon katër qasjet, ku SAI-t mund të japin kontribute të vlefshme për zbatimin e SDG:

I. Vlerësimi i gatishmërisë së sistemeve kombëtare për të raportuar mbi progresin drejt arritjeve të SDG-ve;
II. Kryerja e auditimeve të performancës që shqyrtojnë programet e qeverisë që kontribuojnë në SDG;
III. Vlerësimi dhe mbështetja e zbatimit të SDG 16, i cili parashikon institucione transparente, eficiente, të përgjegj-

shme dhe që është me rëndësi të veçantë për SAI-t; dhe

IV. Duke qenë modele të transparencës dhe llogaridhënies në operacionet e tyre, përfshirë auditimin dhe raportimin.

Këto katër qasje u diskutuan gjithashtu nga pjesëmarrësit e Kongresit XXII INTOSAI (INCOSAI), i cili u zhvillua në Abu Dhabi në dhjetor 2016. Si rezultat i këtyre diskutimeve, INCOSAI vendosi në Deklaratën e Abu Dhabit që kornizat për zbatimin e të katër qasjeve do të zhvillohen deri në INCOSAI pasardhës në vitin 2019.

Sfidat dhe mundësitë

Përvojat e para që SAI-t kanë deri tani tregon se përfshirja e tyre në zbatimin e Axhendës 2030 përfshin si sfida ashtu dhe mundësi.

Për shembull ata kanë evidentuar se:

- SAI-t që kryejnë auditimet e SDG përballen me një diversitet të gjerë në mandatet, kapacitetet dhe burimet e tyre;
- Në shqyrtimin e zbatimit të SDGs, SAI-t përballen me sfidën e kryerjes së auditimeve që shkojnë përtej auditimit tradicional financiar dhe përputhshmërisë;
- Qeveritë, si dhe SAI-t, duhet të kenë një qasje holistike kur bëhet fjalë për zbatimin ose shqyrtimin e zbatimit të SDG-ve;
- Aktorët e ndryshëm kanë pritshmëri të mëdha në lidhje me rolin e SAI-ve në zbatimin e SDG-ve;
- Auditimet e koordinuara ofrojnë mundësi të vlefshme për shkëmbimin e përvojave dhe njohurive.

Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave dhe për të rritur ndërgjegjësimin, INTOSAI po mbështet SAI-t përmes një numri nismash.

Iniciativat dhe aktivitetet e INTOSAI-t

Iniciativa për Zhvillimin e INTOSAI (IDI) dhe Komiteti i Shpërndarjes së Informacionit INTOSAI (KSK) kanë nisur një program të përbashkët për "Auditimin e Zbatimit të SDGs", i cili synon të mbështesë SAI-t në përpjekjet e tyre për të kryer auditime bashkëpunuese të performancës në SDG. Aktualisht, tashmë më shumë se 70 SAI janë duke kryer auditime të performancës bazuar në ISSAI dhe një përgatitje bazuar në një qasje të tërë qeveritare. Nëpërmjet këtyre kontrolleve, SAI-t shprehin gjithashtu angazhimin e tyre për realizimin e Deklaratës së Abu Dhabit duke zbatuar qasjen INTOSAI I “Auditimi i gatishmërisë së qeverive kombëtare për zbatimin e SDG-ve". Në vitin 2019 do të publikohet një përmbledhje e gjetjeve të auditimit qendror në bashkëpunim me OKB.

Për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit ndërkombëtar, Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t organizoi dy aktivitete në kuadër të Forumit Politik të Nivelit të Lartë të OKB-së për Zhvillimin e Qëndrueshëm në Nju Jork. Ngjarja e parë në vitin 2016 adresoi "Kontributin e SAI-ve për të siguruar që askush nuk ka mbetur prapa në implementimin e SDG-ve" dhe i dyti në vitin 2018 iu kushtua "Përvojave të SAI-ve në zbatimin e SDG-ve". Në kuadër të aktivitetit të dytë, rezultatet e para të auditimeve të SDG u prezantuan dhe u diskutuan nga përfaqësues të lartë të SAI-

ve, të OKB-së, qeverisë dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Për më tepër, IDI dhe OKB organizuan së bashku dy aktivitete "Lidershipi dhe takimet e palëve të interesave të SAI-ve" dhe "Kontributet e SAI-ve në SDG-të" në vitin 2017 dhe 2018. Këto aktivitete synonin shkëmbimin e njohurive dhe përvojave të SAI-ve nga të gjitha rajonet INTOSAI përkundrejt fushës së IDI-KSK "Auditimi i programeve të SDG".

Përveç kësaj, Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t i kushton rendësi të veçantë aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve, të organizuara bashkërisht nga INTOSAI dhe OKB me përfshirjen e SAI-ve.

Simpoziumi i 24-të, në qershor 2017 u përqendrua në pyetjen se si SAI mund të kontribuojë në zbatimin e SDG-ve në mënyrën më të mirë të mundshme. Gjithashtu, Simpoziumet e ardhshme të UN / INTOSAI (deri në vitin 2030) do t'i dedikohen rregullisht SDG-ve.

Në mënyrë që të mbështetet SAI dhe të siguroj auditime të një cilësie të lartë janë krijuar grupe pune të INTOSAI-t si:

- Grupi i punës për auditimin mjedisor;
- Grupi i punës mbi treguesit kryesorë kombëtar;
- Grupi i punës për vlerën dhe përfitimet e SAI-ve;
- Nën komiteti i Auditimit të Performancës;
- Nën komiteti për Standardet e Kontrollit të Brendshëm të cilët aktualisht janë duke integruar SDG-të në punën e tyre dhe duke zhvilluar mjete dhe produkte të lidhura me SDG-në.

Rezultatet e para të auditimeve të SDG

Shumë SAI, anembanë botës kanë filluar tashmë auditimet e performancës për tema që kanë të bëjnë me SDG-të dhe auditimet mbi gatishmërinë e qeverive kombëtare për të zbatuar SDS-të. Veçanërisht auditimet e gatishmërisë në përputhje me Qasjen I (e parë) të INTOSAI kanë një rëndësi të veçantë në këtë fazë të parë të zbatimit të SDG. Auditimet e tilla të gatishmërisë nuk janë auditimet "tipike" që zakonisht kryejnë (ato tradicionalisht kryhen thjesht ex post). Në kuadër të këtyre auditimeve, SAI mund të marrë një funksion të rëndësishëm këshillues. Prandaj, një rishikim i hershëm i mekanizmit kombëtar të zbatimit është veçanërisht i rëndësishëm pasi rekomandimet tona mund të ofrojnë stimuj të rëndësishëm për qeveritë tona kombëtare në lidhje me zbatimin e ardhshëm të Axhendës 2030 dhe SDGs.

Përvojat tona të para tregojnë se në shumicën e rasteve SAI-et kanë parë reagime pozitive nga qeveritë e tyre kombëtare. Për shembull, ata mund të nxisin qeveritë të veprojnë nga pyetjet e tyre të auditimit dhe ata mund të rrisin ndërgjegjësimin e tyre për rolin e SAI-ve në zbatimin e SDG-ve.

Këto shembuj praktikë tregojnë rolin e rëndësishëm të SAI-ve si institucione të pavarura mbikëqyrëse në sigurimin e qeverisjes së mirë në zbatimin e SDG-ve. Sidoqoftë, ne kemi parë gjithashtu që SAI-et që fillojnë të kontribuojnë në axhendën 2030 përballen me sfida lidhur me mandatin dhe kuadrin ligjor të tyre dhe sfidat që lidhen me kapacitetet, metodologjinë dhe burimet.

Në mënyrë që të mbështetësin SAI-et në përfshirjen e tyre në zbatimin e Axhendës së 2030, është e rëndësishme të mbështes shpërndarjen e njohurive dhe përvojave midis SAI-ve. Për këtë qëllim, Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t publikon raportet e SDG-së tashmë të përfunduara të anëtarëve të INTOSAI-t në faqen e internetit INTOSAI (http://www.intosai.org/about-us/sdgs-sais-and-regions.html). Ky publikim i raporteve të auditimit SDG të SAI-t duhet gjithashtu të kontribuojë për t'i dhënë publikut të gjerë mundësinë për të mësuar rreth rolit të rëndësishëm që po realizon në këtë drejtim.

Konkluzione

Muajt e fundit kanë treguar se SAI-t janë shumë të vetëdijshëm për mundësinë e madhe por edhe për përgjegjësinë që ata kanë në detyrën e tyre për të monitoruar zbatimin e SDGs.

Megjithatë, ekzistojnë disa sfida me të cilat SAI-et ballafaqohen. Vetëm SAI- et e aftë dhe të pavarura në nivel kombëtar do të ndihmojnë në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies dhe në këtë mënyrë do të sigurojnë bazën për rishikimin dhe monitorimin efektiv të zbatimit të SDG-ve.

Synimi i përgjithshëm i INTOSAI-t është të mbështesë SAI-et në dhënien e një kontributi vendimtar në suksesin e Axhendës së vitit 2030, në mënyrë që të ndihmojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve rreth botës.

Përktheu: Elisa Metaj

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Gjykata Austriake e Auditimit, Sekretariati i Përgjithshëm i INTOSAI-t.

QENDRA E GAO-s PËR EKSELENCËN NË AUDITIM NDËRTON NË MBARË BOTËN KAPACITETET PËR MIRËQEVERISJEN

"Institucionet e pavarura dhe profesionale të auditimit janë pjesë jetike e sistemeve të shëndetshme të menaxhimit financiar publik. Kjo marrëveshje do të forcojë bashkëpunimin e ngushtë midis dy institucioneve tona, në mënyrë që të ndihmojë në zhvillimin e institucioneve të auditimit, të cilat janë të afta në luftën kundër korrupsionit, sigurojnë transparencën dhe promovojnë besimin e publikut"

Shkrimi është marrë nga INTOSAI Journal, Dimër 2018, Vol. 46, Nr. 1

Kontrollori i Përgjithshëm i SHBA, z. Gene L. Dodaro, kishte një vizion: krijimin e një ekipi të dedikuar për ndërtimin e kapaciteteve dhe nxitjen efektive të llogaridhënies në shkallë globale.Vizioni i Kontrollorit të Përgjithshëm dhe legjislacioni i miratuar çoi në krijimin e Qendrës së Ekselencës në Auditim (QEA).

QEA, e cila u lançua zyrtarisht nga Zyra për Auditimin e Qeverisë së SHBA në Tetor të vitit 2015 plotëson programet e tjera të ngritjes së kapaciteteve të GAO-s, duke përfshirë edhe Programi Ndërkombëtar të Fellowship-it për Audituesit. Ndërkohë që programi i fellowship-it ofron trajnime në GAO, instruktorët dhe specialistët e projekteve të QEA mund të udhëtojnë në nivel global për të ofruar shërbime në SAI-e të ndryshme.

Nën drejtimin e Drejtorit për Planifikimin Strategjik dhe Marrëdhëniet me Jashtë të GAO-s, z. James-Christian Blockwood, QEA ofron trajnime dhe asistencë teknike me pagesë, të dizajnuara për të ndihmuar organizatat në përmirësimin e performancës dhe transparencës, si dhe për të siguruar përdorimin e mirë të fondeve publike.

Të angazhuar për avancimin e vizionit të Kontrollorit të Përgjithshëm, QEA bashkëpunon me organizatat të ndryshme për të gjetur metoda me kosto efektive dhe eficiente në dhënien e mbështetjes për ngritjen e kapaciteteve dhe forcimin e llogaridhënies efektive.

Stafi me shumë përvojë i QEA, i përbërë nga ish-profesionistë të nivelit të lartë të GAO-s, fokusohet tek ngritja e kapaciteteve organizative, mentorimin dhe trajnimin si shërbime bazë dhe shfrytëzon njohuritë dhe përvojën e stafit për të ofruar programe dhe nisma kryesore që përfshijnë:

- Kryerjen e vlerësimeve të nevojave për identifikimin e fushave, në të cilat institucionet e auditimit mund të forcojnë politikat dhe procedurat,

aftësitë si dhe zbatimin e standardeve të INTOSAI-t;

- Ofrimin e një game të gjerë kursesh trajnimi për audituesit në tema të tilla si auditimet e performancës, dëshmitë e auditimit, metodologjitë e auditimit, të shkruarit e raporteve të auditimit dhe kontrollin e brendshëm;
- Mentorimin dhe trajnimin e grupeve të auditimit në kryerjen e llojeve të ndryshme të auditimeve duke përdorur mjete dhe teknika të provuara;
- Menaxhimin efektiv të procesit të auditimit dhe ofrimit të auditimeve me cilësi të lartë;
- Rritjen në mënyrë efektive të aftësive drejtuese dhe mbikëqyrëse të auditimeve;
- Zhvillimin, zbatimin dhe ridizenjimin e politikave për kapitalin e burimeve njerëzore, strategjive, planeve strategjike dhe kornizave të sigurimit të cilësisë; dhe
- Zhvillimin dhe zbatimin në mënyrë efektive të strategjive për bashkëpunimin me organet e mbikëqyrjes legjislative, mediat dhe qytetarët.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të institucioneve supreme të auditimit dhe çuarjen përpara të llogaridhënies në nivel global, vendosja e marrëdhënieve me organizatat kryesore partnere është një strategji e rëndësishme e QEA. Në vitin 2016, QEA nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi (MOU) me Agjencinë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

"Institucionet e pavarura dhe profesionale të auditimit janë pjesë jetike e sistemene të shëndetshme të menaxhimit financiar publik. Kjo marrëveshje do të forcojë bashkëpunimin e ngushtë midis dy institucioneve tona, në mënyrë që të ndihmojë në zhvillimin e institucioneve të auditimit, të cilat janë të afta në luftën kundër korrupsionit, sigurojnë transparencën dhe promovojnë besimin e publikut", theksoi z. Dodaro gjatë ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjes me USAID.

Gjatë tre viteve të para, QEA ka përjetuar rritje të kërkesave për shërbimet e saj, si nga organizata kombëtare ashtu edhe organizata ndërkombëtare, duke ofruar shërbimet e saj për dhjetëra organizata në SHBA dhe institucione auditimi në gjashtë vende. Projekte të tjera me SAI nga vende të ndryshme janë në proces.

Që prej nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit me USAID-in, QEA ka kryer një vlerësim për të identifikuar nevojat kryesore në ngritjen e kapaciteteve të një SAI në Afrikë dhe kohët e fundit nënshkroi një marrëveshje trevjeçare me USAID-in për të ndihmuar në forcimin dhe përmirësimin e performancës të aftësive audituese të një SAI në Azi, në të cilin stafi i QEA do të zhvillojë trajnime, do të mentorojë auditues dhe do të ofrojë mbështetje për iniciativa të tjera institucionale për ngritjen e kapaciteteve.

Në vitin 2018, QEA ndihmoi një SAI të BE-së për të vlerësuar dhe përmirësuar procesin për dokumentimin e rezultateve të auditimeve financiare. Specialisti i projektit të QEA, një ekonomist dhe një ish drejtor i GAO, me njohuritë e tyre të konsiderueshme në fushën e sipërcituar dhe nëpërmjet zhvillimit të një marrë-

dhënie të mirë pune me stafin e SAI-t ndihmuan që projekti të jetë i suksesshëm. QEA kohët e fundit ka ndihmuar një SAI në Amerikën Qendrore në përmirësimin e kapaciteteve për kryerjen e auditimeve të performancës. Një specialisti projektesh i QEA me shumë përvojë, i cili flet rrjedhshëm spanjisht ka ofruar disa kurse trajnimi, ka ndihmuar SAI-n në përditësimin e manualit të auditimit të performancës dhe ka trajnuar një ekip auditimi në kryerjen e një auditimi, çka është vlerësuar shumë nga niveli drejtues i SAI-t dhe nga subjekti i audituar. "Progresi i arritur në tre vitet e fundit është jashtëzakonisht frymëzues dhe kjo na frymëzon të shohim përpara për të zgjeruar shërbimet tona dhe shtuar ofertë për kurse të ndryshme " – është shprejur znj. Janet St. Laurent, Drejtor i QEA.

Në nivel kombëtar, agjencitë e auditimit janë asistuar dhe riasistuar nga QEA në përmirësimin e njohurive për auditimin, rritjen e njohurive mbi standardet për evidencat dhe forcimin e aftësive të supervizimit në rishikimin e draftit të raportit të auditimit.

Vlerësime nga organizatat dhe individët që kanë ka marrë mbështetjen dhe trajnimin e QEA janë në mënyrë të vazhdueshme të një niveli superior, duke përfshirë këtu dhe relvancën e rëndësisë së kurseve dhe efektivitetin e instruktorit. Një i anketuar, që përfaqëson një agjenci auditimit në Shtetet e Bashkuara, e vlerësoi trajnimin e QEA si "investimi më i mirë i bërë ndonjëherë".

Në vitin e ardhshëm, QEA synon të mbajë një volum pune të shëndetshëm në nivel kombëtar përmes vendosjes së theksit tek marrëdhëniet e vazhdueshme me inspektorët e përgjithshëm, organizatat shtetërore dhe lokale të auditimit, si dhe shoqatat profesionale.Planet e brendshme përfshijnë gjithashtu kurse individuale në selinë e GAO-s duke përdorur edhe platformat e regjistrimit online.

Në nivel ndërkombëtar, ekipi synon të vazhdojë të ofrojë shërbime me cilësi të lartë për projektet që janë në proces. QEA planifikon të bëjë një zgjerim në komunitetin e donatorëve dhe SAI-eve për të eksploruar dhe zgjeruar mundësitë e partneritetit, duke përfshirë një MoU me Bankë Botërore.

"QEA dhe kontributet e saj, pa dyshim kane një ndikim të madh. Është nder të jesh pjesë e një ekipi që synon mirëqeverisjen dhe ka mundësitë e aftësinë për ti dhënë formë komunitetit global të auditimit "- ka nënvizuar z. Blockwood.

Për të mësuar më shumë rreth QEA dhe shërbimeve të saj, vizitoni http: // www.gao.gov/resources/centerforauditexcellence/overview ose mund ti telefononi znj. Janet St. Laurent në numrin 202-512-7100

Qendra e Ekselencës në Auditim	
Kush jemi ne	**Arritjet kryesore**
Zyra e auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO) lançoi në Tetor të vitit 205 Qendrën e Ekselencës në Auditim(QAO), e cila synon ofrimin e ndihmës për ngritjen e kapaciteteve dhe nxitjen e përgjegjshmërisë efektive të institucioneve në përmirësimin e performancës, transparencës dhe sigurimin e përdorimit të mirë të fondeve publike.	• "Investimi më i mirë i bërë ndonjëherë!" Reagimet e klientëve demonstrojnë vazhdimisht cilësinë dhe ndikimin e shërbimeve. • Trajnimi dhe asistenca teknike e ofruar për 10 institucione federale, shtetërore dhe lokale në të gjithë SHBA-në gjatë vitit të parë të punës. • Krijimi i partneriteteve strategjike: nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit me USAID dhe implementimi i një marrëveshje shërbimi me Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit. • Ofrimi i trajnimeve, asistencës teknike dhe mbështetjes për 15 organizata dhe 3 vendeve deri në fund të vitit 2017. • Mbështetja e një SAI në rajonin e Amerikën Latine përmes marrëveshjes me Korporatën e Sfidës së Mijëvjeçarit. • Përmes partneritetit të USAID-it, QEA kreu vlerësim për të identifikuar nevojat kryesore të një SAI në Afrikë për ngritjen e kapaciteteve. • Zgjerimi i shërbimit në 2018 çoi në rritjen e konsiderueshme të veprimtarisë në nivel ndërkombëtar, duke zbatuar edhe projektin e parë si pjesë e partneritetit me USAID-in. • Është nënshkruar marrëveshja 3-vjeçare me USAID-in për të ndihmuar përforcimin dhe përmirësimin e auditimit të performancës në një SAI në Azi. • QEA ndihmoi një SAI evropian në vlerësimin dhe përmirësimin e procesit të dokumentimit të rezultateve të auditimeve financiare.
Çfarë bëjmë ne	
• Kryerjen e vlerësimeve të nevojave për identifikimin e fushave në të cilit institucionet e auditimit mund të forcojnë politikat dhe procedurat, si dhe aftësitë si dhe zbatimin e standardeve të INTOSAI; • Ofrimin e një game të gjerë kursesh trajnimi për audituesit në tema të tilla si auditimet e performancës, dëshmitë e auditimit, metodologjitë e auditimit, të shkruarit e raporteve të auditimit dhe kontrollin e brendshëm; • Mentorimin dhe trajnimin e grupeve të auditimit në kryerjen e llojeve të ndryshme të auditimeve duke përdorur mjete dhe teknika të provuara; • Menaxhimin efektiv të procesit të auditimit dhe ofrimit të auditimeve me cilësi të lartë; • Rritjen në mënyrë efektive të aftësive drejtuese dhe mbikëqyrëse të auditimeve; • Zhvillimin, zbatimin dhe ridizenjimin e politikave për kapitalin e burimeve njerëzore, strategjive, planeve	

strategjike dhe kornizave të sigurimit të cilësisë; dhe • Zhvillimin dhe zbatimin në mënyrë efektive të strategjive për bashkëpunimin me organet e mbikëqyrjes legjislative, mediat dhe qytetarët.	• Reagimi dhe vlerësimi i klientëve ka qenë i një niveli superior dhe trajnim i ofruar cilësor dhe efektiv.

Përktheu: Alma Shehu, Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

AUDITIMI I PERFORMANCËS, SI PJESËMARRJE E QYTETARËVE NË AUDITIMET E KLSH

Gara ndërkombëtare, në rastin tonë vrapi për të kapur finishin e integrimit evropian është bash si ajo përzgjedhja natyrore apo teoria "Red Queen" e evolucionit, sipas të cilës "duhet të vraposh për të qëndruar në vend. Nëse do të ecësh përpara, duhet të vraposh dyfish".

Nga: Sali Agaj dhe Redi Ametllari, Auditues, KLSH

Botuar në INTOSAI Journal, Dimër 2018

Në kushtet e globalizimit nuk është më e mundur që një vend të qëndrojë në "ineficiencën" e tij. Gara ndërkombëtare, në rastin tonë vrapi për të kapur finishin e integrimit evropian është bash si ajo përzgjedhja natyrore apo teoria "Red Queen" e evolucionit, sipas të cilës "duhet të vraposh për të qëndruar në vend. Nëse do të ecësh përpara, duhet të vraposh dyfish".

Tradicionalisht auditimi përqendrohej në saktësinë dhe rregullshmërinë e regjistrimeve bazuar në standardet kontabile e financiare. Në sferën e auditimit publik, metoda tradicionale verifikon gjithashtu zbatimin e ligjeve dhe rregullave financiare. Kjo metodë mbizotëroi për shekuj deri në vitet shtatëdhjetë të shekullit të XX. Në këtë periudhë, organet legjislative të disa vendeve të përparuara industriale filluan të shtronin atë pyetjen "ekziste-nciale": a e kemi nxjerre vlerën e parave të shpenzuara? Si pasojë lindi disiplina e Auditimit të Performancës, për t'i ofruar qytetarit një informacion të ri, një gjurmim deri në destinacionit final të asaj se çfarë vlere është përfituar. Pse? Sepse paraja e shpenzuar në përputhje me ligjet dhe kuadrin financiar nuk do të thotë që qytetari ka përfituar vlerën për paranë e shpenzuar. Ish-Kryetari i Gjykatës Sllovene të Auditimit, z. Igor Soltes, që aktualisht vepron si raportuesi për Kosovën në Parlamentin Europian, gjatë Konferencës së IV Shkencore të KLSH me temë "Analiza e Riskut", solli në kumtesën e tij shembullin e një fshati të Siçilisë, që përfitoi një grand nga BE për të ndërtuar një ashensor që do të lidhte fshatin me një manastir në majë të një kodre, me qëllim promovimin e turizmit. Por, ashensori nuk funksionoi kurrë për shkak se bashkia nuk mund të përballonte koston vjetore prej 100.000

euro për operimin e saj. Pra, ligjshmëria nuk mjafton kur investimi në fakt rezulton të jetë "shterpë" për qytetarin.

Për auditimet, por edhe produkte që nxjerrin institucionet e tjera publike, qëllimi natyrisht është shërbimi ndaj qytetarit. Por, ky togfjalësh "shërbimi ndaj qytetarëve" është si një ekuacion që vështirë të deshifrohet në realitet, e jo më të ndihet realisht nga qytetari. Në auditimet tradicionale të Institucioneve Supreme të Auditimit, si ai i përputhshmërisë dhe ai financiar, kontakti me qytetarin has pengesa të shumta, kjo për shkak të teknikaliteteve që shoqërojnë auditime të tilla.

Së pari, profesionalizmi i audituesit e bën leksikun e tij të vështirë të kuptohet nga qytetari. Terminologjia por edhe fushat që preken nga këto auditime, duhet të hyjnë në filtrat mediatike dhe parlamentare për të arritur në mënyrë precize, të kuptueshme dhe të qartë tek qytetari.

Së dyti, temat audituese burojnë nga një detyrim kushtetues për të audituar veprimtarinë ekonomiko-financiare të vendit, pra është një cikël i vazhdueshëm, apo një rrotullim i natyrshëm i KLSH-së në orbitën kushtetuese.

Pra, të dyja auditimet, që janë me peshë dhe shërbejnë si shfryrje nga korrupsioni i sektorit publik, ngelin në këtë gjendje agregate të ngurtë, për të cilat KLSH përkujdeset që përmes bashkëpunimit me mediat, Parlamentin dhe OJQ-të t'i sinkronizojë me frekuencën e mesazhit që qytetari kërkon të dëgjojë.

Tek auditimi i performancës, kontakti me qytetarin vendoset që në ngjizjen e auditimit, pra në përzgjedhjen e temës. Në dallim nga dy auditimet e klasike, omnipotenca që na jep Kushtetuta është jo burim i temave audituese, por një divizë besueshmërie. Temat audituese burojnë nga vet qytetari dhe problemet sociale në vend. Shkurt, është qytetari ai që përmes ankesave të tij merr në një farë mënyrë vendimin për të audituar një temë që kapërcen shifrat dhe vargun e numrave të ligjeve dhe VKM-ve për të shkuar direkt në epiqendrën e saj se çfarë e ka shkaktuar këtë problem social. Kjo zhdërvjelltësi e kthen performancës në një auditim "atletik" për shkak se ka hapur horizonte të reja në Kontrollin e Lartë të Shtetit, duke zgjeruar spektrin e tematikave audituese për të sjellë një vlerë të shtuar edhe në fusha me karakter të theksuar social, që kanë qenë të paarritshme nga format e tjera të auditimit. Kështu, "ankorimi" i KLSH-së edhe në fusha problematike që shqetësojnë shoqërinë shqiptare si çështja e ish-të përndjekurve politikë, për ndihmën ekonomike, Matura 2016, siguria ushqimore, shërbimet spitalore, etj., flasin për një zhvendosje të KLSH-së në krah të qytetarit, i cili thirret drejtpërdrejt në auditim përmes pyetësorëve.

Vlen për t'u theksuar se Auditimi i Performancës gjithashtu ka krijuar një standard të ri komunikimi me subjektin e audituar. Në takimet prezantuese, ku i njohim autoritetet e larta të institucionit, përfshirë ministra dhe kryebashkiakë, me temën e auditimit të performancës, pyetja që u shtrojmë nuk është "çfarë është bërë gabim", por "çfarë mund të bëjmë mirë". Në këtë kuadër, sinergjia që krijohet mes KLSH-së dhe institucionit përgjegjës bën që raporti i KLSH-së të jetë më konsensual.

Në dy format klasike të auditimit, që janë më të konturuara, më të fiksuara, të qenit një kontabilist apo jurist merr dhe jep ose vepron mbi një kornizë të fiksuar. Por, në performancë, nuk kemi një kornizë, por një skicë të cilës i duhet edhe pak histori dhe letërsi për t'i dhënë formë, pra sfidat për një audites performance janë më të mëdha.

Auditimi i Performancës ka sot një moshë 7 vjeçare në KLSH dhe lindi jo si një ornament, por si një vrap maratonomaku për të kapur kohën moderne të simotrave evropiane. Ky auditim do të konceptohej si profil institucional që në projekt-idenë e Kryetarit z. Bujar Leskaj, gjatë prezantimit si kandidat i nominuar për Kryetar të KLSH në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, në nëntor 2011"... Auditimi i Performancës do të konceptohet si një filozofi e të menduarit dhe e të vepruarit nga i gjithë stafi i KLSH-së. Një filozofi pune kjo që konsideron se kontrolli nuk është një qëllim në vetvete, por është një instrument parandalimi ndaj korrupsionit dhe abuzimit me pronën shtetërore dhe një instrument korrigjimi e këshillimi i institucionit që kontrollohet. KLSH-ja është përpara sfidës për ta përqendruar punën tek auditi i performancës, sepse i shërben vlerësimit të përgjegjshmërisë publike".

Kësodore, përpos të qenit një auditim, performanca përbën një kulturë menaxheriale, një gardian pararojë në luftën ndaj anti-kulturës së korrupsionit. Fatkeqësisht, Shqipëria është ende prapa në zbatimin e një buxhetimi bazuar në performancë (pra në rezultate) dhe vijon traditën e përdorimit të një buxheti historik. Buxhetimi bazuar në performancë është një mjet për t'u premtuar taksapaguesve më shumë vlerë për paratë e shpenzuara ose si një mjet për të shkurtuar shpenzimet publike për t'i hapur rrugë fondeve duke pasur parasysh prioritetet e matshme dhe të vlerësuara në bazë të eficencës, efektivitetit dhe ekonomicitetit. Kjo shmang atë fenomenin e njohur se paraja shkon pas projekteve në vend që projektet të konkurrojnë për paranë, duke krijuar kështu vatra të korrupsionit.

Por fundja, çka identifikohet si korrupsion apo krizë ekonomike, është pikërisht mungesa e kulturës së performancës. Kësodore, më shumë sesa për vet KLSH-në, ky auditim përbën një reformë kombëtare pasi sjell një qasje të re menaxheriale, për t'i hequr sektorit publik mallkimin e "Sizifit" ku pas çdo ngjitje të gurit-reformë vjen tatëpjeta, por sfilitja dhe mundi është i taksapaguesve.

Nga: Sali Agaj dhe Redi Ametllari, Auditues, KLSH

SIGMA MBËSHTET INSTITUCIONET PUBLIKE DREJT ANËTARËSIMIT NË BE

Tipari specifik i programit SIGMA është që ne të punojmë në fushat horizontale të administratës publike: zhvillimin e politikave dhe koordinimin, menaxhimin e shërbimeve publike dhe burimeve njerëzore, llogaridhënien e administratës, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e financave publike, përfshirë prokurimin publik dhe auditimin e jashtëm dhe kuadrin strategjik të reformës së administratës publike.

Nga: Bianca Brétéché, Programi SIGMA në OECD, botuar në ECA Journal, nr.08-09, gusht/shtator, 2018

Kur ju vëzhgoni nga afër ngritjen e kapaciteteve në vendet kandidate, një emër që ju vjen ndërmend është SIGMA, një nismë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Bashkimit Evropian, financuar kryesisht nga BE. Çfarë bën SIGMA aktualisht, përfshirë auditimin dhe si lidhet me aktivitetet që ECA ndërmerr me Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) në vendet kandidate dhe para-kandidate, Bianca Brétéché, Këshilltare e Lartë për menaxhimin e financave publike dhe auditimin e jashtëm në programin SIGMA në OECD, përgjigjet për këto pyetje, si edhe pse zhvillimi i SAI-ve është i rëndësishëm.

Sfida e transformimit institucional

SIGMA - këto pesë letra të vogla lidhen me *"Mbështetje për Përmirësimin e Qeverisjes dhe Menaxhimin"*dhe janë emri i një nisme të suksesshme dhe një iniciative të përbashkët e afatgjatë midis OECD-së dhe BE-së për më shumë se 25 vjet. Që kur unë iu bashkova këtij programi dhjetë vjet më parë, kam ndjerë privilegjin të kem mundësinë të punoj në mjedisin ndërkombëtar të ofruar nga OECD në një nga qytetet më të bukura në botë: Paris! Për më tepër, duke punuar në fushën më interesante dhe jashtëzakonisht të dobishme të bashkëpunimit ndërkombëtar për qeverisjen publike dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale për integrimin në BE.

Pas rënies së murit të Berlinit, ndarjes së Bashkimit Sovjetik dhe rënies së perdes së hekurt, kur u hap dera për integrimin e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore në BE, shumica e organizatave ndërkombëtare po shikonin mundësitë e tyre për të ndihmuar këto vende me reformat e nevojshme ekonomike. Por OECD dhe Komisioni Evropian ishin të bindur se një nga sfidat më të mëdha për transformimin e këtyre vendeve do të ishte ajo institucionale. Me këtë bindje, ata

krijuan programin SIGMA në vitin 1992 për të ndihmuar vendet të transformonin dhe reformonin administratat e tyre publike, për t'i përgatitur ata jo vetëm për t'u bërë anëtarë të BE, por për të qenë anëtarë të fortë dhe të besueshëm.

Burimi: OECD

Rëndësia e shkëmbimit të eksperiencës mes kolegëve

Tipari specifik i programit SIGMA është që ne të punojmë në fushat horizontale të administratës publike: zhvillimin e politikave dhe koordinimin, menaxhimin e shërbimeve publike dhe burimeve njerëzore, llogaridhënien e administratës, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e financave publike, përfshirë prokurimin publik dhe auditimin e jashtëm dhe kuadrin strategjik të reformës së administratës publike. Disa vjet më parë, së bashku me Komisionin Evropian, ne kemi zhvilluar "Parimet e Administratës Publike" dhe një kornizë matjeje që lejon vlerësimin e progresit në reformën e administratës publike ndaj këtyre Parimeve.

Ne punojmë bazuar në shkëmbimin e eksperiencës mes kolegëve, që do të thotë se të gjithë këshilltarët e lartë të SIGMA-s kanë përvojë të gjatë në praktikë në reformën e administratës publike, në një shtet anëtar të BE-së. Disa nga kolegët tanë sot vijnë nga vendet që u bashkuan me BE në vitin 2004 ose ne vitin 2007 dhe sjellin përvojën e tyre personale në procesin e integrimit në BE të vendeve të tyre.

Personalisht, unë jam nga Gjermania, e lindur, rritur dhe edukuar në pjesën perëndimore. Pas trajnimit tim në fushën ligjore, unë u bëra një nëpunëse civile në një nga landet gjermane, Brandenburg, vetëm pak vite pas ribashkimit të Gjermanisë. Këtu kam përjetuar sfidat e tranzicionit të administratës publike nga një vend socialist në një treg të hapur. Shumica e kolegëve të mi në Gjykatën e Llogarive të Brandenburgut kishin filluar karrierën e tyre në ish Republikën Demokratike Gjermane. Pas ribashkimit, ata duhet të kuptonin modelin krejtësisht të ndryshëm shtetëror të Gjermanisë Perëndimore, të familjarizoheshin plotësisht me një grup ligjesh dhe rregulloresh të reja dhe t'i zbatonin ato në mënyrë korrekte në punën e tyre të përditshme. Unë duhet ta pranoj që si avokate e re, e trajnuar në Gjermaninë Perëndimore, në atë kohë shpesh nuk i kuptoja mirë pyetjet e kolegëve të mi, por tani e kuptoj se kjo përvojë më ka ndihmuar shumë për të kuptuar problemet e vendeve kandidate dhe para-kandidate për në BE.

SIGMA dhe auditimi i jashtëm: një bashkëpunim që ka ndikuar jo vetëm në zhvillimin e SAI-ve

Pra, çfarë bën SIGMA dhe si ndihmon ajo për të zhvilluar fuqishëm dhe me efikasitet institucionet e auditimit shtetëror, të aftë për të luajtur rolin e tyre si "gardian" i parave kombëtare dhe të BE-së? Për zonën e auditimit, ne zakonisht kemi 2-3 kolegë për të mbuluar 19 vende (që nga viti 2008 SIGMA gjithashtu punon edhe me vendet fqinje të BE-së). Kjo sigurisht është e pamundur pa ndihmën e një rrjeti të gjerë ekspertësh të jashtëm, ku përfshihen punonjës me eksperiencë nga SAI-të të shteteve anëtare të BE-së ose ECA, si në marrëdhënie pune apo në pension. Së bashku me ne, këta ekspertë udhëtojnë dhe punojnë me kolegët dhe partneret tanë në fusha të tilla si zhvillimi i planeve strategjike, rishikimi i kornizave legjislative, këshillimi për manualet dhe udhëzuesit e auditimit, ofrimi i trajnimeve për çështje specifike të auditimit. Për më tepër, ne ulemi me menaxherët dhe presidentët e SAI-ve për të menduar për mënyrat më të mira për të forcuar rolin e SAI-t në vendet e tyre dhe gjithashtu për procesin e integrimit në BE.

SIGMA gjithashtu vazhdon të mbështesë Rrjetin e SAI-ve të vendeve kandidate dhe para-kandidate, së bashku me ECA-n, përmes organizimit të tryezave të rrumbullakëta, workshopeve dhe trajnimeve. Kjo përfshin studime krahasuese, siç është dokumenti i SIGMA-s mbi *"Zhvillimin e marrëdhënieve efektive të punës midis SAI-ve dhe parlamenteve"*, që kemi hartuar me ndihmën e z. Jan Pieter Lingen, një ish-anëtar i stafit të ECA-s, botuar në vitin 2017.

Interesant është që ky studim është kërkuar të realizohet nga Rrjeti i SAI-ve për qëllimet e tyre, por u morën reagime shumë pozitive edhe nga SAI-t e shteteve anëtare dhe nga komuniteti më i gjerë ndërkombëtar. Kjo tregon se pyetjet e adresuara në këtë dokument dhe në udhëzues, bazuar në përvojat praktike, janë gjithashtu interesante dhe frymëzuese për SAI-t e zhvilluara dhe të maturuara. Kjo është një përvojë që ne e gjejmë shpesh: Procesi i integrimit në BE sjell dhe nxjerr në pah sfidat, me të cilat ballafaqohen vendet anëtare të BE dhe disa nga zgjidhjet e gjetura sot në vendet kandidate të BE dhe potencial kandidate, mund të shërbejnë gjithashtu shumë mirë brenda BE.

SIGMA është sigurisht vetëm një lojtar i vogël mes mbështetjes tjetër të BE-së, si Projektet e Binjakëzimit, Asistenca Teknike dhe TAIEX, Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit të Komisionit Evropian. Por mendoj se përpjekjet e përbashkëta japin fryte: vlerësimi ynë i rregullt i progresit të reformës që është publikuar në faqen tonë të internetit tregon se SAI-t në vendet aktualisht kandidate për në BE dhe potencial kandidate, janë qartë një nga institucionet publike më të forta dhe më të besueshme nga qytetarët. Kjo gjithashtu u jep atyre një mundësi unike për të mbështetur procesin e integrimit në BE me punën e tyre audituese, për shembull duke realizuar auditimet e performancës, që u japin qeverive dhe parlamenteve njohuri

për proceset e rëndësishme të reformave për integrimin në BE.

Sfida e vazhdueshme: nga projektimi në implementim

Sot, më shumë se kurrë, besoj në rëndësinë e institucioneve të forta publike dhe në përgjegjësinë tonë për të ndihmuar vendet që përpiqen të bëhen anëtare të BE-së për të forcuar administratën e tyre publike, duke përfshirë SAI-t.

Kornizat ligjore për institucione të qëndrueshme në shumicën e rasteve janë të konsoliduara tashmë. Sfidat aktuale dhe të ardhshme janë zbatimi i plotë i tyre. Përveç kësaj, ne duhet të vazhdojmë të sigurojmë mbështetje të veçantë për SAI-t në gjetjen e mënyrave të përshtatshme për t'u marrë me mjedisin e tyre ndonjëherë shumë të vështirë politik, si dhe pritshmëritë shpesh të gabuara të parlamenteve dhe qytetarëve të tyre.

Përktheu: Amantja Patozi

Drejtoria e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Bianca Brétéché, Programi SIGMA në OECD

AUDITIMI PUBLIK NË BASHKIMIN EUROPIAN
NJË MANUAL NË PROCES HARTIMI

SAI-t janë një aspekt kyç i kontrolleve dhe balancimeve të shoqërive moderne për të siguruar përdorimin eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve publike. Ato funksionojnë në mënyrë të pavarur në një kontekst shumë politik dhe janë parakushte që një demokraci të funksionojnë siç duhet. Fakti i thjeshtë se ata vlerësojnë veprimtarinë e qeverisë mund të ndikojë pozitivisht në qeverisjen e mirë.

Nga: Derek Meijers, Drejtoria e Presidencës së Gjykatës Evropiane të Audituesve

Botuar në revistën e EUROSAI-t

Në janar 2019, ECA do të publikojë një manual mbi 29 institucionet e larta të auditimit (SAI) në Bashkimin Evropian (BE) dhe Shtetet Anëtare të tij. Derek Meijers, menaxher i projektit për këtë manual, shpjegon arsyet pse u vendos botimi i tij, atë që përmban manuali dhe si do të evoluojë publikimi në vitet e ardhshme.

Një manual mbi 29 SAI në BE dhe në Shtetet Anëtare të saj

ECA do të publikojë një manual të ri mbi 29 institucionet e larta të auditimit të BE-së në fillim të vitit 2019, me titull Auditimi publik në Bashkimin Evropian, i cili do të përmbajë informacion të detajuar mbi statusin, mandatin, organizimin, punën dhe produktet e SAI-ve; si dhe do ilustrojnë dallimet dhe ngjashmëritë midis këtyre 29 institucioneve të auditimit.

Qëllimi i Auditimit Publik në Bashkimin Europian është të ofrojë tek audituesit publikë, akademikë dhe lexues të tjerë të interesuar një përmbledhje praktike për auditimin publik në BE, si në Europë ashtu dhe në nivel Kombëtar. Duke krahasuar informacionin gjithëpërfshirës mbi punën e SAI-ve në BE dhe rolin e tyre në procesin e llogaridhënies, ECA shpreson të kontribuojë në hulumtime të rëndësishme në vazhdim në këtë fushë.

Pse na nevojitet një manual për SAI-t e BE-së?

SAI-t janë institucione thelbësore, veçanërisht në BE, ku ekzistenca e një organi të jashtëm të pavarur të auditimit publik është një parakusht për t'u bashkuar. SAI-t janë një aspekt kyç i kontrolleve dhe balancimeve të shoqërive moderne për të siguruar përdorimin eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve publike. Ato funksionojnë në mënyrë të pavarur në një kontekst shumë politik dhe janë parakushte që një demokraci të funksionojnë siç duhet. Fakti i thjeshtë se

ata vlerësojnë veprimtarinë e qeverisë mund të ndikojë pozitivisht në qeverisjen e mirë. Për më tepër, duke ndihmuar parlamentet të kontrollojnë qeveritë e vendeve të tyre, apo institucionet ekzekutive të BE-së për të përmirësuar politikë-bërjen dhe menaxhimin financiar, SAI-t veprojnë si ofrues të shërbimeve dhe si "gardianë" të pavarur të interesave të qytetarëve. Përveç promovimit të llogaridhënies dhe transparencës në nivel kombëtar, SAI-t e BE-së gjithashtu mbështesin në mënyrë aktive ndërtimin e kapaciteteve të organeve të auditimit publik në vendet e treta.

Shumë nga 29 SAI-t që mbulojnë Auditimin Publik në Bashkimin Europian mund të jenë krenarë për një histori të gjatë dhe të pasur. Ata janë mishërimi modern i funksionimit të auditimit publik, i cili në disa vende daton që nga shekulli i 14-të. Megjithëse strukturat, mandatet dhe metodat e punës së SAI-ve kanë evoluar me kalimin e kohës - ndonjëherë si rezultat i ndryshimeve politike apo reformave të administratës publike, funksioni i tyre kryesor mbetet i njëjtë: të shqyrtojnë financat dhe politikat e qeverive dhe të ndërtojmë besimin.

Shembull i bashkëpunimit të mirë midis ECAs dhe SAI-ve të shteteve anëtare

Neni 287 (3) i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian i bën thirrje ECAs që të bashkëpunojë me SAI-t e të gjitha shteteve anëtare të BE-së "*Në frymën e besimit por duke ruajtur pavarësinë tonë*". Është parim i cili mbështet projekte të tilla, si publikimi i Auditimit Publik në Bashkimin Evropian. Për më tepër, ishte një argument shtesë për përpilimin e raporteve në bashkëpunim me përfaqësuesit e SAI-ve të ndryshme.

Krijimi i manualit - një projekt ambicioz, të cilit iu desh një vit për të përfunduar

Jemi mbështetur për këtë manual nga një botim më i hershëm: Botimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar në vitin 2005, "Auditimi publik në Bashkimin Evropian". Ne jemi veçanërisht mirënjohës për kolegët tanë në Mbretërinë e Bashkuar, të cilët na besuan të vazhdojmë iniciativën e tyre. Ata nuk kishin kundërshtime ndaj propozimit tonë për të nxjerrë një manual për SAI-t e BE-së dhe shteteve të saj. Ne gjithashtu kërkuam pëlqimin e të gjithë anëtareve të BE-së në kuadër të Komitetit të Kontaktit të BE-së.

Pas kësaj, hapi i parë i projektit ishte të vendoste një strukturë dhe përmbajtje të librit dhe cilat detaje duhet ose nuk duhet të përfshihen. Pastaj filluam të mblidhnim informacionet që ishin në dispozicion, për shembull në faqet e internetit të SAI-ve individuale, ose në raportet apo në studime të tjera.

Ne përdorëm këtë informacion për të përpiluar pjesët për SAI-t individuale në lidhje me bazën ligjore, strukturën, burimet, përgjegjësinë e auditimit dhe metodat e punës, si dhe aktivitetin dhe bashkëpunimet e tyre. Në këtë dhe në të gjitha fazat e tjera, ne kryesisht u përqendruam në gjithëpërfshirjen dhe krahasueshmërinë e përmbajtjes.

Hapi i ardhshëm ishte që përmbajtja të ishte e pranuar dhe draft-projekti të ishte i miratuar nga vetë SAI-t. Kjo nuk ishte në

asnjë mënyrë një detyrë e lehtë, pasi mënyra me të cilën ne zgjodhëm të paraqesim informacionin nuk përputhej domosdoshmërisht me mënyrën se si ata kishin bërë botimet e tyre.

E kombinuar me natyrën e pavarur të SAI-ve, kjo shumëllojshmëri nganjëherë çoi në disa diskutime interesante. Trajtimi i disa pikave, të tilla si mandati i një SAI ose viti i krijimit, rezultoi të ishte më i vështirë se sa pritej.

Në përgjithësi, na u desh më shumë se një vit për të përfunduar projektin dhe mund të themi me krenari se rezultati flet vet: ia vlejti përpjekja! Në fund, ne arritëm të prezantojmë materialin tek të gjitha SAI-t në mënyrë të përmbledhur dhe të pakrahasueshme; që rezulton të jetë pa dyshim një nga meritat kryesore të botimit të këtij manuali.

Kontributi në hulumtimin e auditimit publik në BE

Ky manual ilustron që SAI-t e BE-së e konsiderojnë të rëndësishme të jenë transparente në lidhje me punën e tyre dhe t'u sigurojnë qytetarëve informacione të thjeshta, të arritshme dhe të krahasueshme. Në këtë kuptim, ne shpresojmë që botimi ynë të thellojë njohuritë mbi SAI-t e BE-së dhe të inkurajojë institucionet e tyre që të bashkëpunojnë dhe të mësojnë nga njëri-tjetri.

Së fundi, por jo më e parëndësishmja, akademikët dhe hulumtuesit që merren me auditimin publik në BE dhe në shtetet e saj anëtare mund ta gjejnë këtë manual interesant. Libri dhe kërkimi mund të frymëzojë si dhe të ofrojnë udhëzime për audituesit, politikë-bërësit dhe ligjvënësit në të gjithë BE-në dhe më gjerë.

Mbështetur në rëndësinë e këtij botimi, ne gjithashtu synojmë të botojmë manualin online, në 23 gjuhët zyrtare të BE-së, dhe ta përditësojmë atë rregullisht.

Përktheu: Eni Kabashi

Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qëndrore

Nga: Derek Meijers, Drejtoria e Presidencës së Gjykatës Evropiane të Audituesve

PARASHIKIMI PËR TRANSPORTIN DHE LËVIZSHMËRINË: FORCAT, FAKTORËT DHE SFIDAT E SË ARDHMES

Për t'u përgatitur për sfidat që janë përpara, ne nuk mund të mbështetemi vetëm në përvojën tonë, pasi në fund të fundit, performanca e kaluar nuk është domosdoshmërisht indikative për rezultatet e ardhshme. Prandaj, siç u theksua në edicionin e tetorit 2018 të ECA Journal, ECA ka filluar të investojë në parashikimin strategjik.

Nga: Andreas Bolkart, Drejtoria e Presidencës, ECA

Botuar në ECA Journal, nr.1/2019

Një Institucion Suprem Auditimi zakonisht shqyrton gjërat që kanë ndodhur dhe përpiqet të vlerësojë ngjarjet e kaluara për të nxjerrë mësime të vlefshme për të përmirësuar politikat dhe proceset në të ardhmen. Por shikimi prapa nuk është gjithmonë i mjaftueshëm. Për t'u përgatitur për sfidat që janë përpara, ne nuk mund të mbështetemi vetëm në përvojën tonë, pasi në fund të fundit, performanca e kaluar nuk është domosdoshmërisht indikative për rezultatet e ardhshme. Prandaj, siç u theksua në edicionin e tetorit 2018 të ECA Journal, ECA ka filluar të investojë në parashikimin strategjik. Duke vepruar kështu, ajo shpreson të bëjë sot pyetje të drejta, në mënyrë që të mund të ketë përgjigjet e duhura të gatshme kur ato të nevojiten, nesër. Në këtë seksion, ne përpiqemi të marrim në shqyrtim çështjet e parashikimit sa herë që kjo përshtatet me temën e Revistës. Ndalesa e parë: largpamësi për transport dhe lëvizje.

Kohët e fundit, Task Forca e Parashikimit të ECA-së ndërmori një studim të gjerë trendesh, 'ECA trendëatch', bazuar në më shumë se 40 studime të mëdha ndërkombëtare të trendeve dhe në konsultime me më shumë se 60 ekspertë. Në këtë artikull, Andreas Bolkart zgjeron rezultatet e kësaj analize për sektorin e transportit dhe lëvizshmërisë. Ai jep një pasqyrë të forcave dhe faktorëve në punë në këtë sektor dhe diskuton sfidat e ardhshme për analistët e sektorit publik.

Forcat dhe faktorët në punë në transport dhe lëvizshmëri

Sektori i transportit dhe lëvizshmërisë po nxit shumë procese të ndryshimit në shoqëritë evropiane. Ekzistojnë forca të shumta të brendshme dhe të jashtme që vijnë nga ky sektor ose ndikojnë

drejtpërdrejtë mbi të. Më poshtë është një pasqyrë e atyre më të rëndësishmeve.

Forcat e brendshme

- Forca 1: *Rritja e kërkesës për lëvizshmëri* - Vëllimet e transportit të udhëtarëve dhe mallrave në BE kanë qenë në rritje të vazhdueshme në dekadat e fundit. Komisioni Evropian vlerëson se ato do të vazhdojnë të rriten (42% për aktivitetin e transportit të udhëtarëve dhe 60% për transportin e brendshëm midis 2010 dhe 2050).

- Forca 2: *Automjetet autonome* - Automjetet janë gjithnjë e më të pajisura me teknologji të ndihmës që në fund të fundit do të zëvendësojë nevojën për një shofer njerëzor. Kjo vlen për makinat personale, linjat hekurudhore dhe automjetet e ndara, automjetet e transportit publik si autobusët dhe trenat, dhe automjetet e mallrave si anijet e ngarkesave, kamionët dhe dronët e livrimit.

- Forca 3*: Pronësia e përbashkët* - Një popullsi gjithnjë e më urbane është duke luftuar me rritjen e kostos fikse, pasojat dhe dëmet klimatike të pronësisë së makinave personale. Në të njëjtën kohë, mjetet dixhitale bëjnë ndarjen e makinave një alternativë të përshtatshme. Prandaj, pronësia e makinave personale pritet të bjerë në kurriz të modeleve të pronësisë së përbashkët.

- Forca 4: *Elektrifikimi* - Çmimi dhe performanca e baterive të automjeteve po përmirësohen në mënyrë dramatike. E njëjta gjë vlen edhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme. Së fundi, opinioni publik dhe politikat publike gjithnjë e më shumë po favorizojnë motorët elektrikë për shkak të mungesës së emisioneve lokale. Si rezultat, motorët elektrikë gjithnjë e më shumë do të zëvendësojnë motorët me djegie.

- Forca 5: *Mjetet e lëvizshmërisë digjitale* - Mjetet dhe shërbimet e zgjuara, që arrihen shpesh nga pajisjet mobile, përmirësojnë efikasitetin e lëvizshmërisë duke optimizuar rrugët, kohën e udhëtimit dhe kombinimin e mënyrave të ndryshme të transportit. 'Interneti i gjërave' do të përfshijë automjete, mallra të transportuara dhe pajisje të përdorura nga njerëzit në lëvizje.

Forcat e jashtme

- Faktori 1: *Reduktimi i CO2* - Shtetet Anëtare të BE kanë vendosur objektivat për reduktimin e CO2, që kanë çuar në një numër politikash për të reduktuar emetimet e CO2 në kontekstin e transportimit të njerëzve dhe mallrave.

- Faktori 2: *Përmirësimi i shëndetit* - cilësia e dobët e ajrit në qytetet e mëdha është një problem i vazhdueshëm për shëndetin publik. Përveç kësaj, për arsye shëndetësore qytetarët janë gjithnjë e më të gatshëm të kënaqin nevojat e lëvizshmërisë në rreze të shkurtër përmes ecjes ose çiklizmit.

- Faktori 3: *Hapësira e rrezikuar kibernetike* - Sistemet e transportit dhe lëvizshmërisë mbështeten shumë në përpunimin e të dhënave të rrjeteve që janë të pambrojtura. Kjo përfshin kërcënimet për vjedhjen dhe keqpërdorimin e të dhënave personale, si dhe për hakimin, dëmtimin

dhe manipulimin e sistemeve të infrastrukturës.

- Faktori 4: *Afërsia virtuale* - Roli në rritje i blerjeve online, sistemeve të telepranisë, qasjes në distancë dhe aplikacioneve të realitetit virtual është reduktimi i disa prej nevojave për lëvizshmëri të njerëzve. Mundësitë teknologjike përputhen me ndryshimin e modeleve në sjelljen e njerëzve dhe organizatave të tilla si puna përmes telefonit.

- Faktori 5: *Prodhimi i decentralizuar* - Teknologjia e printimit 3D dhe format e tjera të prodhimit lokal dhe përshtatjes po transformojnë modelet tradicionale të prodhimit dhe shpërndarjes. Përveç kësaj, konsumatorët gjithnjë e më shumë po favorizojnë mallrat e prodhuara afër shtëpisë për arsye të mbrojtjes së mjedisit dhe të patriotizmit ekonomik.

Sfidat e ardhshme për hartuesit e politikave të sektorit publik dhe audituesit

Sektori publik është investitori më i madh në infrastrukturën dhe teknologjinë e transportit dhe lëvizshmërisë. Agjencitë e sektorit publik janë gjithashtu vetë sistemet operative të lëvizjes. Sektori publik rregullon shumë transportin dhe lëvizshmërinë për arsye sigurie, mjedisore dhe aksesueshmërie. Së fundi dhe mjaft e rëndësishme, tatimi luan një rol të rëndësishëm tek ndikimi mbi zgjedhjet e lëvizshmërisë. Forcat dhe faktorët e diskutuar në seksionet e mëparshme e bëjnë shumë të vështirë investimin në sektorin publik, rregullimin e operacioneve dhe aplikimin e taksave. Sfidat për veprim të sektorit publik dhe auditimi i tyre janë të shumëfishta. Seksioni në vijim diskuton këto dilema.

E vogël do të thotë e bukur? - Vendimmarrësit e sektorit publik ballafaqohen me zgjedhjen e vështirë midis projekteve të infrastrukturës së madhe klasike dhe projekteve të vogla të rrjetit që janë në rritje. Këto të fundit janë në dispozicion në sajë të teknologjisë së re, por janë gjithashtu shumë të paparashikueshme. Një shembull do të ishte në planifikimin e një qyteti që duhet të zgjedhë midis shtrirjes së një tuneli për trena nëntokësorë ose investimit në një flotë të minibuseve që vetëdrejtohen.

Pronësia individuale apo pronësia e përbashkët? - Në njëqind vitet e fundit, pronësia individuale e makinave ishte një histori suksesi. Kohët e fundit, ky model po bie dhe modelet e pronësisë së përbashkët po dalin. A ka krijuar sektori publik mjedisin e duhur rregullator? Vendimet për investime publike a i marrin parasysh këto ndryshime? Për shembull, hapësirat publike të parkimit tani duhet të reduktohen ose të planifikohen në një mënyrë të tillë që të përdoren më vonë si stacione të përbashkët të automjeteve elektrike.

Ndërtuar për të zgjatur? - Në kohët e zgjidhjeve teknologjike në zhvillim të shpejtë, infrastruktura e madhe publike duhet të jetë e adaptueshme. Kjo do të thotë se planifikuesit duhet të parashikojnë sa më shumë të jetë e mundur ndryshimin e modeleve të lëvizshmërisë, teknologjive të reja dhe

sjelljes së re të përdoruesve gjatë planifikimit të projekteve të infrastrukturës në shkallë të gjerë. Një shembull është një tunel për trenat nëntokësorë që mund të planifikohet në një mënyrë që do të përdoret më vonë për qëllime të tjera të lëvizjes, si një tunel nëntokësor për automjete personale, ose mallrash që drejtohen pa shofer.

PPP ka vdekur? - Projektet e Partneritetit Publik Privat kanë një reputacion jo të mirë kohëve të fundit. Shumë shpesh, duket se nivelet e shërbimit u përkeqësuan dhe investitorët privatë morën përfitimet, por jo rreziqet. Megjithatë, e ardhmja do të ketë më shumë mundësi për bashkëpunim efektiv midis investitorëve privatë dhe ofruesve të shërbimeve publike. Kjo mund të jetë vendimtare për të ardhmen e lëvizshmërisë për të vepruar në të gjithë llojet e transportit, gjeografitë dhe funksionalitetet.

Çmimi a është i drejtë? - Sektori publik përballet me një sërë mundësish për të krediturar mbi përdorimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të mobilitetit publik. Në të ardhmen, çmimi mund të bëhet neutral dhe i varur nga përdorimi i infrastrukturës. Në ditët e sotme, shumica e vendeve paguajnë një taksë fikse për zotërimin e një automjeti. Disa kanë tarifa për përdorimin e autostradës ose hyrjen në zonat e mbingarkesës. Megjithatë, teknologjia e disponueshme do të lejonte kreditimin saktësisht për çdo kilometër të infrastrukturës rrugore të përdorur, duke përfshirë tarifat më të larta për zonat e mbipopulluara ose periudhat e ditës. Përveç kësaj, disa qytete po eksperimentojnë me transportin publik falas.

Mbrojtja e të dhënave apo shfrytëzimi i të dhënave? - Kjo dilemë ekziston në shumë sektorë por është veçanërisht e rëndësishme për lëvizshmërinë. Të dhënat e përdoruesit, siç janë rrugët e udhëtimit, mund të bëjnë goxha punë për të zgjidhur problemet e mbingarkesës dhe për të ofruar shërbime shtesë për përdoruesit. Nga ana tjetër, këto të dhëna gjithashtu lejojnë kontrollin total të vendndodhjes së çdo qytetari. Sektori publik duhet të përcaktojë se si të përdorë dhe të ndajë më së miri të dhënat që gjeneron vetë dhe më pas të rregullojë përdorimin e të dhënave të mbledhura në sferën publike (standardet dhe protokollet e hapura).

Një taksë mbi lëvizshmërinë apo mbi energjinë? - Tatimet mbi forma të ndryshme të lëvizshmërisë janë në ditët e sotme më tepër rezultat i një sërë ngjarjesh historike sesa një proces i projektimit të menduar dhe holistik. Karburantet ose energjia në përgjithësi tatohen shumë ndryshe në mënyrat e ndryshme të transportit dhe shpesh nuk janë fare ose shumë pak të lidhura me ndikimin në emetimet e CO2 ose të ndikimeve të tjera të jashtme. Disa skema stimuluese tatimore aktualisht janë diskriminuese mes formave të ndryshme të lëvizshmërisë, si për shembull nxitja e taksave të kompanive të automjeteve.

Inovacioni përmes rregullimit? - Rregullimi i sektorit publik është tradicionalisht i ngadalshëm në krahasim me inovacionin teknologjik. Megjithatë, kufiri rregullator mund të bëhet një avantazh konkurues në

ekonomitë e përparuara. Rregullatorët duhet të inkurajojnë teknologjitë e reja duke krijuar në fillim kushtet për një adoptim dhe eksperimentim të shpejtë. Kjo vlen për shembull për krijimin e standardeve për automjetet autonome si kamionët dhe dronët. Kushtet e sigurisë në trafikun rrugor duhet të përshtaten me futjen e veturave vetëlëvizëse.

Lidhur me sa më sipër dhe përtej saj

Analistët e sektorit publik dhe audituesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm për këto sfida të ardhshme gjatë vlerësimit të politikave publike dhe programeve në fushën e transportit dhe lëvizshmërisë. Meqenëse ka shumë forca dhe zhvillime të ndryshme për t'u marrë parasysh, ekziston një nevojë e qartë për të vlerësuar rolin e sektorit publik në lëvizjen në tërësi, në vend të izolimit të politikave individuale.

Përktheu : Reinis Xhelili

Drejtoria e Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Andreas Bolkart, Drejtoria e Presidencës, ECA

Info Kontrolli i Lartë i Shtetit

AKTIVITETE TË KLSH-së PËR PERIUDHËN SHTATOR 2018 - SHKURT 2019

KLSH merr pjesë në takimin vjetor të Komitetit për Ngritjen e Kapaciteteve të INTOSAI-t

Në datat 3-6 Shtator 2018, në Kuvajt City u mbajt takimi vjetor i Komitetit për Ngritjen e Kapaciteteve të INTOSAI-t. Ky takim u realizua me mbështetjen dhe bashkëpunimin e Inisiativës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI) dhe Sekretariatin e Donatorëve të këtij Komuniteti Global të Auditimit.Në ditën e saj të parë, konferenca u zhvillua nën moton "Të frymëzojmë dhe inkurajojmë njëri-tjetrin". Fjalën përshëndetëse e mbajti Presidenti i SAI-t Kuvajtian dhe moderatorët të përfaqësuar nga Zv/Kryetari i SAI-t Suedez dhe Presidenti i SAI-t Afrikano-Jugor. Një diskutim mbresëlënës i kësaj dite, ishte ai i përfaqësuesit të Kombeve të Bashkuara, z. Jens Wandel, mbi mundësitë dhe nevojat për rritjen e kapaciteteve.

Foto e realizuar gjatë takimit me Princin e Kurorës së shtetit të Kuvajtit, z. Nawaf Al-Ahmad Al-Jaber Al-Sabah, në të cilin morën pjesë Drejtues të disa SAI-ve dhe përfaqësues të Komunitetit të donatorëve: Audituesi i Përgjithshëm i GAO-s, z. Gene L.

Dodaro; Presidenti i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kuvajtit, z. Adel Al-Sarawi; Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, Presidenti i SAI-t të Hungarisë, z.Laszlo Domokos; Drejtoresha e Përgjithshme e Gjykatës Austriake të Auditimit, zj.Monika Gonzalez-Kross, etj.

Pjesëmarrja e delegacionit shqiptar në këtë aktivitet, të përfaqësuar nga z. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së dhe z. Rinald Muça, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës, u shtri në tri drejtime kryesore, të cilat u realizuan përgjatë ditës së dytë dhe të tretë të konferencës nën motot respektive "Njerëzit të parët" dhe "Përpara sëbashku". Konkretisht:

Në takimin e realizuar nga CBC dhe IDI, ku ishin të pranishëm SAI nga vende të

ndryshme, të zhvilluara dhe në zhvillim të botës, pjesëmarrja e delegacionit shqiptar ishte rrjedhojë e ftesës së NIK-ut polak. Kjo ftesë erdhi në kuadrin e përfundimit me sukses të projektit IPA dhe qëllimi ishte ndarja e eksperiencës së përbashkët me komunitetin e donatorëve dhe SAI-t e tjera mbi shkëmbimin e dijeve dhe ekspertizës përmes proceseve IPA. Së bashku me 4 grupe të tjera, grupi Poloni-Shqipëri prezantoi historikun, rezultatet, sfidat dhe leksionet e nxëna nga bashkëpunimi 2-vjeçar IPA. Prezantimi mori formën e një panairi idesh, ku, në tryeza të rrumbullakëta, të pranishmit shëtisnin midis prezantuesve për të kuptuar, bërë pyetje dhe filtruar ide se cila mund të ishte forma më efektive dhe eficiente për të bashkëpunuar me kolegë të huaj në rritjen e kapaciteteve të institucioneve respektive. Në prezantimin Poloni-Shqipëri, z. Jacek Jezierski, ish-President i NIK-ut polak, e vuri theksin tek rëndësia e përkushtimit të lidershipit në ngritjen e kulturës së ndryshimit të vazhdueshëm brenda institucionit, duke vlerësuar lart rolin e Kryetarit të KLSH-së, z. Bujar Leskaj, si promotor dhe mbështetës i pakompromis drejt kësaj kulture. Zoti Jezierski u shpreh se: "Lidershipi i KLSH-së e kishte të qartë se cilat ishin nevojat institucionale, si duhej adresuar ndryshimi dhe ku duhej shtrirë bashkëpunimi me kolegët polakë. Një vizion i tillë nga lidershipi është premisa parësore dhe guri i themelit në rritjen e kapaciteteve dhe suksesin institucional, drejt një bote që ndryshon vazhdimisht."

Në fjalën e tij, z. Leskaj theksoi se roli i SAI-eve kudo në botë është në rritje dhe SAI-t e vogla duhet të bëjnë çdo përpjekje që ta rrisin edhe më tej këtë rol, duke mësuar nga eksperienca e më të mirëve. "Ne, – nënvizoi z. Leskaj, - jetojmë në realiete dhe të vërteta kontekstuale. Por në fakt, përgjigjet për sfidat që ndeshim në këto realitete janë globale dhe të testuara në masë të madhe nga vendet e zhvilluara. Një nga rrugët më të mira për të kursyer kohë, përmirësuar performancën tonë dhe globalizuar kapacitetet, është bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencës". Prezantimi i grupit Poloni-Shqipëri, i realizuar nga z. Rinald Muça, u prit me mjaft interes dhe pyetje të shumta nga të pranishmit, duke u cituar edhe si "best practice" nga moderatori i panelit, z. Magnus Lindell, Zv/Kryetar i SAI-t suedez.

Së dyti, në frymën e bashkëpunimit të ngushtë dhe miqësor me SAI-n kuvajtian, me të cilin KLSH zhvilloi edhe një konferencë shkencore në Prill të këtij viti, delegacioni shqiptar u prit në mënyrë të posaçme nga Presidenti i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kuvajtit, z. Adel Al-Sarawi. Në këtë takim, u diskutuan dhe u dakordësuan modalitetet mbi konferencën e ardhshme midis dy institucioneve tona, që do të mbahet në Shqipëri, në Pranverën e vitit 2019. Tema e konferencës do të jetë "Pavarësia e auditimit dhe sfidat e qeverisjes së mirë". Pala kuvajtiane bëri një prezantim të hollësishëm të manualit mbi qeverisjen e mirë, manual të cilin e kishin përgatitur dhe promovuar edhe në komunitetin ndërkombëtar, specifikisht me Bankën Botërore dhe Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP). Nga ana tjetër, pala shqiptare bëri një prezantim mbi sfidat e pavarësisë në auditim, si në mjedisin e jashtëm, e fokusuar kjo pavarësi kryesisht në aspektin financiar, ashtu edhe në mjedisin e brendshëm, e përkufizuar më së shumti si sfidë e etikës dhe integritetit në auditim. Ky takim u përmbyll në një atmosferë të ngrohtë e shumë miqësore, ashtu sikurse edhe nisi.

Së fundmi, gjatë kësaj vizite, delgacioni shqiptar u takua dhe forcoi fijet e bashkëpunimit me një sërë delegacionesh të tjera ku vlen të veçohet takimi me Audituesin e Përgjithshëm të GAO-s amerikane z. Gene L. Dodaro dhe stafin e tij, të cilët pritet të zhvillojnë një vizitë në KLSH në fundin e këtij muaji. Po ashtu, nën kujdesin e z. Al-Sarawi dhe z. Dodaro, një grup i vogël personalitetesh, të përbërë nga Presidentët dhe Kryetarët e SAI-eve të pranishme në këtë vizitë, u pritën nga Princi i Kurorës së shtetit të Kuvajtit, z. Nawaf Al-Ahmad Al-Jaber Al-Sabah dhe Kryeministri, z. Jaber Al-Mubarak Al-Hamad Al-Sabah.

KLSH nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me Gjykatën e Llogarive të Rumanisë

Në datën 18 shtator 2018, në Bukuresht të Rumanisë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj nënshkroi rinovimin e Marrëveshjes dhe Planin e Bashkëpunimit për aktivitete të përbashkëta 2018-2021 mes Gjykatës së Llogarive të Rumanisë dhe KLSH-së. Presidenti i Gjykatës, z. Mihai Busuioc vlerësoi këtë marrëveshje si të rëndësishme për institucionin e tij dhe objektivat e tij reformuese, pas marrjes së detyrës një vit më parë nga Parlamenti rumun. Ai u shpreh se për institucionin shqiptar të auditimit të jashtëm publik kishte marrë opinion tejet pozitiv nga Presidenti i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë dhe ish-President i Gjykatës Evropiane të Audituesve(ECA), Dr. Vitor Caldeira dhe theksoi se *"me nisma konkrete do të zhvillojmë vullnetin tonë për*

punë të përbashkët, punë që do të sjellë vlerë të shtuar për audituesit e dy SAI-ve tona".

Kryetari Leskaj u shpreh se, bazuar në moton e INTOSAI-t *"Experentia mutua Omnibus prodest (Nga eksperienca e përbashkët fitojnë të gjithë)"* dhe në Nenin 15 *"Shkëmbimi ndërkombëtar i eksperiencave" të Deklaratës së Limës, ISSAI 1, "* Po nënshkruajmë këtë Marreveshje dhe Plan të përbashkët Veprimi për disa arësye themelore.

Së pari, për shkak të lidhjeve historike mes popujve tanë, popullit shqiptar dhe popullit mik rumun, në këtë vit të kremtimit të 100 Vjetorit të Bashkimit të Rumanisë, së cilës i jemi mirënjohës se ka mirëpritur dhe mbajtur në gjirin e saj patriotët shqiptarë gjatë viteve 1890-1912, në përpjekjet e tyre të pareshtura për liri, që kulmuan me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimin e Shtetit shqiptar në vitin 1912.

Së dyti, nënshkruajmë bashkëpunimin në vlerësim të personalitetit të fuqishëm reformues të z. Mihai Busuioc, President i Gjykatës së Llogarive të Romanisë. Ne kemi shumë për të mesuar nga Gjykata e Llogarive e Rumanisë, një SAI i madh evropian dhe me tradita. Besojmë se shkëmbimi i eksperiencave më të mira në auditim do të kontribuojë në zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të institucioneve tona".

Gjatë vizitës në Rumani, Kryetari i KLSH u prit nga Kryeministrja e Rumanisë, zj. Viorica Dăncilă në zyrën e saj të punës. Zj. Dăncilă theksoi se bashkëpunimi mes dy vendeve mike, Shqipërisë dhe Rumanisë është me rëndësi për bashkëpunimin ballkanik dhe integrimin e plotë të vendeve të rajonit në familjen e madhe evropiane. *"Në këtë drejtim"*, cilësoi Kryeministrja Rumune *,"partneriteti mes të dyja institucioneve supreme të auditimit luan një rol parësor".*

Nga ana e tij, z. Leskaj, pasi i shprehu Kryeministres së Rumanisë mirënjohjen për ndihmën që populli rumun dhe qeveritë e tij i kanë dhënë përpjekjeve të popullit shqiptar për të formuar shtetin e tij të pavarur, nënvizoi se shkëmbimi i eksperiencave në fushën e auditimit të jashtëm publik ndikon në forcimin e besimit të qytetarit në qeverisjen publike.

Në datën 19 shtator 2018, Kryetari i KLSH u prit në Parlamentin rumun nga Marius-Constantin Budăi, Kryetar i Komisionit për Buxhetin, Financat dhe Bankat. Në përshëndetjen e tij, Kryetari Budăi vlerësoi partneritetin e Komisionit që drejton me Gjykatën e Llogarive të Rumanisë, partneritet i cili realizohet nëpërmjet nën-komisionit të dedikuar për mbikqyrjen e punës së Gjykatës dhe vuri në dukje pritshmëritë e larta të Parlamentit ndaj qasjes së re të Presidentit të SAI-t, të përqëndruar në planin kështillues ndaj institucioneve shtetërore dhe në auditimet parandaluese ndaj dukurive të keqmenaxhimit të aseteve dhe parasë publike. Ai u interesua të dinte për raportet e KLSH me Parlamentin dhe komisionin përkatës parlamentar në Shqipëri.

Në përgjigje të interesimit, z. Leskaj theksoi mbështetjen e dhënë nga Kuvendi i Shqipërisë në miratimin e ligjit integral të institucionit që drejton në fund të vitit 2014, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, si dhe rolin e Kryetarit të Komisionit të Kuvendit për Ekonominë dhe Financat në promovimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimeve të KLSH dhe nxitjen e auditimeve të reja më cilësore dhe më pranë interesave të qytetarit.

Duke vlerësuar maksimalisht idetë dhe përpjekjet reformuese të z. Mihai Busuioc, President i Gjykatës së Llogarive të Rumanisë, Kryetari i KLSH u shpreh se *"…që këto ide të realizohen, ndihma dhe mbështetja Juaj si Komision është vendimtare"*.

Në diskutimet për Planin e përbashkët të Veprimeve për konkretizimin e Marrëveshjes, nga SAI rumun ishin të pranishëm z. Florin Demian, Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës, zj. Marina Aulona Pelea, Anëtare e Gjykatës së Llogarive, z. Dragos Budulac, Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe z. Dimitru Nichita, Këshilltar i Presidentit të Gjykatës.

Në prezantimin e tij, Presidenti Busuioc theksoi domosdoshmërinë që Gjykata t'i largohet pozicionit që ka mbajtur deri tani si një institucion vetëm sanksionues dhe të

zëvendësojë qasjen se kush jep sanksione më të rënda e ka kryer punën e tij si auditues më mirë, për të marrë një pozicion më këshillues dhe rekomandues, duke synuar auditime parandaluese ndaj riskut të keqmenaxhimit në administratën shtetërore. *"Administrata ka frikë nga ne se mos gabon dhe e ndëshkojmë dhe nuk kryen tendera. Kjo pengon zhvillimin. Ne duhet të këshillojmë qeverinë në marrjen e politikave të duhura. Duhet të jemi një hap përpara, për ta ndihmuar. Vetëm kështu mund të shndërrohemi në faktor nxitës të zhvillimit ekonomik"*, u shpreh z.Busuioc.

Nga ana e tij, Kryetari Leskaj, pasi prezantoi punën dhe arritjet e KLSH në periudhën 2012-2018, nënvizoi se vetëm njohja dhe asimilimi nga audituesit i standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t, ISSAI-t, ballafaqimi i eksperiencave të tyre audituese me ato të kolegëve të SAI-ve evropiane më të zhvilluara, do të mundësojë rritjen e impaktit të gjetjeve dhe rekomandimeve të SAI-t në jetën e qytetarëve.

Në përbërjen e delegacionit të KLSH ishin Prof. Dr. Skënder Osmani, ekspert i jashtëm i KLSH dhe një nga personalitet më të spikatura të shkencës shqiptare në studimet për matematikën dhe informatikën dhe aplikimet e tyre në shoqëri dhe ekonomi, z. Muhamed Kavaja, auditues me eksperiencë mbi 25 vjecare në KLSH dhe Kryetar i Shoqatës së Audituesve të Shqipërisë dhe z. Fatos Cocoli, ekspert i jashtëm.

Marrëvëshja me SAI-n e Rumanisë është e 17-ta me SAI-t evropiane simotra që KLSH ka nënshkruar gjatë viteve 2012-2018, duke zgjedhur qasjen e partneritetit të plotë dhe bashkëpunimit konkret e reciprok me institucionet e zhvilluara të auditimit suprem evropian.

Ambasadori Italian në Shqipëri takon Kryetarin e KLSH-së

Në datën 24 shtator 2018, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj takoi në mjediset e KLSH Ambasadorin e Republikës së Italisë në Shqipëri, z. Alberto Cutillo.

Z. Cutillo u interesua të dinte për zhvillimet me nën-komisionin e dedikuar për raportet e KLSH në Kuvend. Kryetari i KLSH i parashtroi Ambasadorit italian marrëdhëniet konstruktive dhe të partneritetit aktiv që KLSH ka pasur në vijimësi me Parlamentin, të intensifikuara gjatë viteve të fundit me rritjen e numrit të raporteve të auditimit dërguar Kuvendit dhe me rezolutat e Kuvendit për KLSH-në. Ai vlerësoi rolin mbështetës të Kryetarit të Kuvendit z. Ruçi dhe të Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat, z. Braçe. "Ne e kemi konsideruar gjithnjë veten si një institucion "watchdog" në shërbim të qytetarit dhe Kuvendit. Më 4 qershor të këtij viti në Tiranë, në takimin e ndërgjegjësimit mbi zhvillimin e marrëdhënieve mes institucioneve supreme të auditimit dhe parlamenteve, të organizuar nga SIGMA, z. Ruçi u shpreh për ngritjen së shpejti të një nën-komisioni parlamentar për çështjet e KLSH-së. Shpreh bindjen se ky nën-komision do të

ngrihet brenda këtij viti", përfundoi z. Leskaj.

Ambasadori Cutillo u interesua dhe për raportet e KLSH me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm. Kryetari Leskaj nënvizoi se raportet në vazhdimësi kanë qenë korrekte në nivel të zyrës qendrore, por ka munguar bashkëpunimi ndaj dosjeve të kallëzimeve penale të KLSH nga ana e zyrave të Prokurorisë nëpër rrethe. "Me ngritjen e

strukturave të reja nga reforma në drejtësi, sidomos të SPAK, bashkëpunimi mes institucionit tonë dhe strukturave të hetimit dhe Prokurorisë do të marrë një shtysë të re, shumë të mirëpritur nga ne", u shpreh ai. Më tej, Kryetari i KLSH cilësoi se edhe pse detyra kryesore e një institucioni suprem auditimi është të kryejë auditime sa më cilësore, krahas modernizimit të institucionit të KLSH dhe rritjes së cilësisë së gjetjeve dhe rekomandimeve të tij, thellimi i luftës kundër korrupsionit është parë si një detyrë tjetër madhore. "Pikërisht për këtë arsye, gjatë këtyre 7 viteve kemi ecur me një ritëm një kallëzim penal çdo javë", theksoi Leskaj. Gjithashtu, Kryetari i KLSH-së informoi Ambasadorin Cutillo për treguesit e auditimeve të vitit 2017 dhe 2018, si për numrin e auditimeve të realizuara, dëmin ekonomik të konstatuar, të ardhurat e munguara dhe shpenzimet e kryera jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit (3E), masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara, rekomandime për ndryshime apo përmirësime të legjislacionit, etj.

Ambasadori italian në Shqipëri, në përfundim të takimit, e falenderoi Kryetarin e KLSH për mikpritjen dhe informacionin e dhënë dhe cilësoi se Italia e konsideron punën dhe progresin e institucionit suprem të auditimit në mbajtjen e qeverisë të përgjegjshme për harxhimin e fondeve publike, si një kontribut themelor në integrimin e vendit në BE dhe, në emër të institucionit që përfaqëson, u shpreh i gatshëm të ofrojë asistencën e duhur.

KLSH merr pjesë në seminarin me temë "Evaluation Internal Control and Sampling"

KLSH ka marrë pjesë në seminarin me temë "Vlerësimi i Kontrollit të Brendshëm dhe zgjedhja e kampionit", të zhvilluar në Budva, Mali i Zi, nga data 25-28 Shtator 2018, në të cilin morën pjesë edhe përfaqësues nga SAI i Bosnjë Hercegovinës, Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Turqisë. KLSH, u përfaqësua nga Brunilda Zeneli, Kryeauditueseë; Klarenc Xhaferaj, Kryeauditues; Elida Koçani, Audituese e Parë; Jovan Plaku, Auditues i Parë dhe Berti Meçaj, Auditues i Parë. Seminari u organizua nga SAI i Malit të Zi në bashkëpunim me Zyrën Kombëtare të

Auditimit të Suedisë (SNAO), në kuadër të projektit për vendet kandidate dhe parakandidate pë në BE, si dhe u moderua nga z. Hazim Sabanoviç, z. Herjevik Anders dhe z.Janhed Tomas.

Qëllimi i këtij seminari ishte shkëmbimi i eksperiencave lidhur me metodologjinë e përdoruar për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nga SAI-et pjesëmarrëse, duke iu referuar shembujve praktikë. Për këtë arsye gjithë zhvillimi i seminarit ishte konceptuar si një auditim në praktikë (rast studimor), ku secili nga SAI-et përdori metodologjinë e vet, për të vlerësuar funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Në ditën e parë të seminarit, grupet pjesëmarrëse u njohën me qëllimin dhe objektivin e seminarit, si dhe me të dhënat e rastit studimor, të cilat konsistonin në "Raportimin financiar" të njësisë për vitin 2017, bazën e të dhënave "llogari analitike", të shpenzimeve operative, etj., si dhe të dhëna shtesë rreth njësisë, në mënyrë që të krijohej një pamje më e plotë, për të bërë të mundur aplikimin e metodologjive nga secili pjesëmarrës, e konkretisht për përcaktimin e nivelit të sigurisë së auditimit me qëllim dhënien e një opinioni me siguri të arsyeshme mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Auditimi i rastit studimor, u punua në mënyrë të pavarur ditën e dytë dhe të tretë të seminarit nga çdo SAI pjesëmarrës. Rezultatet e dala nga auditimi i "rastit studimor", mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nga secili pjesëmarrës, në mënyrë të përmbledhur u referuan ditën e katërt të seminarit.

Nga ana e moderatorëve në këtë aktivitet referimet u zhvilluan në një frymë diskutimesh aktive, duke krahasuar vazhdimisht procedurat e secilit SAI, apo mënyrat e ushtrimit e zbatimit të tyre në rastin studimor, duke nxjerrë në pah qasjen e secilit vend pjesëmarrës.

Në përfundim të aktivitetit duke falenderuar palën organizatore për mikpritjen, u vu theksi në vlerën e shtuar të këtij seminari, si dhe mënyrën e konceptimit të tij, duke u përqendruar te zbatimi i teorisë në praktikë, shkëmbimi i mendimeve dhe eksperiencave reciproke gjatë seminarit.

KLSH merr pjesë në seminarin e zhvilluar në Luksemburg, nga Instituti Europian i Administratës Publike, për praktikat Europiane të prokurimit publik

Në datat 7 - 8 nëntor 2018, u zhvillua në Luksemburg, nga Instituti Europian i Administratës Publike (EIPA), i cili ndodhet në Maastricht Hollandë, seminari me temë "Mbi praktikat më të mira dhe auditimi i procesit të prokurimit publik të Bashkimit Europian". Qëllimi kryesor i EIPA-s, është ofrimi i kurseve cilësore të trajnimit, për të zhvilluar kapacitetet e profesionistëve, administratave publike kombëtare dhe rajonale që merren me çështjet e BE-së, si dhe me institucionet evropiane. EIPA ofron ekspertizë të gjatë, të kombinuar me module të mësimdhënies të bazuara në probleme dhe praktika.

Seminari u drejtua nga Rita Beuter, eksperte e lartë në Njësinë e Politikave, me titull master në administratën publike, Michael Burnett, Ekspert i Menaxhimit Publik Europian të EIPA-s, asistent drejtor i KPMG, me titull master në administratën publike dhe Dr. Peter Braun, anëtar i grupit të prokurimit publik të Universitetit të Notingamit si dhe anëtar i bordit të rishikimit të ligjeve të prokurimit publik të Bashkimit Europian. Në këtë seminar morën pjesë auditues të ECA (Gjykata Europiane e Audituesve) si dhe nga shtete si Bullgaria, Maqedonia, Sllovakia. Nga Shqipëria morën pjesë audituesit e KLSH-së z.Aldo Kume dhe zj.Lolita Baholli.

Në këtë seminar u trajtua objektiva në lidhje me prokurimin publik "Europa 2020", e cila ka të bëjë me arritjen e një sistemi inteligjent të qëndrueshëm të prokurimit, duke siguruar sa më shumë eficencë të fondeve publike, rritjen e eficencës së shpenzimeve publike, lehtësimin dhe krijimin e mundësive për pjesëmarrje në procedura, përdorimi i prokurimit si një mbështetës i qëllimeve të përbashkëta sociale si dhe sigurimi i një qartësie ligjore. Programi i trajnimit u bazua në rregullat e prokurimit publik europian sipas direktivës 2014/24/EU, nëpërmjet kombinimit të rasteve studimore si dhe zgjedhjeve të shumëfishta duke përfshirë edhe dokumentacionin përkatës rast pas rasti.

Gjatë dy ditëve të këtij takimi u zhvilluan temat mbi:

- Kuptimi i objektivave për çdo faze të prokurimit publik;
- Ndryshimet, risqet dhe adresimi i tyre, për çdo faze të prokurimit publik;
- Rregullat etike të prokurimit të ECA-s dhe INTOSAI-t si dhe zbatimi i ISSAI 30 në të gjitha procedurat e prokurimit;
- Kuptimi i praktikave më të mira, bazuar në rastet ligjore të Gjykatës Europiane të Drejtësisë (CJE).

Gjatë dy ditëve të seminarit një vend të rëndësishëm zuri roli i prokurimit si një mjet antikorrupsion. U diskutua mbi dimensionet e korrupsionit në prokurim të cilat janë korrupsioni nga autoriteti kontraktor (që është politik dhe operacional) si dhe korrupsioni nga operatorët ekonomikë. Një praktikë e mirë prokurimi është një tregues i fortë për nivel të ulët korrupsioni. Por prokurimi publik nuk mund të jetë i vetmi mjet dhe nuk

mund të funksionojë me efektivitet pa një kuadër ligjor të mirë, pa kod etik të prokurimit, pa një buxhet efektiv, menaxhim financiar të mirë si dhe me një auditim efektiv.

Seminari pati shumë interes, pasi çështjet e trajtuara kishin të bënin me mënyrën e auditimit, u zhvillua interaktiv, me shembuj të ndryshëm për tipe kontratash të zbatuara nga vende të ndryshme të BE-së dhe me diskutime mbi to.

Një delegacion i KLSH-së merr pjesë në kremtimin e 25 vjetorit të SAI-t Çek

Në datat 30 Shtator - 1 Tetor 2018, një delegacion i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i kryesuar nga Kryetari, z.Bujar Leskaj, mori pjesë në kremtimet e 25 vjetorit të krijimit të Institucionit Suprem të Auditimit të Çekisë. Delegacioni i KLSH-së përbëhej nga Kryetari i KLSH-së z. Bujar Leskaj, Sekretari i Përgjithshëm, zj. Luljeta Nano dhe auditueset zj.Nikoleta Piranjan dhe zj.Alketa Kalleshi.

Në këtë event morën pjesë në statusin e të ftuarit Kryetari i Gjykatës Europiane të Audituesve, i kryesuar nga Presidenti i kësaj Gjykate, z. Klaus-Heiner Lehne, delegacionet e Institucioneve Supreme të auditimit të Austrisë, Polonisë, Spanjës, Hungarisë, Sllovenisë dhe Turqisë. Gjatë zhvillimit të ceremonisë, Kryetari i SAI-t Çek, z. Miloslav Kala solli ne vëmendje të të pranishmëve rolin e kontributin 25 vjeçar të SAI-t Çek në mirë-menaxhimin e financave publike dhe të fondeve publike. Zoti Kala theksoi në fjalën e tij rëndësinë e komponentit të ruajtjes së pavarësisë institucionale si shtylla e katërt e demokracisë.

Presidenti i Republikës Çeke, z. Milos Zeman në fjalën e tij përshëndetëse vlerësoi veprimtarinë e SAI-t Çek si një institucion kushtetues i pavarur në gjenerimin e informacioneve objektive dhe të besueshme në drejtim të përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve dhe pronës shtetërore me një impakt të padiskutueshëm në vendimmarrjet për zhvillim dhe prosperitet të vendit.

Kryetari i Gjykatës Europiane të audituesve z. Lehne theksoi rëndësinë e kooperimit të vendeve anëtare të EUROSAI-t, duke theksuar *se "duhet të punojmë së bashku për Europën sot".*

Në vijim Kryetarët e SAI-ve zhvilluan takime dhe bisedime mbi sfidat me të cilat përballen Institucionet Supreme të Auditimit në nivel global.

Auditues të KLSH marrin pjesë në Trainimin treditor të organizuar në Prishtinë, nga USAID dhe Qendra për Ekselencë e GAO-s

USAID dhe Qendra për Ekselencë në Auditim e Zyrës së Auditimit të Qeverisë (GAO) të SHBA-së, nën kujdesin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (në kuadër dhe të festimeve të 15 vjetorit të krijimit të saj), organizuan në datat 1-3 Tetor 2018 një trainim mbi Auditimin e Performancës ku merrnin pjesë rreth 30 auditues të të gjitha niveleve të Institucioneve Supreme të Auditimit të Ballkanit Perëndimor: Kosovës, Shqipërisë, Bosnjë - Hercegovinës, Maqedonisë dhe Malit të Zi.

Në këtë aktivitet, Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga 8 Auditues, ndër të cilët 6 auditues nga Departamenti i Auditimit të Performancës. Trainimi u zhvillua nga një ish auditues i performancës (team leader) me shumë përvojë si në ushtrimin e auditimeve ashtu edhe në zhvillimin e trainimeve të kësaj fushe të GAO-s, z. Riçard Stana.

Qendra për Ekselencë në Auditim e GAO, ka si mision të nxisë qeverisjen e mire dhe forcojë kapacitetet institucionale të organizmave të kontrollit duke i mbështetur më trainime të cilësisë së lartë, asistencë teknike dhe aktivitete e shërbime të tjera mbështetëse, në katër fusha kryesore:

- Auditimet e Performancës,
- Ndërtimi Insitucional,
- Auditimet Financiare,
- Lidership dhe Mbikqyrje, si dhe në shumë fusha të tjera specifike: kontrollin e brendshëm, prokurime dhe metodologjinë e auditimit, etj.

Trainimi i lartpërmendur, do të përfshinte me hollësi të gjitha hapat që ndërmerren gjatë auditimeve të performances, të përgatitur në 5 module, jo vetëm në aspektin teorik, por dhe të ilustruara me raste dhe gjetje të GAO-s dhe në veçanti nga përvoja e z. Stana.Gjithashtu ky trainim u dallua për veçorinë se ishte shumë interaktiv, ku të gjitha SAI-t pjesëmarrëse folën për specifikat në punën e tyre gjatë auditimeve të performances sipas çështjeve që diskutoheshin. Bazuar në njohuritë e përfituara nga pjesëmarrësit mund të themi se trainimi ishte një vlerë e shtuar dhe i tejkaloi pritshmëritë e pjesëmarrësve.

Një çështje tjetër që u diskutua ishte vlerësimi i riskut të auditimit, i cili përfshin si vlerësimin cilësor dhe sasior.Faktorët që ndikojnë në riskun e auditimit përfshijnë kuadrin kohor, kompleksitetin apo ndjeshmërinë e punës; madhësinë e programit në aspektin e vlerave monetare dhe numrin e qytetarëve që iu është

shërbyer; përshtatshmëria e sistemeve dhe proceseve të njësisë së audituar, për të zbuluar mospërputhjet, gabimet e rëndësishme apo mashtrimin; dhe mundësia e audituesve për të marrë të dhëna.

Gjatë planifikimit, audituesit duhet të identifikojnë kriteret e mundshme dhe të nevojshme për të vlerësuar çështjet studimore; burimet e evidencave të auditimit dhe të përcaktojnë sasinë dhe llojin e evidencës së nevojshme për nivel të caktuar të riskut dhe materialitetit të auditimit; nëse do të përdoret puna e audituesve dhe specialistëve të tjerë për të adresuar disa nga objektivat e auditimit; etj.

Më pas u vijua me Ushtrimin e auditimit dhe Raportimin. Një raport cilësor auditimi performance është fundi i produktit të një pune audituese që përmban:

- Pyetje auditimi të bazuara dhe evidencë të besueshme në përgjigje të këtyre pyetjeve, të cilat janë baza e raportit të auditimit të performances.
- Një mesazh të qartë auditimi.

Grupi i audituesve të KLSH-së që morën pjesë në këtë trainim i përbërë nga Sali Agaj, Angjela Nestori, Reinis Xhelili, Silvana Ramadani, Miranda Mesini, Artemida Hoxha, Hektor Kosova dhe Kris Anastas, u përfshinë aktivisht në diskutimin e çështjeve dhe dhanë kontributin e tyre në zgjidhjen e ushtrimeve të parapërgatitura nga trainuesi, për situata konkrete në faza të ndryshme auditimi. Në mbyllje të trainimit u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së çertifikatave për të gjithë audituesit pjesëmarrës, ku merrnin pjesë Audituesi i Përgjithshëm i ZKA, z. Besnik Osmani, zv. drejtore e USAID në Kosovë, zj.Kristina Devis, zv. auditori i ZKA, z.Ilir Salihu dhe drejtori i menaxhimit financiar të zyrës së USAID, Markham Isom.

Fjalën e rastit e mbajti Audituesi i Përgjithshëm i ZKA ku theksoi rëndësinë e trainimit në zhvillimin e njohurive profesionale të audituesve, të nevojshme për të qenë të suksesshëm dhe përmirësuar performancën në kryerjen e funksionit të audituesit shtetëror si dhe theksoi se trainimi mbi auditimin e performances është pjesë e aktiviteteve që Zyra Kombëtare e Auditimit po zhvillon këtë javë në kuadër të festimeve të 15 vjetorit të themelimit si Institucion Suprem i Auditimit në Republikën e Kosovës.

KLSH merr pjesë në kursin "Korniza e Matjes së Performancës së SAI-ve"

Në datat 3-5 Tetor në Madrid, Spanjë u zhvillua trajnimi mbi njohjen dhe aplikimin e SAI-PMF (Sistemi i Matjes së Performancës) nga IDI (Inisitativa për Zhvillim e INTOSAI-t). Qëllimi i këtij trajnimi ishte ndërgjegjësimi i SAI-ve për këtë instrument në matjen e performancës individuale të tyre.

Vetë SAI-PMF u miratua si dokument i INTOSAI-t në Kongresin e XXII të INCOSAI-t, mbajtur në Abu D'habi në dhjetor të vitit 2016, duke i hapur kështu rrugën implementimit të standartizuar të tij në të gjitha vendet e interesuara.

Trajnimi u fokusua në disa çështje kryesore:

- Në instrumentin dhe metodologjinë e vlerësimit PMF;
- qëllimi i një vlerësimi PMF të SAI-ve dhe si raportet mund të përdoren nga SAI-t dhe partnerët e jashtëm;
- një proces i përshtatshëm për kryerjen e një PMF sipas qëllimit të vlerësimit dhe kontekstit të vendit;
- pikat e forta dhe kufizimet e PMF;
- vlerat dhe përfitimet e SAI-ve duke përdorur kornizën PMF.

SAI PMF është një sistem gjithëpërfshirës vlerësimi, i cili mat performancën e një SAI përkundrejt standardeve ndërkombëtare ISSAI, sikurse edhe praktikave të mira në fushën e auditimit. I konceptuar dhe dizenjuar si një vetë-vlerësim (vet-auditim), SAI PMF identifikon, mbi bazën e evidencave, mangësitë dhe përparësitë e aktivitetit të një SAI, duke matur njëkohësisht nevojat për rritje të kapaciteteve, vlerat dhe përfitimet që SAI ofron tek taksapaguesit dhe Kuvendi, sikurse dhe dinamikën e zhvillimit, për të gjurmuar progresin e një SAI në kohë.

Nga pikëpamja strukturore, SAI PMF mat performancën e një SAI në 7 fusha (brenda dhe jashtë kontrollit menaxherial të institucionit). Secila fushë vlerësimi ka indikatorët e saj, të cilët vetë detajohen në dimensione dhe kritere specifike dhe vlerësimi.

Gjatë ditës së parë dhe të dytë të trajnimit u diskutuan domain A (Pavarësia dhe kuadri ligjor) domain B (Qeverisja e Brendshme dhe Etika) dhe domain C (Cilësia e auditimit dhe raportimi). Të gjitha domainet e diskutuara u shoqëruan me shembuj, punë në grup dhe raste praktike në mënyrë që ato të implementohen në SAI të ndryshme.

Në ditën e tretë u diskutua domain D, E, F të shoqëruar me ushtrime për të shpjeguar në detaje të gjithë kornizën PMF për të realizuar procesin e vlerësimit.

Pjesëmarrës në këtë seminar ishin auditues të niveleve drejtuese nga vende të ndryshme si: Shqipëria, Armenia, Bosnja Hercegovina, Turqia, Ukraina, Kuwajt, Gjykata e Europiane e Audituesve, Suedia, etj.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit morën pjesë znj.Manjola Naco, Drejtore e Përgjithshme dhe znj. Elisa Metaj specialist në Drejtorinë e Komunikimit dhe Marrëdhënieve më Jashtë, të cilat bashkëpunuan me kolegët nga Mbretëria e Bashkuar, Armenia dhe Senegali në rastet studimore që u zhvilluan gjatë 3 ditëve të trajnimit.

Roli i KLSH në vendosjen dhe shpërndarjen e kulturës së integritetit

Në 2 Tetor 2018 në Budapest u mbajt Konferenca *"Roli i Institucioneve Supreme të Auditimi, në shpërndarjen e kulturës së integritetit".*

Konferenca kishte si qëllim forcimin e bashkëpunimit bilateral dhe shumëpalësh ndërmjet institucioneve të auditimit, anëtare të Grupit të Punës në mënyrë që secili prej tyre të ofrojë kontributin e tij në krijimin dhe zgjerimin e kulturës së integritetit ndërmjet vendeve të rajonit të EUROSAI-t.

Konferenca u organizua nga Zyra e Auditimit Shtetëror të Hungarisë, e cila është dhe udhëheqëse e Grupit të Punës EUROSAI-t me pjesëmarrjen e SAI-t të Portugalisë, Gjykatës së Auditimit të Austrisë, SAI-t të Bullgarisë, Rumanisë, Bjellorusisë si dhe përfaqësues të Universitetit Shtetëror dhe ministrive e institucioneve të tjera të Hungarisë.

KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga znj. Albana Gjinopulli, Drejtore e Departamentit të Metodologjisë dhe Strategjisë së Auditimit dhe znj. Edlira Sako, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Misioni i auditimit të jashtëm publik po shkon gjithnjë e më shumë tej kufijve të kontrollit tradicional në fusha të caktuara si rregullshmëria dhe pasqyrat financiare. Institucionet Supreme të Auditimit janë tashmë gardianë të qeverisjes së mirë në tërësi dhe jo vetëm të financave publike.

Eksperienca e SAI-t të Polonisë dhe Gjykatës së Auditimit të Austrisë bënë prezent se si këto ndryshime kanë vendosur para auditimit publik kërkesën për adoptimin e qasjeve të reja audituese, të cilat i ofrojnë publikut, parlamentit dhe gjithë grupeve të interesit informacion të fokusuar mbi shkallën e integritetit dhe etikës me të cilën pushtetarët dhe zyrtarët e zgjedhur ushtrojnë funksionet e tyre publike.

Eksperienca e SAI-ve më të zhvilluar në këtë drejtim tregoi se tashmë këto institucione janë angazhuar në qasje auditimi të bazuara në integritet.

Në këtë këndvështrim KLSH ka theksuar gjithnjë e më shumë rolin e saj aktiv dhe kontributin në vendosjen e një sistemi vlerash, ku etika dhe integriteti përfaqësohen më një njëjtën rëndësi sikurse dhe funksioni bazë auditimi.

Pjesëmarrësit në Konferencë vlerësuan si mjaft pozitive përpjekjet e KLSH prej vitit 2012 të cilat kanë konkretizuar idetë për një ambjent me etikë e integritet në një sistem vlerash e parimesh të cilat mbështeten në ISSAI 20 "Parimet e

Trasparencës dhe Përgjegjshmërisë" për të udhërhequr përmes shembullit.

Një delegacion i KLSH-së merr pjesë në kremtimin e 15 vjetorit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës

Në datën 4 Tetor 2018, një delegacion i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i kryesuar nga Kryetari, z. Bujar Leskaj, mori pjesë në kremtimet e 15 Vjetorit të krijimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit(ZKA) të Kosovës.

Me rastin e këtij përvjetori, ZKA organizoi konferencën ndërkombëtare tematike *"Roli i impaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit në rikthimin e besimit publik ndaj sektorit publik",* në të cilën morën pjesë zj. Helena Lindberg, Audituese e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, inxh. Miloslav Kala, President i SAI-t të Çekisë, z. Adrian Crompton, Auditues i Përgjithshëm i Uellsit, z. Milan Dabović, President i Senatit të SAI-t të Malit të Zi, z. Seyit Ahmet Baş, President i Gjykatës së Llogarive të Turqisë, si dhe shumë drejtues të tjerë të lartë të SAI-ve të Polonisë, Maqedonisë, Finlandës, ECA-s, etj.

Paneli i Parë i Konferencës trajtoi impaktin e auditimeve të performancës për një qeverisje më të mirë. Referuesit sollën shembujt e auditimeve të performancës të SAI-ve të tyre, si dhe theksuan trendin e rritjes së rolit të këtyre auditimeve në përmirësimin e jetës së qytetarëve, nëpërmjet këshillimeve ndaj qeverisë dhe rekomandimeve për përmirësim të shërbimeve dhe politikave qeveritare ndaj qytetarit.

Paneli i Dyte trajtoi demonstrimin nga ana e SAI-ve të rëndësisë së auditimeve të tyre për shoqërinë, duke kryer auditime të bazuara në risk. Në këtë panel, KLSH paraqiti eksperiencën e tij në ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e auditimeve me bazë riskun.

Me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, nën drejtimin e Kryetarit Leskaj, KLSH ka nënshkruar marrëveshjen e parë të bashkëpunimit me SAI-t homologe, në shkurt 2012.

Si KLSH dhe si Zyrë Kombëtare e Auditimit të Kosovës, mbi bazën e Nenit 15 të Deklaratës së Limës dhe të motos së INTOSAI-t "Experentia mutua omnibus prodest", të dyja SAI-t kanë shkëmbyer në këto gjashtë vite e gjysëm eksperiencat e suksesshme nga auditimet e tyre, duke bashkëpunuar konkretisht, duke marrë pjesë në aktivitetet vjetore dhe

ndërkombëtare të njeri-tjetrit me kumtesa, botime të përbashkëta, me vizita reciproke pune të audituesve, etj.

Në përbërje të delegacionit të KLSH ishin edhe z. Ermal Yzeiraj, Drejtor i Departamentit Juridik, si dhe audituesit z. Luan Kuka dhe z.Kristaq Gjurgjaj.

Pjesëmarrje e KLSH-së në Takimin e 16-të Vjetor të EUROSAI WGEA në Bratislavë, Sllovaki

Në datat 25-28 Shtator 2018 në Bratislavë, Sllovaki, u organizua Takimi i 16-të i Grupit të Punës për Auditimet Mjedisore të EUROSAI-t (EUROSAI WGEA) me temë: *Ndryshimet Klimatike - Fokusimi tek të dhënat*. Kjo është një temë shumë e ndjeshme sa i takon çështjeve të mjedisit, mund të quhet tema e ditës, pasi e gjithë vëmendja e politikëbërësve, shkencëtarëve, etj. është fokusuar tashmë në arritjen e zbatimit të politikave të tilla në Europë dhe në gjithë botën, për ngadalësimin e ngrohjes globale duke synuar rritjen e temperaturave të Tokës me të paktën 2 gradë/vit (synimi i vërtetë është edhe më poshtë 2 gradëve), kjo sipas Marrëveshjes së Parisit mbi ndryshimet Klimatike, datë 12.12.2015.

Në lidhje me këtë çështje SAI Sllovak ishte mikpritësi i radhës i këtij takimi, i cili e nisi ditën e tij të parë me fjalët përshëndetëse të Presidentit të SAI-t Sllovak dhe Sekretarit të Shtetit për Ministrinë e Mjedisit në Sllovaki.

Dita e parë e Takimit ishte e organizuar si një seminar me prezantime dhe ushtrime për të gjithë pjesëmarrësit me qëllim:

- prezantimin e llojeve kryesore të të dhënave për ndryshimet klimatike;
- sigurimin e një pasqyre të burimeve dhe përdorimin e të dhënave mbi ndryshimet klimatike;
- prezantimin e mjeteve dhe metodave për analizimin e të dhënave;
- diskutimin mbi aspektet e përdorimit të të dhënave në auditimet që lidhen me ndryshimet klimatike;
- kryerjen e ushtrimeve praktike për të frymëzuar punën e ardhshme të auditimit.

Prezantuesit gjatë ditës së parë ishin nga institucionet: Agjencia Europiane e Mjedisit, Instituti Botëror i Kërkimeve, Gjykata Europiane e Llogarive dhe GAO e Sheteve të Bashkuara të Amerikës.

Në ditën e dytë, Takimi u fokusua në auditimet e kryera konkretisht për temën e takimit, dmth. në lidhje me ndryshimet klimatike, ku prezantuan eksperiencën e tyre përfaqësues të SAI-ve Gjerman, Letonez, Sllovak dhe të GAO-s. U përfshi gjithashtu dhe pjesëmarrja e profesorit Milan Lapin i Universitetit Sllovak, në lidhje me trendin e ndryshimeve klimatike në Europë e kryesisht në Sllovaki. Prezantuan gjithashtu dhe përfaqësues të Komisionit Europian e të OECD-së në lidhje me Marrëveshjen e Parisit mbi Ndryshimet Klimatike.

Në përfundim takimi u përqendrua në auditmet e përbashkëta. Gjatë kësaj dite ishte parashikuar që dhe KLSH të mbante një prezantim të shkurtër në lidhje me ekperiencën në auditimin e përbashkët "Mbi zonat e mbrojtura detare". Ky është një auditim performance i përbashkët i SAI-ve të vendeve të Mesdheut, ku marrin pjesë SAI-t e Maltës, Qipros, Greqisë, Sllovenisë, Portugalisë, Spanjës dhe Shqipërisë.

Bashkëpunimi i ndërmjet audituesve të jashtëm dhe të brendshëm në sektorin publik

Në datat 9, 10 dhe 11 tetor 2018 në Qendrën për Ekselencë në Financë, CEF e cila ndodhet në Ljubljanë, Sllloveni u zhvillua workshopi me temë*: "Bashkëpunimi i audituesve të brendshëm dhe të jashtëm në sektorin publik".* Kontrolli i Lartë i Shteti u përfaqësua në këtë event nga z.Artur Hasanbelliu, zj.Eneida Seraj dhe z.Besmir Pajaj.

Ky aktivitet ofroi një platformë për shkëmbimin e ideve se si të rritet bashkëpunimi ndërmjet auditorëve të jashtëm që punojnë në Institucionet Supreme të Auditimit dhe auditorët e brendshëm të sektorit publik. Workshopi mblodhi së bashku drejtuesit e njësive të harmonizimit qendror, drejtuesit e departamenteve të auditimit të brendshëm, audituesit e brendshëm të Institucioneve të Auditimit.

Sipas modelit të Tre Linjave të Mbrojtjes, auditimi i brendshëm luan rolin e vijës së tretë, që do të thotë se ofron siguri për nivelin e lartë menaxherial dhe bordin drejtues mbi efektivitetin e procesit të

menaxhimit, kontrollit dhe riskut të qeverisjes.

Auditimi i jashtëm nuk është pjesë e këtij modeli, ai është i vendosur jashtë organizatës dhe ka rol parësor për të shprehur mendimin mbi pasqyrat financiare. Megjithatë, bashkëpunimi ndërmjet auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm është i dobishëm pasi i jep nivelit të lartë menaxherial një pasqyrë më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të risqeve, edhe pse objektivat e auditimit të brendshëm dhe të atij të jashtëm janë të ndryshme, ka fusha me interes të përbashkët, veçanërisht në raportimin financiar.

Në workshop u shtruan për diskutim dhe zgjidhje raste praktike të vendeve pjesëmarrëse duke përdorur një qasje interaktive.

Në përfundim të aktivitetit pjesëmarrësit kishin një kuptim më të mirë të parimeve, standardeve dhe udhëzimeve që drejtojnë punën e audituesve të brendshëm dhe të jashtëm, kishin një kuptim më të mirë të asaj që është baza për bashkëpunimin ndërmjet audituesve të brendshëm dhe atyre të jashtëm, identifikuan zonat ku mund dhe do të bashkëpunohet në të ardhmen. Ky trajnim ishte hartuar për menaxherët e njësive qendrore të harmonizimit në Ministrinë e Financës, drejtuesit e departamenteve të auditimit të brendshëm, audituesit e njësive të auditimit të brendshëm në SAI si dhe audituesit e Institucioneve Supreme të Auditimit.

Lënda ishte shumë interaktive dhe pjesëmarrësit nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Bosnje Hercegovina, Serbia, Hungaria, Maqedonia, Turqia dhe Sllovenia u inkurajuan të ndajnë pikëpamjet e tyre dhe përvojat profesionale.

KLSH organizon akademinë përkujtimore për prof. Stanislav Zuber, inxhinierit dhe gjeologut me famë botërore

Në datën 14 tetor 2018, me rastin e 125 vjetorit të lindjes së gjeologut dhe inxhinierit të naftës Prof. Stanislav Zuber, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në bashkëpunimin me profesoratin e Fakultetit Gjeologji-Miniera të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe me Shoqatën e Miqësisë Shqipëri-Poloni organizoi Akademinë Përkujtimore në nderim të Prof. Zuber, në formën e një simpoziumi shkencor, në sallën qendrore të Akademisë së Shkencave.

Në këtë aktivitet morën pjesë personalitete të fushës së gjeologjisë, përfaqësues të Akademisë së Shkencave, Ambasadori i Polonisë në Shqipëri z. Karol Bachura, Zv-Presidenti i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë(NIK), z. Wojciech Kutyla, përfaqësues të Shoqatës së miqësisë Shqipëri-Poloni, përfaqësues të shoqërisë civile, auditues të KLSH, etj.

Në fjalën e tij të hapjes, Kryetari i KLSH z. Bujar Leskaj theksoi se në vitet 1927-1947, Shqipëria pati rastin fatlum të përfitonte nga kontributi i jashtëzakonshëm shkencor 20-vjeçar i Prof. Stanislav Zuber-it. Ai i la trashëgim Arkivit qendror të Gjeologjisë dhe Institutit të Naftës 551 punime dhe bocete shkencore, me 480 punime të plota. Prof. Zuber është hartuesi i hartës tektonike të Shqipërisë në shkallë 1:4 000 000, i Hartës Gjeologjike të Shqipërisë në shkallën 1:200 000 dhe i Hartës Minerale të Shqipërisë në shkallë 1:300 000. Deri në kohët e fundit, gjeologët tanë punonin me hartat e tij.

Ambasadori i Polonisë në Shqipëri z. Karol Bachura u shpreh se në vitin 2017 një rrugë në Tiranë, pikërisht në afërsi të vendndodhjes së ish-burgut ku vdiq nga torturat Prof. Zuber në vitin 1947, mori emrin e Prof. Zuber. Ndërsa gazsjellësi TAP, vepra madhore që shtrihet sot edhe në Shqipëri dhe vjen nga Azerbajxhani për të përfunduar në Itali, përshkruan pikërisht fillin e jetës dhe të veprës së Prof. Zuber-it, me kontributin fillestar për zbulimin e naftës në Azerbajxhan, pastaj në Shqipëri dhe eksportin e naftës shqiptare në Itali.

Zv-Presidenti i NIK, Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë, z. Wojciech Kutyla, në fjalën e tij nënvizoi rëndësinë që ka për institucionin që ai përfaqëson dhe për mbarë shoqërinë dhe kombin polak njohja në detaje e veprës dhe kontributit të intelektualëve të shquar, si polakë ashtu edhe të vendeve mike dhe partnere me Poloninë, sikurse është Shqipëria dhe institucioni i auditimit suprem publik i saj, Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Prof. Dr. Arqile Teta, studiuesi i njohur dhe autor i librit monografik kushtuar Prof. Zuberit *"Prof. Stanislav Zuber-Jeta dhe vepra",* i përkthyer edhe në gjuhën polake në vitin 2017, në kumtesën e tij theksoi se *"Me Zuber-in filloi industrializimi i Shqipërisë. Disa ekonomistë të ditëve të sotme, në diskutimet që kemi bërë, e pranojnë këtë tezë; nuk gjejnë argumente ta rrëzojnë...Vetëm Prof. Zuberi arriti të zbulojë pellgun naftëmbajtës të Devollit(siç e quante atëhere Kuçovën Zuber-i) dhe në vitin 1928 shpoi pusin e parë që dha naftë në sasi dhe vlera industriale...Më vonë, kur u shtua dhe nafta e Patosit, Zuberi e zmadhoi diametrin e tubacionit nga Fieri në Vlorë në 300 mm. Filloi kështu eksporti i naftës shqiptare, si produkt industrial shqiptar. Kështu u hodh hapi i parë i*

industrializimit të vendit, që filloi nga industria e naftës që e projektoi dhe e ndërtoi Prof. Zuber-i".

Në kumtesat e tjera, studiues dhe gjeologë të njohur, si Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof. Dr. Shyqyri Aliaj, Prof. Dr. Aleksandër Çina, prof. Dr. Kujtim Onuzi, Prof. Dr. Gafur Muka dhe Prof. Dr. Sazan Guri sollën përmasat dhe vlerat e bibliografisë së tij, figurën e inxhinierit dhe gjeologut të madh polak si tektonist i shquar, kontributin në magmatizmin shqiptar, rëndësinë e hartave të tij, modelin topografik të hartave, si dhe studimet dhe kërkimet e naftës në hartat e Prof. Stanislav Zuber-it.

Takimin e mbyllën z.Leonard Zissi, në emër të Shoqatës së Miqësisë Shqipëri-Poloni dhe z.Astrit Beqiraj, i cili trajtoi një temë shumë interesante *"Jehonën e personalitetit të Prof.Stanislav Zuber në mediat shqiptare dhe njohja e veprës së tij në Poloni".*

Kontrolli i Lartë i Shtetit në Komitetin e Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit të Bashkimit Evropian

Bashkëveprimi ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve) të Bashkimit Evropian realizohet kryesisht brenda kuadrit të Komitetit të Kontaktit , i cili përbëhet nga Kryetarët e SAI-ve të vendeve anëtare.

Për 2018-ën takimi vjetor i Komitetit të Kontaktit dhe mbledhja teknike e zyrtarëve të koordinimit u organizuan më 11 dhe 12 tetor në Dubrovnik në kryesimin e SAI-t të vendit pritës Kroacisë. Në takim krahas Kryetarëve të SAI-ve të vendeve anëtare , u ftuan të marrin pjesë në cilësinë e observuesit aktiv SAI-t e Shqipërisë, Malit të Zi, Serbisë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë si dhe përfaqësues të SIGMA-s. Delegacioni i KLSH-së përbëhej nga znj.Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme dhe znj. Albana Gjinopulli Drejtore e Departamentit të Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit.

Qëllimi i takimit ishin diskutimet e përbashkëta ndërmjet SAI-ve, mbi praktikat dhe eksperiencat e tyre në auditime të temave specifike me rëndësi në zhvillimet e fundit të Bashkimit Evropian. Z. Ivan Klesic , Kryetar i SAI-t

Kroat në autoritetin e vendit udhëheqës të Komitetit të Kontaktit të SAI-ve për periudhën, në mirëseardhjen drejtuar pjesëmarrësve theksoi se: *"Komiteti i Kontaktit është një rrjet shumë efektiv për kontakte profesionale ndërmjet audituesve publikë të BE-së nëpërmjet grupeve të punës , forumeve dhe task forcave mbi çështje specifike të auditimit."*

Znj. Karen Hill , Drejtore e Programit SIGMA prezantoi mënyrat efiçente se si angazhimi publik mund të kontribuojë në politika dhe shërbime më të mira për qytetarët, ide e cila u trajtua më specifikisht nga znj. Laettitia Veriter përfaqësuese e *"Citizens for Europe/ Qytetarët për Evropën "* mbi mundësitë se si angazhimi i qytetarëve me SAI-t sjellin impakt në ruajtjen e besimit publik tek Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij. Qasje inovative mbi ndërveprimin e SAI-ve të BE-së me grupet e interesit dhe eksperiencat e vendeve anëtare në përdorimin e këtyre risive u sollën nga SAI-t e Hungarisë, Lituanisë dhe Bullgarisë.

Gjatë eventit dokumente, botime dhe revista të veprimtarive të SAI-ve nën kuadrin e rrjetit të Komitetit të Kontaktit u shpërndanë tek pjesëmarrësit. Revista e ECA " Në rrugën drejt Unionit, Ndihma e BE para-anëtarësimit", botim i muajit Gusht 2018, prezanton një intervistë ekskluzive të z. Bujar Leskaj, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi përfitimet dhe impaktin nga implementimi i Projektit "Forcimi i Kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm Publik në Shqipëri" nën Programin

How EU Pre-accession Aid helped our SAI to shape its future

IPA 2013, i realizuar me sukses nga SAI i Polonisë dhe SAI Kroat.

Paralelisht me takimin e Kryetarëve të SAI-ve u organizua dhe takimi në nivel teknik të koordinatorëve të vendeve anëtare, takim i cili trajtoi çështje lidhur me organizimin dhe koordinimin e veprimtarive që kryejnë dhe do të kryejnë Task Force dhe Grupet e Punës mbi bazën e vendimeve të marrë nga Komiteti i Kontaktit.

Raportimi dhe vendimmarrja mbi veprimtaritë e ardhshme të Komitetit të Kontaktit dhe Grupeve të Punës dhe Task Forcë që veprojnë nën këtë organizim u trajtuan nën këndvështrimin e propozimeve dhe zhvillimeve për periudhat e ardhshme. Në përfundim të takimit sipas procedurës dhe traditës z. Krysztof Kwatkowski, President i SAI-t të Polonisë mori dhe kryesimin e radhës për vitin e ardhëm, i cili iu dorëzua nga SAI Kroat në përfundim të periudhës një vjeçare.

Takim në Opole të Polonisë mbi Manualin Aktiv të Auditimit IT

Në datat 17-19 Tetor 2018, në Opole të Polonisë u zhvillua takimi i nëngrupit të Qeverisjes Elektronike dhe Manualit Aktiv të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Forma aktive e manualit të Auditimit IT ishte një nga produktet e bashkëpunimit gjatë projektit të binjakëzimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe NIK-ut polak. Manuali Aktiv u pranua si një formë dinamike e zhvillimit të manualit të Auditimit IT gjatë takimit të Grupit të punës së Auditimit IT të INTOSAI. Në të njëjtën kohë zhvillimi i mëtejshëm i këtij projekti u vendos dhe nga grupi i punës së EUROSAI-t.

Në takim e organizuar nga NIK-u i Polonisë morën pjesë dhe SAI të vendeve si: Estonia, Shqipëria, Bosnia & Herzegovina, Hungaria, Sllovakia, Mali i Zi, Letonia. Kontrolli i Lartë i Shtetit merr pjesë për herë të dytë në këtë takim dhe këtë vit u përfaqësua nga dy auditues të Drejtorisë së Auditimit IT, zj.Elira Cukalla dhe z.Meald Habazaj.

Fjalën e hapjes së takimit e mbajti drejtori rajonal i zyrës së NIK në Opole duke shprehur mirëseardhjen dhe vlerësimin për zhvillimin e hapësirës së e-Qeverisjes, apo "KUBI-t" që ka zhvilluar Grupi i Punës së TI në EUROSAI.

Zoti Pawel Banaś i cili është njëkohësisht dhe Këshilltar i Presidentit te NIK-ut të Polonisë, theksoi rëndësinë e KUBI-t si një mjet për të lehtësuar auditimet e qeverisjes elektronike.

Platforma e KUBI-t shërben si një bazë të dhënash në faqen e web të Internetit të EUROSAI-t, për publikimin e raporteve të auditimit nga SAI të ndryshme. Nëpërmjet KUBI-t bëhet e mundur jo vetëm një qasje tjetër mbi një auditim të njëjtë ose të ngjashëm që ka zhvilluar një tjetër SAI, por dhe informimi nëpërmjet gjetjeve të ngjashme, artikujve, metodologjisë si dhe materiale të ndryshme. Prezantimi vazhdoi me zhvillimet e reja të paraqitjes së raporteve dhe referencave mbi gjetjet në mënyrë grafike, çfarë lehtëson kërkimin dhe leximin e raporteve të ngjashme nga përdoruesit e platformës.

SAI-t pjesëmarrëse prezantuan rezultatet më kryesore të auditimeve IT që ka zhvilluar secili prej tyre. Nga audituesit e TI në KLSH u bë një prezantim mbi gjetjet kryesore të auditimit që kemi zhvilluar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Në ditën e dytë të takimit, grupin e punës e përshëndeti Zv-Presidenti i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë(NIK), z. Wojciech Kutyla, duke vënë theksin tek fakti se çdo njëri prej nesh duhet të mendojë se si IT i shërben dhe mund ta ndihmojë auditimin.

Manuali aktiv i IT është zhvilluar edhe më shumë si rezultat i një pune ambicioze e z. Paëel Banaś i SAI-t të Polonisë, z. Carlos

Cardoso Drejtor i departamentit në TI në Gjykatën e Llogarive të Portugalisë dhe z. Alo Lääne Audites i Lartë IT në SAI e Estonisë, ata vlerësuan dhe rolin e Drejtorisë së Auditimit të Teknologjisë së Informacionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë në këtë zhvillim. Ky manual është përmirësuar duke lehtësuar përdorimin dhe ndryshimet në zhvillimin e tij ishin dhe objektivi kryesor i takimit në ditën e dytë të tij. Ky tool që lehtëson më së mirë leximin dhe asimilimin e manualit IT, mund të shkarkohet nga faqet e INTOSAIT dhe EUROSAI-t për përdorim nga çdo SAI.

Në ditën e fundit të takimit, u prezantuan dhe ide të reja, të cilat janë dukë u zhvilluar së bashku me udhëzime për kontrollin e brendshëm (IC). Drejtuesit e takimit sugjeruan se çdo udhëzim të ri mund ta shohim të zhvilluar si një *tool* në mënyrë të ngjashme me atë të manualit Aktiv të IT.

Nga diskutimet se si çdo SAI mund te kontribuojë në zhvillimin e mjeteve të tilla si mundësi që ofrohen nga teknologjia, KLSH mori iniciativën të ndërtojë një plugin që i shërben manualit aktiv, që lidhet me zbatimin e rregullores së mbrojtjes së të dhënave ku zbatimi i saj është i detyrueshëm jo vetëm në vendet që janë anëtare të BE, por dhe në vendet ku punojnë shtetas europianë. Në fund të takimit u vlerësua fryma e bashkëpunimit midis vendeve pjesëmarrëse të grupit të punës si dhe kontributi i seicilit pasi i shërben rritjes së cilësisë së Auditimit të TI.

KLSH, pjesëmarrëse në takimin e EUROSAI-t mbi Metodologjinë e Auditimit

Në datat 16 dhe 17 Tetor 2018, u zhvillua në Varshavë, në ambientet e Zyrës Kombëtare të Auditimit, takimi i EUROSAI-t mbi metodologjinë e Auditimit. Në këtë takim të bashkëdrejtuar nga SAI Polak dhe SAI Suedez morën pjesë 57 përfaqësues të institucioneve supreme të auditimit nga 30 vende. Pjesë e kësaj tryeze ishin dhe përfaqësues të EUROSAI-t, të Iniciativës Ndërkombëtare të Zhvillimit të INTOSAI-t (IDI), të Gjykatës Evropiane të Auditimit (ECA), etj.

Në fokus të takimit ishte shkëmbimi i përvojave dhe përditësimi i arritjeve lidhur me përsosjen e metodologjisë së auditimit dhe zbatimin në praktikë të komponentëve të saj nga institucionet supreme të auditimit publik.

Takimi dy ditor ishte konceptuar mbi tre kolona bazë, rreth të cilave u orientuan prezantimet apo seancat e punës në grupe, që përfshinin:

1. Sigurimi i cilësisë së auditimit nëpërmjet zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

Këtu u nënvizuan domosdoshmëria e njohjes dhe ndërveprimit të shtyllave të sigurimit të kontrollit të cilësisë (autoriteti, përgjegjësia dhe përgjegjshmëria), mënyrat e eliminimit të gabimeve (vetëvlerësimet, vlerësimet e brendshme dhe rishikimet e vlerësimet e jashtme) dhe se sigurimi i cilësisë është një histori/proces që nuk përfundon kurrë.

2. Komunikimi me palët e interesit, përmes metodave moderne të prezantimit të gjetjeve dhe rekomandimeve të auditimit, të tilla si infografikët.

   Në këtë panel u diskutua rreth temave: përse komunikojmë rezultatet e angazhimeve profesionale dhe si mund të ngushtohet hendeku midis audituesit dhe komunikimit të gjetjeve dhe rekomandimeve; përdorimi i rrjetave të komunikimit për të marrë më shumë *feedback* mbi tema apo çështje që duhen audituar, etj.

3. Planifikimi dhe strategjia e auditimit duke përdorur analizën e riskut. Me interes ishte diskursi mbi nevojat, iniciativat dhe sfidat e procesit të planifikimit vjetor dhe strategjik, auditimet paralele, teknikat e reja të planifikimit të aktiviteteve dhe proceset e strukturat e planifikimit, dhe si të përmirësojmë vlerësimin e risqeve nëpërmjet ndihmës së programeve dhe aplikimit të IT-së.

Takimi nga ana tjetër, konfirmoi rëndësinë e angazhimeve të auditimeve paralele, si zhvillim i elementeve të Planit Strategjik të EUROSAI-t 2017-2023. Për këtë, u soll në vëmendje fakti se Iniciativa e Auditimit Paralel u krijua si një projekt i koordinuar nga SAI i Holandës gjatë takimit të 11 të grupit të punës ITWG në Pragë dhe se vendimi i marrë gjatë takimit të 12-të të ITWG në Talin shënoi kërkimin e zgjidhjes nga ana e IT-së, që të sigurojë paraqitjen e temave dhe do të ofrojë mekanizmat e përzgjedhjes mbi temat më të përshtatshme për auditimet e ardhshme paralele (duke pasur parasysh procesin e planifikimit nga vendet anëtare).

Konkluzionet e përgjithshme të këtij takimi krahas vlerësimit të rëndësisë dhe dobisë që sjellin takime të tilla për institucionet e larta kombëtare të auditimit, listuan disa aspekte dhe çështje që marrin rëndësi në stadin aktual të kooperimit dhe ndërveprimit midis SAI-ve, si: shkëmbimi i planeve vjetore të auditimit të SAI-ve, me qëllim planifikimin më të mirë të auditimeve paralele.

Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë takim nga audituesit Qeram Cibaku, Koço Sokoli dhe Orgest Levani.

KLSH merr pjesë në takimin e IX-të për Auditimin e Etikës, organizuar nga grupi Task Force (EUROSAI) për Auditimin e Etikës

Në datat 22-23 tetor 2018, u zhvillua në Lisbonë, takimi i IX-të i grupit Task Force të EUROSAI-it për "Auditimin dhe Etikën" (TFA&E). Në cilësinë e anëtarit të këtij grupi, KLSH mori pjesë në këtë aktivitet të rëndësishëm të EUROSAI-t, i cili trajtoi një prej çështjeve më aktuale për administratën publike, Etikën, e cila është e lidhur me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Trajtimi i kësaj teme është me rëndësi prioritare për institucionet supreme të Auditimit, të ngarkuara me mbikëqyrjen e menaxhimit të shëndoshë të financave publike.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e 20 SAI-ve: Gjykata Austriake e Auditimit, Gjykata Franceze e Llogarive, Gjykata Evropiane e Audituesve, Polonia, Hollanda, Shqipëria Maqedonia, Izraeli, Italia, Malta, Çekia, Hungaria, Finlanda, Rumania, Qipro,Serbia, Spanja, Turqia dhe Greqia.

Gjykata e Audituesve e Portugalisë, e cila kryeson grupin Task Force te EUROSAI-t ishte SAI mikpritës. Fjala përshëndetëse u mbajt nga Presidenti i Gjykatës Portugeze të Llogarive z. Vitor Caldeira. Gjatë fjalës së tij zoti Caldeira theksoi se EUROSAI beson se Task Forca për Auditim & Etikën po studion dhe punon fort për të arritur qëllimin kryesor atë të promovimit të sjelljes etike si në Institucionet Supreme të Auditimit dhe në organizatat publike. Ne do të përpiqemi që të jemi të dobishëm, të udhëheqim përmes shembullit, për të rritur vlerat e SAI-ve, lidershipin dhe stafin e tyre, si dhe për qytetarët të cilëve u shërbejnë-vijoi z.Caldeira.

Gjatë ditës së parë të takimit në aktivitet morën pjesë edhe rreth 30 auditues të Gjykatës Portugeze të Llogarive, të cilët ndërhynë disa herë gjatë prezantimeve, duke sjellë shembuj nga puna e tyre e përditshme.

Gjatë ditëve të takimit u trajtuan dhe u diskutuan çështje me interes si:

- Promovimi i Etikës në Organizatat e Sektorit Publik;
- Auditimi i Etikës në Organizatat e Sektorit Publik;
- Roli i SAI-ve në shpërndarjen e kulturës së integritetit;
- Implementimi i ISSAI 30 dhe ide të reja në këtë drejtim;
- Direktivat evropiane për mbrojtjen e bilbil-fryrësve;
- Sistemi i menaxhimit të anti-korrupsionit, etj;

Gjatë ditës së dytë, takimi u fokusua në referime dhe diskutime lidhur me inkurajimin e SAI-ve drejt promovimit të integritetit në sektorin publik. Në këtë

pjesë u përfshi edhe prezantimi i zj.Irena Islami, lidhur me rezultatet e Auditimit të Performancës mbi Strategjinë Antikorrupsion të Qeverisë shqiptare, realizuar edhe me mbështetjen e Inisiativës për Zhvillim të INTOSAI-t (IDI). Zonja Islami paraqiti objektivat e auditimit, kontekstin në të cilin u zhvillua auditimi, periudhën e auditimit, subjektet e audituara dhe veçanërisht mesazhet e auditimit, konkluzionet dhe rekom-andimet.

Auditimi është fokusuar në një nga objektivat e Strategjisë Antikorrupsion të Qeverisë Shqiptare " Miratimi i politikave anti korrupsion nga pushteti vendor". Një nga rekomandimet kryesore të KLSH-së ishte krijimi i Agjencisë Kombëtare kundër korrupsionit, me qëllim që të sigurohet implementimi i strategjisë me eficiencë dhe efektivitet. Zonja Islami falënderoi organizatorët dhe veçanërisht IDI-n për mbështetjen që i ka dhënë audituesve të KLSH-së gjatë këtyre viteve, në drejtim të rritjes së kapaciteteve audituese dhe modernizimit të institucionit.

KLSH nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me ILDKPKI

Në datën 26 tetor 2018, në mjediset e KLSH u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit midis Kontrollit të Lartë të Shtetit përfaqësuar nga Kryetari, Z. Bujar Leskaj dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, përfaqësuar nga z. Shkëlqim Ganaj.

Me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje, z. Leskaj u shpreh se synimi i nënshkrimit të saj është thellimi i mëtejshëm i një bashkëpunimi shumëvjeçar i cili i ka shërbyer rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike dhe drejtuesve të tyre dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit. Marrëveshja zyrtarizon përfshirjen e inspektorëve të ILDKPKI në grupet e auditimit të KLSH dhe sinergjizimin e programeve trajnuese për tema me interes të përbashkët. Ekspertiza e inspektorëve të ILDKPKI do të jetë një vlerë e shtuar për punën e grupeve të auditimit, të cilët përveçse kanë identifikuar dhe vazhdojnë të identifikojnë raste të përdorimit të parave publike për të identifikuar konfliktet e interesit, në të cilat janë përfshirë zyrtare të lartë përgjegjës për menaxhimin e parave te taksapaguesve shqiptarë. Z. Leskaj shprehu vlerësimin e tij më të lartë për veprimtarinë e ILDKPKI duke theksuar se ky institucion në 3 vitet e fundit ka intensifikuar luftën kundër korrupsionit të zyrtareve të lartë.

Z. Ganaj duke falënderuar z. Leskaj dhe institucionin e KLSH për bashkëpunimin e frytshëm midis dy institucioneve vlerësoi qasjen pa kompromis për të evidentuar çdo rast të shpërdorimit të fondeve publike. Ai theksoi se ndryshimi rrënjësor që ka pësuar institucioni i KLSH gjatë viteve të fundit është i dukshëm dhe publiku tashmë e percepton atë si një institucion serioz që punon për përmbushjen e misionit të tij kushtetues.

Marrëveshja e bashkëpunimit e nënshkruar midis dy institucioneve është plotësim i marrëveshjes së nënshkruar në vitin 2012. Kjo marrëveshje nënshkruhet edhe në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Progres Raportit të KE-së, për të cilat KLSH ka hartuar një plan veprimi për zbatimin e tyre, në të cilin një prej pikave i referohet edhe rekomandimit që lidhet me bashkëpunimin me ILDKPKI, lidhur me kryerjen e trajnimeve të përbashkëta të të dy institucioneve, referuar çështjeve që lidhen me konfliktin e interesave gjatë procedurave të prokurimit. Nënshkrimi i marrëveshjes bëhet edhe në kuadër të Muajit të hapur që po organizon KLSH në periudhën 25 tetor-14 dhjetor.

Takim mbi Planin Strategjik të EUROSAI-t 2017 - 2023

Më 30 – 31 Tetor 2018 në Tiranë, Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit, EUROSAI dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit zhvilluan me sukses punimet e takimit mbi një prej drejtimeve kryesore të Planit Strategjik të EUROSAIt 2017-2023, për mbështetjen e auditimeve efektive, inovative dhe adekuate përmes promovimit dhe ndërmjetësimit të bashkëpunimit profesional. Akiviteti u organizua në kuadrin e Muajit të Hapur që KLSH e ka bërë tashmë traditë të perfomancës së saj prej disa vitesh. KLSH u prezantua me një grup anëtarësh të stafit të drejtuar nga znj. Lindita Milo, Drejtor i Përgjithshëm, znj. Albana Gjinopulli Drejtore e Departamentit të Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit, znj. Irena Islami Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe auditues të nivelit të lartë.

Takimin e hapi, znj. Lindita Milo, Drejtor i Përgjithshëm në KLSH, e cila nënvizoi rëndësinë e këtij aktiviteti dhe iu uroi të pranishmëve mirëseardhjen, në emër të KLSH-së, si SAI mikpritës dhe organizator i këtij aktiviteti. Zonja Milo, theksoi që KLSH

ka qenë dhe do të jete pjesë e të gjitha aktiviteteve të EUROSAI-t sepse kjo organizatë e themeluar që në vitin 1990 ka si qëllim ndërtimin e një kuadri për shkëmbimin e njohurive midis Institucioneve të Auditimit Publik, duke promovuar fuqizimin reciprok dhe përmirësimin e auditimit të fondeve publike. 50 SAI-t anëtarë formojnë një qark të larmishëm që përfaqëson Institucione Supreme të Auditimit (SAI) me modele organizative, mandate, nevoja dhe prioritete të ndryshme.

Deri në vitin 2023, EUROSAI synon të jetë transformuar në një ndërmjetës dinamik dhe i udhëhequr nga dija i cili i përgjigjet nevojave specifike të zhvillimit të anëtarëve, kushteve të ndryshme sociale dhe administrative në të cilat ata veprojnë dhe burimeve që kanë në dispozicion. Ky zhvillim do të udhëhiqet nga dy qëllime strategjike dhe do të mbështetet nga përmirësimet në qeverisjen e EUROSAI-t: 1) Mbështetja e auditimeve efektive, inovative dhe adekuate përmes promovimit dhe ndërmjetësimit të bashkëpunimit profesional; 2) Ndihmesa ndaj SAI-ve në përballjen me sfidat e reja nëpërmjet mbështetjes në zhvillimit të kapaciteteve të tyre institucionale.

Duke punuar për këto qëllime, EUROSAI mbështet SAI-t anëtare në ofrimin e auditimeve me cilësi të lartë dhe forcimin e llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të qeverisjes dhe njësive të sektorit publik në vendet e tyre. Takimi mbi Qëllimin Strategjik 1 : Mbështetja e auditimeve efektive, inovative dhe adekuate përmes promovimit dhe ndërmjetësimit të bashkëpunimit profesional synoi të mblidhte sëbashku përfaqësuesit e SAI-ve udhëheqëse të grupeve të punës, task forcës dhe projekteve të krijuara nën kuadrin e këtij qëllimi dhe objektivave specifike.

SAI i Gjermanisë dhe SAI i Republikës së Çekisë drejtuan punimet dy ditore mbështetur në progresin e arritur nën këndvështrimin e aktiviteteve për të ardhmen. Përfaqësuesja e Gjykatës Turke të Auditimit njohu të pranishmit me Planin Operacional, i cili mbështet me veprime dhe aktivitete konkrete çdo objektiv dhe qëllim të vendosur në Planin Strategjik të EUROSAI-t.

Nën objektivin që SAI-t të aftësohen për të krijuar me fleksibilitet auditime bashkëpunuese dhe t'i përgjigjen sfidave ekzistuese dhe atyre në zhvillim kur lind nevoja, Kontrolli i Lartë i Shtetit prezantoi vlerat dhe përfitimet nga eksperienca e pjesëmarrjes në auditime paralele të organizuara nën ombrellën e EUROSAI-t. Megjithëse jo të panjohura në spektrin teorik, vetëm pas vitit 2012 auditimet paralele morën zhvillim edhe në Shqipëri, duke ofruar rezultate pozitive si instrument efektiv për rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përtej kufijve të një vendi. Pjesëmarrja në auditimet paralele me SAI te vendeve të rajonit por gjithnjë të drejtuara nga SAI të vendeve anëtare të BE, i ka ofruar KLSH mundësi unike të veprimtarisë audituese.

Sfida e EUROSAI-t në të ardhmen është të mbetet një organizatë atraktive dhe që i përket të gjithë anëtarëve. Suksesi në këtë

përpjekje mund të arrihet vetëm përmes ndryshimeve dhe përmirësimeve po ashtu dhe ndërveprimin reciprok ndërmjet të gjithë aktorëve, dhe si pjesë e këtij kuadri KLSH mbetet i angazhuar për të kontribuar denjësisht në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

KLSH merr pjesë në Seminarin e Task Forcës për Auditimin e Bashkive, organizuar nga EUROSAI me temë *"Financat e Pushtetit Lokal -Sfidat për të ardhmen"*

EUROSAI organizoi takimin vjetor të anëtarëve të TaskForcës së EUROSAI-tpër Auditimin e Bashkive(TFMA) dhe Seminarin për Auditimin e Bashkive, në Beograd në datat 5 dhe 6 nëntor 2018, me temë kryesore *"Financat e Pushtetit Lokal - Sfidat e ardhshme".* Në këtë aktivitet KLSH u përfaqësua nga z. Qemal Shehu, drejtor i departamentit të auditimit të buxhetit vendor, z.Sali Agaj, auditues i lartë në departamnetin e auditimit të performancës, z.Albert Thoma, auditues i lartë në departamentin e auditimit të buxhetit vendor.Task Forca e EUROSAI për Auditimin e Bashkive u krijua në qershor të vitit 2016, kur Bordi Drejtues i EUROSAI-t mbështeti iniciativën e Zyrës Shtetërore të Auditimit të Lituanisë për të mbledhur SAI-t e interesuara për çështjet e auditimit të pushtetiti vendor. Kjo Task Forcë, e përbërë nga 26 anëtarë të SAI-ve të Europës, anëtar i së cilës është edhe KLSH synon të përmirësojë sistemet dhe procedurat në lidhje me auditimin e bashkive, shkëmbimin e praktikave më të mira për të arritur rezultatet e auditimit me ndikim thelbësor në drejtim të përmirësimit të menaxhimit financiar publik, përmirësimit të auditimit të jashtëm, në mënyrë që rezultatet të sjellin ndryshime dhe përfitime pozitive si për qytetarët e bashkive ashtu edhe për tatimpaguesit në përgjithësi.

Në seminar morën pjesë rreth 40 përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga Shqipëria, Austria, Kroacia, Danimarka, Estonia, Bosnje-Hercegovina, Finlanda, Greqia, Hungaria, Izraeli, Italia, Letonia, Lituania, Maqedonia, Malta, Moldavia, Mali i Zi, Polonia, Portugalia, Serbia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Turqia dhe Ukraina.Gjatë dy ditëve të seminarit, nga pjesëmarrësit u diskutua mbi situatën e financimit të autoriteteve lokale, menaxhimi efektiv financiar dhe përgjegjësitë lokale, huamarrja dhe borxhi si dhe roli i autoriteteve qendrore në këtë proces.

Seminari i Task Forcës mbi Auditimin e Bashkive përsëriti faktin se tendencat globale në fushën e menaxhimit të shpenzimeve publike po ndryshojnë nga dimensioni i disiplinës fiskale tek dimensioni i performancës, duke u shtrirë në rezultatet e bashkive në drejtim të realizimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, duke kërkuar përhapjen e praktikave më të mira në auditimin e bashkive, me qëllim informimin e ligjvënësit, ekzekutivit dhe

publikut të gjerë mbi rolin në rritje të auditimit të jashtëm publik në drejtim të përmirësimit të menaxhimit në të gjithë sektorin publik.

Gjatë dy ditëve u organizuan dhe tryeza pune, për përvojat specifike në auditimin e bashkive, ku grupi pjesëmarrës nga KLSH,u përfshi në diskutimin e çështjeve dhe paraqitjen e situatës së menaxhimit financiar bazuar në auditimet e ushtruara, gjetjet kyçe, rekomandimet, etj.

Në fund të takimit përfaqësuesit e SAI-ve shqyrtuan aktivitetet që kanë të bëjnë me Planin e Punës në periudhën 2017-2020 dhe veçanërisht në lidhje me planin e veprimit për vitin 2019. Propozimet e parashtruara në këtë takim nuk konsiderohen shteruese, por do të diskutohen online ndërmnjet anëtareve të Task Forcës, përpara zhvillimit të aktiviteteve të ardhshme.

Kryetari i KLSH-së zhvillon një vizitë zyrtare në Kroaci

Në datat 8-9 nëntor, Kryetari i KLSH-së, Z.Bujar Leskaj zhvilloi një vizitë zyrtare dy ditore në Kroaci me ftesë të Auditorit të Përgjithshëm të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, z.Ivan Klesic, me rastin e përfundimit të mandatit 7 vjeçar të z.Leskaj në fund të vitit 2018. Takimi i mirëseardhjes u zhvillua në zyrat qendrore të SAI-t Kroat dhe më pas u zhvillua një takim i zgjeruar me drejtues dhe auditues të SAI-t të Kroacisë.

Auditori i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, z.Ivan Klesic bëri një prezantim lidhur me mënyrën e organizimit dhe të funksionit të SAI-t kroat. Kjo zyrë ka qendrën në Zagreb dhe ka 20 degë të shpërndara në rajonet kryesore të vendit. Departamentet e auditimit janë organizuar në funksion të subjekteve të audituara dhe llojeve të auditimit. Zyra drejtohet nga Auditori i Përgjithshëm, i cili zgjidhet nga Parlamenti i Kroacisë dhe propozohet nga komisioni për çështjet administrative, të zgjedhjeve dhe emërimeve.Zyra Shtetërore e Auditimit të Kroacisë e zhvillon veprimtarinë e saj bazuar në ligjin për funksionimin e kësaj zyre dhe ka mandat për të audituar, të ardhurat dhe shpenzimet; pasqyrat financiare dhe transaksionet financiare; entitetet publike, kompanitë dhe personat legalë, në të cilët shteti ka shumicën e aksioneve; përdorimin e fondeve të BE-së dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare lidhur me përdorimin e këtyre fondeve për nevoja publike. Zoti Klesic vijoi prezantimin e tij me mënyrën e raportimit të SAI-t në parlament, politikat e burimeve njerëzore, të komunikimit dhe transparencës, etj.

Më pas Kryetari i KLSH-së zhvilloi një leksion me drejtues dhe auditues të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë. Zoti Leskaj pasi bëri një prezantim të shkurtër të KLSH-së dhe më pas mbështetur dhe në moton e Kongresit të IX-të të EUROSAI-t, të zhvilluar në Holandë : "Kur është hera e fundit që keni bërë diçka për herë të parë?", përcolli përpara audituesve kroatë 10 risitë që janë implementuar për herë të parë në KLSH këto shtatë vitet e fundit :

1. Miratimi i Ligjit të Ri të KLSH-së në nëntor të vitit 2014, i cili e solli veprimtarinë e KLSH-së në përputhje me standartet e I NTOSAI-t;
2. Zhvillimin e auditimeve të Performancës, duke filluar nga viti 2012 (deri tani janë realizuar 80 auditime performance);
3. Zhvillimin e auditimeve të IT, duke filluar nga viti 2015 (deri tani janë realizuar 15 auditime IT);
4. Kallëzimet penale, të cilat nuk kanë qenë qëllim në vetvete për KLSH-në por i kanë shërbyer luftës kundër korrupsionit. Që nga viti 2012 deri tani, KLSH ka bërë 299 kallëzime penale, që do të thotë një kallëzim penal në javë;
5. Botimet e KLSH-së, të cilat deri në fund të vitit 2018 do të jenë 101(në shtatë vjet), ndërkohë që në 20 vjet KLSH ka pasur vetëm 12 publikime (1991-2011);
6. KLSH ka botuar një revistë kërkimore shkencore, në gjuhën shqipe dhe angleze, në shtatë vjet 20 numra të kësaj reviste;
7. Muaji i Hapur, i cili në kuadër të transparencës së aktivitetit të institucionit është zhvilluar për disa vite radhazi dhe ka pasur një impakt të gjerë në publik;
8. Gjashtë Konferencat shkencore të KLSH-së, e para është zhvilluar në vitin 2012 dhe e shtata do të zhvillohet në datat 12-13 dhjetor 2018;
9. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe, Universitetet dhe veçanërisht me OJF-të (në total 57 marrëveshje, 30 nga të cilat me OJF-të);
10. Vendosja e stafit të KLSH-së në godinën e re dhe zhvillimi i aktivitetit auditues në kushte komode.

Gjithashtu Kryetari i KLSH-së vlerësoi implementimin e projektit të binjakëzimit nga pala kroate dhe polake dhe u fokusua në komponentët dhe misionet e zhvilluara nga ekspertët kroatë, auditimet e performancës dhe kontrolli i cilësisë. Gjatë implementimit të projektit u realizuan 107 misione, 10 takime pune , mbi 100 drejtues dhe auditues morën pjesë në takime pune dhe në trajnime me ekspertët polakë dhe kroatë, etj.

Delegacioni zhvilloi edhe një vizitë në Bashkinë e qytetit të Vinodolit, në bibliotekën dhe në vendin e lindjes të piktorit Juraj Julije Kloviç (1498 - 5 janar 1578), i cili ishte një illuminator, miniaturist dhe piktor i lindur në Mbretërinë e Kroacisë, i cili ishte kryesisht aktiv në Italinë e Rilindjes. Ai konsiderohet si iluminatori më i madh i Rilindjes së Lartë Italiane, dhe me sa duket artisti i fundit shumë i njohur në traditën e gjatë të dorëshkrimit të ndriçuar, para disa risive moderne.

Kryetari i Bashkisë së Vinodolit, z. Marinko Karliç i rezervoi delegacionit të KLSH-së një pritje shumë të përzemërt dhe e nderoi

Kryetarin e KLSH-së me titullin "Qytetar nderi" i Vinodolit, përmes një ceremonie të mirë-organizuar, me shumë të ftuar, duke përcjellë shumë emocione pozitive. Në ceremoni ishin ftuar edhe instrumentistë dhe grupe folklorike të zonës.

Kryetari i KLSH-së shoqërohej në këtë vizitë nga z.Rinald Muça, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës, zj.Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe zj.Amantja Patozi, specialiste pranë kësaj Drejtorie. Vizita e arriti qëllimin e saj dhe kaloi në një atmosferë shumë miqësore.

KLSH zhvilloi në Tiranë trajnimin me temë "Teknologjia e informacionit - Mbështetje IT në proceset e auditimit dhe softwerët e auditimit"

Në datat 14-15 Nëntor 2018, në Tiranë, u zhvillua trajnimi IT me temë "*Teknologjia e informacionit-Mbështetje IT në proceset e auditimit dhe softwerët e auditimit".*Ky bashkëpunim udhëhiqet nga misioni i Rrjetit të vendeve kandidate dhe vendeve potenciale kandidate për në BE, duke synuar kërkimin e zgjidhjeve për problemet e përbashkëta dhe zhvillimin progresiv të punës audituese të SAI-ve të vendeve të këtij rrjeti në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ky trajnim u organizua bazuar në planin e punës të Rrjetit për periudhën 2018-2020, i cili është zhvilluar në bazë të inputeve të nxitura nga një sondazh i shkurtër i kryer nga SIGMA për të marrë pikëpamjet e rrjetit mbi prioritetin e aktiviteteve. Kontrolli i Lartë i Shtetit ishte SAI mikpritës

dhe në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga SAI-t e Turqisë, Serbisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Bosnje-Hercegovinës. Fokusi kryesor i trajnimit ishte mbështetja e IT në proceset e auditimit.

Drejtoresha e Përgjithshme znj.Lindita Lati (Milo), në emër të Kryetarit të KLSH, përshëndeti dhe u uroi mirëseardhjen SAI-ve pjesëmarrëse në aktivitet. Në fjalën përshëndetëse znj.Lati theksoi se zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit vendosi nevojën për të përmirësuar kapacitetin tonë për të absorbuar teknologjinë e re dhe për të mbështetur qasjen inovative të auditimit IT.

Trajnimi u moderua nga Drejtoresha e Departamentit të Strategjisë dhe Metodologjisë së Auditimit, znj.Albana Gjinopulli.

Takimi i ditës së parë nisi me prezantimin e metodologjisë së auditimit, objektivave dhe proceseve që përfshin auditimi. Kjo temë u referua nga Drejtoresha e Departamentit të Strategjisë dhe Metodologjisë. Gjatë prezantimit znj.Gjinopulli theksoi rëndësinë e metodologjisë së auditimit si një nga elementet thelbësorë për të realizuar një auditim me cilësi dhe të mbështetur në standardet ndërkombëtare. Ditën e parë pjesëmarrësit ndoqën me interes 2 tema të mbajtura nga z. Kozma Kondakçiu, Drejtor i Drejtorisë së Auditimit IT në KLSH e konkretisht atë të *"Përdorimit të Manualin Aktiv të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit"* dhe të *"Përdorimit të teknikave Vizualizuese në Auditim"* në KLSH.

Pjesëmarrësit ndoqën me shumë interes temat e prezantuara nga SAI i Maqedonisë dhe Serbisë për suportin IT dhe mbështetjen e saj në auditimet e zhvilluara. Të dyja këto SAI treguan teknikisht softwaret që ata përdorin në një proces auditimi qoftë IT apo i kombinuar. Trajnimin e përshëndetën dhe prezantuan eksperiencën e tyre përfaqësues të Gjykatës Europiane të Audituesve (ECA-s), znj. Magdalena Cordero Valdavida, Drejtore e IT dhe z. Emanuele Fosseti përgjegjës sektori IT.

Temat e prezantuara në ditën e dytë të aktivitetit ishin teknike dhe shumë të detajuara për audituesit IT, të cilët jo vetëm mund të mbështesin audituesit në procesin e auditimit por arrijnë të analizojnë një databazë dhe të kenë rezultate pozitive. Gjatë ditës së dytë të trajnimit peshën kryesore e kishte SAI Turk, i cili prezantoi zhvillimin e Data Mining, përdorimin e aplikacioneve dhe nxjerrjen e të dhënave gjatë auditimit. Përfaqësuesit e SAI-t Turk treguan me shembuj dhe ilustrime se si ata realizojnë procesin e përpunimit të të dhënave, mjetet dhe teknikat.

Nga z. Aldo Kita përgjegjësi i Sektorit IT-së në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Llogjistikës në KLSH prezantoi praktikën e KLSH-së në menazhimin e proceseve dhe konkretisht *"Sistemin e Informacionit për Menaxhimin dhe Mbështetjen e Proceseve të Auditimit" (SIMMPA).*

Të dy ditët e trajnimit u ndoqën me shumë interes dhe nuk munguan pyetjet, sugjerimet dhe ndarje e eksperiencës midis SAI-ve pjesëmarrëse. Trajnimi u shoqërua dhe me aktivitete sociale dhe me shumë interes nga të ftuarit u prit vizita në Muzeun Historik Kombëtar.

KLSH merr pjesë në tryezën e rrumbullakët ndër-institucionale organizuar nga USAID

Në kuadër të implementimit të projektit "Transparenca në sistemin shëndetësor" financuar nga USAID, në datën 14 nëntor 2018 u organizua në Tiranë një tryezë e rrumbullakët me temë *"Fuqizimi i transparencës institucionale dhe angazhimit qytetar për përmirësimin e cilësisë në sistemin shëndetësor-sfida dhe mundësi bashkëpunimi".*

Në këtë takim morën pjesë drejtues të tre institucioneve që janë pjesë e këtij projekti : KLSH, ILDKPKI dhe Avokati i Popullit, si dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe medias. Gjatë takimit u diskutua rreth angazhimit qytetar në rritjen e transparencës dhe cilësisë në sistemin shëndetësor.

Fjalën e rastit në këtë tryezë e mbajti zj.Mikaela Meredith, Drejtoreshë e USAID për Shqipërinë. Zonja Meredith ritheksoi faktin që projekti ka për qëllim krijimin e një mjedisi më të përgjegjshëm për përdorimin e parave publike duke forcuar institucionet mbikëqyrëse si KLSH, Avokati i Popullit dhe ILDKPKI dhe duke rritur bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe median.

Asistenca teknike që USAID po i ofron KLSH-së konsiston në përmirësimin e auditimeve të performancës në sektorin e

shëndetësisë, rritjen e aksesit të qytetareve tek informacioni, futjen e disa zgjidhjeve teknologjike për sistemin e ankesave, përdorimin e të dhënave të hapura dhe treguesve të alarmit-red flags për fusha të prirura për korrupsion, etj. Më pas e mori fjalën Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, i cili theksoi që realizimi i kësaj tryeze të rrumbullakët nuk përbën thjesht një aktivitet të radhës, por përfaqëson një moment të rëndësishëm të paraqitjes së instrumenteve që janë projektuar dhe që kanë filluar të aplikohen nga institucioni, me synimin e rritjes së transparencës tek shoqëria civile dhe tek publiku i gjerë, por jo vetëm. Përfitimi nga përdorimi i teknologjisë së informacionit, për të identifikuar transaksionet me risk më të lartë potencial në procedurat e prokurimit publik ndikon në rritjen e efiçiencës dhe impaktit të aktivitetit auditues të KLSH-së. Kryetari i KLSH e cilësoi kontributin e dhënë ndër vite nga USAID-i në Shqipëri si *"...unikal dhe të rëndësishëm për fuqizimin e institucioneve të pavarura të Shtetit Shqiptar, ndërtimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të administratës sonë publike, fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile, zhvillimin e sektorit privat, reformën zgjedhore, reformën administrative e territoriale dhe së fundmi dhe kryesoren, reformën në drejtësi".*

Në emër të Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit bëri një përmbledhje të rezultateve të Projektit, z. Flori Karaj, i cili u përqendrua në plotësimin on-line të Deklaratave të deklarimit të pasurive të zyrtarëve shqiptarë, duke e cilësuar si një produkt shumë dobiprurës të këtij projekti. Në fund të takimit me shumë interes ishin edhe rezultatet e arritura nga disa OJF dhe përfaqësues të mediave, të cilat kishin përfituar grante të vogla për këtë.

Gjatë takimit, të tre institucionet paraqitën arritjet dhe sfidat e tyre kryesore në rritjen e transparencës institucionale dhe angazhimit qytetar, si një kusht për luftë efikase ndaj korrupsionit me fokus në sektorin shëndetësor. Ndërkaq, takimi shërbeu si një platformë për dialog me organizatat e shoqërisë civile dhe median sesi të forcohet zbatimi i parimeve të mirëqeverisjes, të rritet transparenca dhe të mbrohen fondet dhe asetet publike nga abuzimi.

KLSH merr pjesë në edicionin e XXI-të të Panairit të Librit

Në datat 14-18 nëntor 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në edicionin e XXI-të të Panairit të Librit, në Tiranë, duke shënuar kështu për të gjashtin vit radhazi një pjesëmarrje dinjitoze, duke u paraqitur me 95 botime përkundrejt 17 botimeve të vitit 2013, kur mori pjesë për herë të parë modestisht në këtë panair. Botimet e KLSH, krahas informimit të opinionit të gjerë publik, i ndihmojnë audituesit publikë për formimin e kapaciteteve të tyre, zbatimin rigoroz të standardeve të INTOSAI-t dhe shkëmbimin e eksperiencave të mira të punës, në bazë të motos së INTOSAI-t "Nga eksperienca e përbashkët përfitojnë të gjithë".

Në datën 16 nëntor në Pallatin e Kongreseve u organizua promovimi i

kolanës së botimeve të KLSH-së. Në këtë aktivitet morën pjesë drejtues e auditues të KLSH-së, Prof. Dr. Skënder Osmani, Prof.Dr.Pajtim Ribaj, Prof.Dr. Sazan Guri, përkthyesi Astrit Beqiraj, ekspertë të jashtëm të KLSH-së dhe përfaqësues të medias.

Aktivitetin e hapi Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj, i cili theksoi se *"mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit për vitet 2018-2022 dhe në Strategjinë e Komunikimit të KLSH-së 2017-2019, ne jemi mbledhur sot në këtë sallë për të promovuar botimet e KLSH-së në vite dhe veçanërisht ato të vitit 2018. Titujt e botimeve të KLSH-së në këto shtatë vite janë vërtet impresionues, si për lamirshmërinë e temave, thellësinë e argumentit shkencor, të dhënat historike, vlerën e konkluzioneve dhe përsiatjeve, ashtu dhe për sasinë e informacionit që përmbajnë, si për lexuesit e fushës së auditimit dhe të ekonomisë, ashtu edhe për lexuesin e thjeshtë të interesuar për fushën e auditimit".* Kolana e botimeve të KLSH-së është shtuar gjatë viteve të fundit me tituj gjithnjë e më cilësorë dhe në panairin e këtij viti, ne po paraqitemi me kolanën e botimeve tona me 95 tituj, ndër të cilët :

- 20 numra të Revistës Kërkomore-Shkencore "Auditimi Publik" në gjuhën shqipe dhe angleze;
- 7 analiza vjetore të punës së KLSH-së;
- 8 botime që i dedikohen Performances së institucionit në shqip dhe në anglisht;
- 10 volume të shkrimeve të përmbledhura të audituesve në shtypin e përditshëm
- 6 volume që lidhen me Konferencat Shkencore vjetore të KLSH-së;
- 17 tituj që lidhen me Standartet INTOSAI, Manuale dhe Guida të auditimit;
- 4 tituj që lidhen me Etikën dhe Integritetin;
- 16 tituj te tjerë që pasqyrojnë auditimet e KLSH-së në vitet 2012-2015, strategjitë e KLSH-së, historikun e INTOSAI-t, etj.

Më pas, z.Leskaj-vijoi me faktin që botimi i gjithë këtyre titujve është në të njëjtën linjë me qasjen e re që KLSH ka përqafuar këto vitet e fundit, e cila është në përputhje të plotë dhe bazohet në standardet profesionale të auditimit publik suprem, ISSAI-t.

Pas Kryetarit, z.Bujar Leskaj e mori fjalën Sekretarja e Përgjithshme, zj.Luljeta Nano, e cila prezantoi 11 botimet e përfunduara të vitit 2018, duke theksuar që KLSH vjen në këtë event kulturor në vijim të traditës së krijuar tashmë prej shtatë vitesh me një kolanë botimesh, librat e së cilës përfaqësojnë një gamë të pasur vlerash,

punimesh, hulumtimesh, pasqyrim të veprimtarisë institucionale dhe kontribute të lidershipit dhe stafit të KLSH-së, por jo vetëm. Kontribute me mjaft vlerë vijnë nga bota akademike, nga profesionistë të njohur vendas dhe të huaj të fushës së ekonomisë, auditimit, kontabilitetit, etj.

Drejtoresha e Përgjithshme e KLSH-së, znj.Manjola Naço, bëri një prezantim të 20 numrave të Revistës Kërkimore-Shkencore "Auditimi Publik". Znj.Naço theksoi se arritja deri tek numri 20 i revistës është një dëshmi e suksesit të shënuar nga KLSH në këtë zhanër që për nga vetë formati si Revistë Kërkimore Shkencore përbën një sfidë të vërtetë. Në këto 20 numra të Revistës janë botuar 316 punime, përkthime dhe artikuj shkencorë, 53 profile të SAI-ve homologe dhe 41 përkthime të artikujvë të personliteteve të INTOSAI-t dhe të fushës së auditimit.

Një prezantim që u ndoq me interes ishte ai i përkthyesit të njohur të gjuhës polake, z.Astrit Beqiraj, i cili është njëkohësisht edhe përkthyesi i një prej librave të kolanës së KLSH-së, "NIK-u polak, tradita dhe bashkëkohësia", i cili gjatë fjalës së tij bëri një përmbledhje të librit duke konstatuar që Institucioni i Auditimit Suprem të Polonisë veç funksionit primar, atë të auditimit të financave publike, ka edhe dimensione të tjera si psh përcjelljen e njohurive dhe përvojave, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rigjetejen e veprave të zhdukura të artit, etj.

Më pas, Kryeauditueseja Aulona Jonuzi paraqiti një përmbledhje të librit Jeshil të Zyrës së Llogaridhënies së Qeverisë së SHBA, botur gjatë 2018. Libri Jeshil vjen për audituesit e KLSH-së dhe më gjerë në kontekstin e një udhërrëfyesi praktik mbi kërkesat specifike ndaj vlerësimit dhe raportimit të kontrolleve në qeverinë federale të SHBA-ve. Libri Jeshil i qaset kontrollit të brendshëm nëpërmjet një strukture hierarkike prej pesë komponentësh, 17 parimesh dhe 77 atributesh. Atributet vijnë në formën e informacioneve shtesë dhe synojnë të shpjegojnë më saktësisht se çfarë do të thotë një parim dhe çfarë është menduar të mbulojë ai, ose përfshijnë shembuj të procedurave që mund të jenë të përshtatshme për një njësi ekonomike.

Në fund e mori fjalën Drejtoresha e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, znj. Irena Islami, e cila u përqëndrua në diskutimin e saj në pesë librat që do të përmbyllin serinë e botimeve të KLSH-së për vitin 2018 : Dokumente të Kryetarit, 2016-tetor 2018; Bashkëpunimi me GAO, ECA, NIK dhe SAI i Kuvajtit; Trajnimi dhe zhvillimi profesional; Auditimet e Performancës në KLSH nëntor 2017-2018 dhe Auditimet IT dhe Volumi i XI, "Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm".

Zonja Islami bëri një paraqitje të shkurtër lidhur me përmbajtjen e këtyre pesë titujve

dhe u ndal vecanërisht në botimin "Trajnimi dhe zhvillimi profesional i audituesve të ECA dhe eksperienca e KLSH në trajnimin e stafit gjatë shtatë viteve të fundit". Për KLSH që synon të jetë një institucion profesional i besueshëm, ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit është objektiv parësor. Një ndihmë cilësore për metodologjinë e hartimit të planeve efektive të trajnimit është eksperienca e Gjykatës Evropiane të Audituesve(ECA). Për ta sjellë sa më pranë audituesve të KLSH metodologjinë dhe qasjen që kjo Gjykatë ka ndjekur ndër vite për trajnimin e stafit të saj, KLSH ka përkthyer dhe do të publikojë botimin *"Trajnimi dhe zhvillimi profesional i audituesve të ECA dhe eksperienca e KLSH në trajnimin e stafit gjatë shtatë viteve të fundit".*

Kryetari i KLSH-së duke falenderuar të pranishmit e mbylli aktivitetin, duke nënvizuar *".. e kemi theksuar edhe në aktivitete të tjera si dhe në panairin e vitit të kaluar që sfida jonë ishte 100 tituj në fund të vitit 2018. Me numrin e botimeve që kemi realizuar deri tani si institucion, mund te themi që nuk kemi më përpara nesh një sfidë por një realitet. Botimet e KLSH-se në fund të këtij viti do të jenë 101 tituj. Këto botime i shërbejnë rritjes se transparencës dhe llogaridhënies, duke bërë një hap të rëndësishëm sasior dhe cilësor në kontributin ndaj mirëqeverisjes, përmes bërjes publike dhe transparente të të gjithë veprimtarisë së institucionit dhe rritjes së kapaciteteve në fushën e auditimit publik.*
Dëshiroj së fundmi të nënvizoj që kolana e botimeve të KLSH-së është në krye të 10 risive që janë realizuar nga KLSH dhe për këtë duhet të ndihemi krenarë të gjithë. Unë mendoj që kjo kolanë do të jetë një gjurmë, mes shumë të tjerave që ne do të lemë në punën e KLSH, për të cilën të gjithë kemi kontributin tonë".

KLSH promovon librin "Përjetësia e dyfishtë" të autorit Bedri Islami

Në datën 19 nëntor në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në sallën "Lech Kaczynski", u promovua libri "Përjetësia e dyfishtë", me autor Bedri Islamin, që i kushtohet dy heronjve të luftës së Kosovës, Fehmi Lladrovci dhe Xheva Krasniqi-Lladrovci.

Në këtë aktivitet morën pjesë përveç autorit dhe audituesve të KLSH-së, i ngarkuari me punë i Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë, z.Syl Ukshini, Kryetari i Komunës së Drenasit z.Ramiz Lladrovci, z.Namik Dokle, z.Dilaver Goxhaj, z.Ismet Sulejmani, poeti Xhevahir Spahiu, shkrimtari Sulejman Mato, z.Ago Nezha, aktorët Bujar Asqeriu e Mirush Kabashi, etj.

Aktivitetin e hapi Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, i cili nënvizoi faktin që ishte një nder i veçantë për institucionin organizimi i promovimit të librit "Përjetësia e dyfishtë", me autor Bedri Islamin, që i kushtohet dy heronjve të luftës së Kosovës, Fehmi Lladrovci dhe Xheva Krasniqi-Lladrovci, dy intelektualëve, të cilët morën pjesë në dy luftëra, pra dy herë luftuan me armë në dorë kundër Serbisë pushtuese, herën e parë në Kroaci, herën e dytë në Atdheun e tyre në Kosovë dhe kaluan në përjetësi.

Në fjalën e tij, z. Ismet Sulejmani, anëtar i Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK), theksoi që 22 shtatori i vitit 2018 shënoi 20 vjetorin e rënies heroike të veprimtarit të madh kombëtar, ilegalit me konspiracion të çeliktë, organizatorit e udhëheqësit të shkëlqyer të lëvizjes kombëtare politike klandestine në Kosovë, Kryetarit të LPK-së në Gjermani, gjeneralit legjendar të UÇK-së e të popullit shqiptar, komandantit historik të Drenicës, heroit të kombit, të lavdishmit Fehmi Lladrovci dhe bashkëshortes e bashkëluftëtares së tij heroinë Xhevës.

Fehmiu e Xheva kudo që ishin, veprimtarinë patriotike për çlirimin e Kosovës, jo vetëm nuk e ndalën e nuk e ulën, por e rritën dhe e pasuruan me gjithçka, edhe luftën e armatosur kundër Serbisë pushtuese e bënë edhe në Kroaci, ndërkohë që përgatitjet për të filluar lufta e armatosur çlirimtare në Kosovë i kishin të pandërprera.

I ngarkuari me punë i Republikës së Kosovës në Republikën e Shqipërisë, z. Syl Ukshini, mori fjalën dhe e cilësoi autorin e librit, z.Bedri Islami si kronistin më të mirë të UÇK dhe në këtë vepër shkruhet e vërteta për UÇK, si organizimi politiko-ushtarak më i mirë që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit.

Shkrimtari Sulejman Mato, veçoi dicka nga jeta personale e të dy heronjve Fehmi Lladrovci dhe Xheva Krasniqi-Lladrovci, dashurinë e tyre të madhe për njëri tjetrin, luftuan së bashku dhe vdiqën së bashku. Kjo vepër është një roman i vërtetë dhe mund të shërbejë pa dyshim si zanafilllë e një filmi artistik.

Zoti Dilaver Goxhaj, Zv/shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK në fjalën e tij mbi Monografinë ''Përjetësia e Dyfishtë'', e cilësoi si veprën më të mirë të derisotme, pa hezitim me këtë gjini, z.Bedri Islami renditet ndër shkrimtarët më profesionistë europianë të monografive. Përmes monografive të tij, z.Bedri Islami me sa duket i ka vënë vetes qëllim të paraqesë rolin historik të disa figurave të shquara të asaj lufte dhe rolin udhëheqës të LPK-së në luftën për çlirimin e Kosovës.

Monografia për Fehmi Lladrovcin dhe Xheva Krasniqi-Lladrovci, ''Përjetësia e Dyfishtë", nuk është thjeshtë një monografi, por një vepër letrare me temë jo vetëm politike por edhe historike.

Takimin e përmbylli autori i veprës, z. Bedri Islami, i cili ka qenë edhe Kryetar i LPK. Ndër të tjera autori theksoi që dy heronjtë e Kosovës janë nderuar në Shqipëri me

titullin “Nderi i Kombit”. Luftës së Kosovës iu bashkuan 7000 të rinj dhe të reja që banonin në vendet e Europës për të dhënë kontributin e tyre për Pavarësinë e Kosovës.

Z.Islami iu referua edhe shkrimtarëve dhe artistëve shqiptarë, të cilët me veprat e tyre frymëzuan luftëtarët e UÇK si Mirush Kabashi, Xhevahir Spahiu, Bujar Asqeriu, Reshat Arbana, etj. Në Kosovë Lëvizja për çlirimin e Kosovës nuk erdhi nga lart si shiu por nga poshtë si burim i pastër. Një rol të rëndësishëm në këtë luftë kanë luajtur dhe luftëtarët nga Shqipëria.

Letërkëmbimi mes dy bashkëshortëve Lladrovci është monumental dhe unë kam pasur fatin më të madh-përfundoi z.Islami-që i kam njohur këta heronj-legjendë dhe më kanë bërë mik shtëpia. Takimi u ndoq me shumë interes dhe me emocion. Në fund të aktivitetit Grupi “Çipini” këndoi një këngë shumë të ndjerë e me shumë poezi brenda, kushtuar dy heronjve legjendarë të Kosovës, Fehmi Lladrovci dhe Xheva Krasniqi-Lladrovci.

KLSH zhvillon një takim me studiuesin Uran Butka dhe shkrimtarin e studiuesin Agron Tufa për veprën e Mid'hat Frashërit

Në datën 26 nëntor në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në sallën “Lech Kaczynski”, u zhvillua një takim me studiuesin Uran Butka dhe shkrimtarin e studiuesin Agron Tufa për veprën e Mid'hat Frashërit. Ky takim u zhvillua në kuadër të aktiviteteve të muajit të hapur. Në këtë aktivitet morën pjesë Kryetari i KLSH, auditues të Kontrolli të Lartë të Shtetit dhe gazetarë nga fusha e kulturës.

Aktivitetin e hapi Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, i cili nënvizoi faktin që ishte një nder i veçantë për institucionin organizimi i këtij aktiviteti që i kushtohet veprës së Mid’had Frashërit. Z.Leskaj përmendi se vepra e zgjedhur e Mid’hat Frashërit është një kulturë e jashtëzakonshme, që i kthehet kombit shqiptar, dhe bashkë me të edhe vetë Mid’hat Frashërit. Duhet thënë se, ndonëse pinjoll i derës së madhe kombëtare të Frashërllinjve, Mid’hat Frashëri, për dekada, për shkak të bindjeve dhe veprimtarisë së tij politike, që shkonin ndesh me ato komuniste, qe përjashtuar tërësisht nga jeta jonë shoqërore e kulturore.

Zoti Leskaj iu referua dekalogut moral të Mid'hat Frashërit dhe përmendi 10 postulatet e tij. Në fjalën e tij Historiani dhe studiuesi Uran Butka, iu referua veprës së tij "Gjeniu i Kombit" kushtuar Mid'hat Frashërit. Zoti Butka evidentoi faktin se kjo vepër është kryesisht kulturore dhe ka tre volume, në veprën e pare përfshihet publicistika e tij, në të dytin studimet historike, kulturore, politike sociale etj., në vëllimin e tretë janë krijimtaria dhe kujtimet e tij, që janë një pasuri shumë e madhe për historinë e kombit, mandej letërkëmbimi që është ndër më të jashtëzakonshmit në historinë e literaturës shqipe, përshkrimet e udhëtimeve në të gjithë botën, ditarët etj. Z.Butka shpjegoi se këto *"...janë dokumente të cilat ndodhen në Arkivin e Shtetit dhe në arkivat e tjera të Londrës, të Gjenevës, të Romës e të Stambollit. Në libër lexuesit do të gjejnë për herë të parë procesverbalin e Kongresit të Manastirit".*

Z.Butka përfundoi këtë vështrim të shkurtër me disa fjalë të Mid'hat Frashërit, të cilat i kishte thënë në shkrimin homazh për bashkëpunëtorin e tij Kristo Luarasin: "Një varr nuk mbulon kurdoherë një njeri të vdekur. Shumë herë jeta e vërtetë, rrojtja shpirtërore fillon kur mbaron fryma. Ç'ka të bëjë zhdukja e trupit, në qoftë se ideja rron, kur ajo ide ngjall një mijë shpresa dhe entuziazëm? Dhe bash këto janë jetë e vërtetë". Gati 70 vjet pasi dha frymën e fundit, Mid'hat Frashëri, me idetë e tij, me trashëgiminë shkrimore, vjen në një format të ri, të plotë dhe funksional si një dëshmi e rrojtjes së tij shpirtërore dhe si një vlerë kombëtare.

Më pas e mori fjalën z.Agron Tufa, i cili theksoi që edhe pse trashëgimia memuaristike e Mid'hat Frashërit nuk paraqet një shkrim sistematik, të rregullt, sipas një vijueshmërie të pandërprerë, ajo, gjithsesi, na njeh me disa segmente të rëndësishme të ngjarjeve historike e politike të Shqipërisë në agun e saj shtetformues, sikundërse na sjell nga afër portrete personalitetesh politike e kulturore të çerek shekullit të parë të shekullit XX. Gjithashtu lloji i shkrimit memuaristik të Mid'hat Frashërit rivalizon dorë për dorë me letërsinë artistike, pa ia zbehur aspak forcën dhe rëndësinë e dëshmisë autentike. Zoti Tufa theksoi prozat memuaristike të Mid'hat Frashërit, të shkruara në vite të ndryshme, të cilat krijojnë kuadre të veçanta historike e nganjëherë psikologjike, zbulime, meditime, etj.

Në fund të këtij aktiviteti studiuesit Uran Butka dhe Agron Tufa përshëndetën kryetarin e KLSH për këtë organizim dhe audituesit e KLSH për kohën që i kushtojnë librit dhe historisë shqiptare. Zoti Butka falënderoi z.Leskaj për mbështetjen që ka dhënë në kohën që ka qenë Ministër i Kulturës për botimin luksoz të veprës së Mid'hat Frashërit.

KLSH merr pjesë në workshop-in e zhvilluar në Ankara për auditimin financiar

Nga data 26 deri në datën 30 nëntor 2018, në Ankara të Turqisë, në zyrat e Gjykatës Turke të Llogarive, audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit morën pjesë në Workshop-in mbivlerësimin e gjetjeve dhe raportimin e Auditimit Financiar në Sektorin Publik. Ekipi përfaqësues i Kontrollit të Lartë të Shtetit përbëhej nga z. Enea Caushaj, z. Jovan Plaku, Auditues në Departamentin e Auditimit të Vetqeverisjes Vendore dhe z. Agim Mandri, Auditues në Departamentin e Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit. Në këtë aktivitet morën pjesë Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, Gjykata Turke e Llogarive, Zyra e Auditimit të Institucioneve të Bosnje-Hercegovinës, Zyra Kombëtare eAuditimit të Maqedonisë, Institucioni Shtetëror i Auditimit të Malit të Zi dhe Institucioni Shtetëror i Auditimit të Serbisë.

Qëllimi i këtij Workshop-i, mbështetur edhe nëmoton e INTOSAI-t "Experientia mutua omnibus prodest (Nga eksperienca e përbashkët përfitojnë të gjithë)", ishte shkëmbimi i ekperiencës dhe praktikave më të mira për sa i përket formulimit dhe vlerësimit të gjetjeve dhe raportimit të auditimit financiar në sektorin publik. Kjo qasje bëri të mundur nxjerrjen në pah të pikavetë forta dhe pikave ku shihet mundësia për përmirësime në aspektin strukturues dhe raportues të auditimit financiar. Rastet studimore të trajtuara dhe më pas të diskutuara në mënyrë konstruktive bashkarisht nga secili prej gjashtë ekipeve përfaqësuese të SAI-ve të sipërpërmendur, vunë në dukje metodologjitë dhe qasjet që ekzistojnë në një projekt auditimi, duke u nisur që nga planifikimi i auditimit, përcaktimi i riskut e materialitetit dhe deri në klasifikimin e gjetjeve dhe formulimi i raportit përfundimtar duke dhënë dhe rekoman-dimet e nevojshme.

Nga ana e përfaqësuesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit u prezantua nga z. Enea Caushaj, auditues i Departamentit të Auditimit të Vetqeverisjes Vendore, një pamje e përgjithshme rreth kuadrit ligjor raportues në Republikën e Shqipërisë, strategjisë së menaxhimit të financave publike dhe roli monitorues i KLSH-së, si anëtar kyç i Komitetit Drejtues për Menaxhimin e Financave Publike, për sa i përket progresit të masave të përcaktuara në këtë Strategji.

Finalizimi i Workshop-it u arrit me disa konkluzione rreth metodave, qasjeve, strukturimeve dhe fomulimeve në raportimin e auditimit financiar, duke përfituar nga eksperienca e përbashkët mes Institucioneve Supreme të Auditimit pjesëmarrëse.

Kryekontrollori i SHBA-ve takon Kryetarin e KLSH

Në 6 dhjetor 2018, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj takoi në Washington D.C. në zyrën e tij Kontrollorin e Përgjithshëm të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Gene L. Dodaro, personaliteti më i rëndësishëm i auditimit suprem publik në botë. Z. Leskaj vlerësoi riaktivizimin e bashkëpunimit mes të dyja institucioneve të auditimit të lartë që nga viti 2012 dhe e informoi Kryekontrollorin amerikan për 10 risitë kryesore të zhvillimit të KLSH gjatë viteve 2012-2018, të tilla si ligji i ri integral i institucionit i vitit 2014, në përputhje me standardet e INTOSAI-t, përqëndrimi tek auditimi i performancës, 300 kallzime penale në 7 vjet, ose një kallzim në javë, ose dy herë më shumë se periudha 2004-2011, investimi tek auditimet e teknologjisë së informacionit, konferencat shkencore të KLSH, muaji i hapur me qytetarët, kolana "Botimet e KLSH-së", shkrimet e audituesve të institucionit në shtypin e përditshëm, etj.

Zoti Leskaj theksoi se standardet e auditimit të Zyrës së Llogaridhënies Qeveritare(GAO), institucionit suprem të auditimit të SHBA-ve, si reflektimi më i saktë i standardeve ndërkombëtare ISSAI, institucioni i KLSH i kishte gjithnjë parasysh. Për këtë, Kryetari Leskaj i tregoi Kryekontrollorit amerikan Dodaro edhe përkthimet në shqip të përmbledhjes së standardeve amerikane, të quajtur "Yellow Book(Libri i Verdhë)", të botuar si libër nga KLSH në vitin 2016, si dhe botimin e fundit të vitit 2018, përkthimin e përmbledhjes "Green Book(Libri Jeshil)" të GAO-s për standardet e auditimit të brendshëm në qeverinë federale amerikane.

Kryetari i KLSH e informoi kolegun amerikan edhe për zbatimin nga KLSH të përvojës amerikane në fushën e integritetit, nëpërmjet Kodit të Kryetarit të KLSH, ku përfshihet vendimi i titullarit për mos-rikandidim, si dhe projektin, i cili do të zbatohet në muajt e parë të vitit 2019, për botimin e protokolleve të GAO-s në raportet e saj me Kongresin Amerikan, si dhe të përvojës amerikane në ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të institucionit të auditimit suprem publik.

Z. Leskaj u shpreh se kjo vizitë e tij ndërkombëtare, edhe pse e fundit në detyrë, ishte domethënëse, përsa i përket të ardhmes së zhvillimit profesional të audituesve të KLSH dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar të institucionit.

Në fjalën e tij, z. Dodaro vlerësoi punën impresionuese të Kryetarit të KLSH në reformimin e institucionit dhe në drejtim të zbatimit të standardeve ISSAI, si dhe falenderoi për botimin në shqip të standardeve të GAO-s, të përfshira në përmbledhjet "Yellow Book" dhe "Green Book".

Kryekontrollori i SHBA-ve theksoi punën e mirë të KLSH në drejtim të fitimit të dijeve në auditim, nëpërmjet botimeve të standardeve të fushës dhe shkëmbimit të eksperiencës me institucionet supreme të auditimit partnere.

Në takim ishte i pranishëm edhe Drejtori i Planifikimit Strategjik në GAO, z. Blockwood, i cili, nga ana e tij cilësoi të suksesshëm bashkëpunimin e KLSH me Qendrën e Ekselencës në Auditim të GAO-s, të konkretizuar me ardhjen në Tiranë të Drejtoreshës së Qendrës, zj. Janet St. Laurent dhe dhënien nga ana e saj të një leksioni për audituesit shqiptarë, si dhe të programeve disamujore të trajnimit "Fellowship" të 5 audituesve shqiptarë në zyrat e GAO-s.

Z. Blockwood u shpreh se vizita të tilla të ekspertëve amerikanë për të ngritur kapacitetet e audituesve shqiptarë do të vijojnë edhe në të ardhmen. Ai cilësoi se numri i rradhës i Revistës së INTOSAI-t "INTOSAI Journal", që botohet nga GAO, do të ketë një hapësirë të veçantë kushtuar risive të KLSH në veprimtarinë audituese.

Nga ana e tij, Kryekontrollori Dodaro i uroi z. Leskaj suksese në detyrat e tij të ardhshme dhe e inkurajoi për projektin e tij individual me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Polonisë(NIK) për shkëmbimin e eksperiencës në auditim, si dhe u shpreh i sigurtë se bazat e shëndosha të bashkëpunimit, të ngritura mes GAO-s dhe KLSH-së do të vijojnë të japin frutet e tyre edhe në të ardhmen.

Që nga viti 2015, ky është takimi i tretë zyrtar i dy drejtuesve të auditimit suprem publik të Shqipërisë dhe SHBA-ve në zyrën e drejtuesit të GAO-s në Washington, pas disa takimeve në Kongreset INCOSAI dhe në simpoziumet kryesore të INTOSAI-t.

Përfaqësues të SIGMA takohen me Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Në datën 12 dhjetor 2018, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj priti në zyrën e tij, dy përfaqësues të SIGMA, zoti Joop Vrolijk, ekspert dhe z. Alastair Swarbrick, Këshilltar i Lartë i SIGMA, të cilët vizituan KLSH-në me rastin e përfundimit të mandatit 7-vjeçar të Kryetarit të KLSH-së.

Kryetari i KLSH-së u shpreh shumë i kënaqur dhe falënderoi përfaqësuesit e SIGMA për bashkëpunimin e suksesshëm dhe për mbështetjen që i kanë dhënë KLSH, gjatë këtyre shtatë viteve. KLSH duhet të vijojë bashkëpunimin në të ardhmen me SIGMA, si një nga institucionet më të mira dhe që ka dhënë produkte konkrete për KLSH-në.

Bashkëpunimi i SIGMA ka qenë shumë i hapur me KLSH dhe ekspertët e SIGMA e kanë dhënë mbështetjen e tyre me shumë gjenerozitet dhe dashamirësi, veçanërisht z.Joop Vrolijk.

Unë jam shumë mirënjohës-vijoi z.Leskaj-se SIGMA dhe z.Vrolijk personalisht, së bashku me DG Budget në Bruksel, i kanë dhënë institucionit një ndihmë të jashtëzakonshme për miratimin e Ligjit të Ri të KLSH-se, i cili falë kësaj mbështetje u miratua nga Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje të plotë me Standartet e INTOSAI-t.

Zoti Leskaj përmendi gjithashtu aktivitetet që janë organizuar në bashkëpunim me SIGMA, duke veçuar workshopin që u zhvillua në qershor të vitit 2018, lidhur me marrëdhëniet mes KLSH-së dhe Parlamentit, veçanërisht në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së. Në vijim edhe të konkluzioneve të këtij aktiviteti, KLSH ka propozuar nënshkrimin e një Memorandumi mirëkuptimi mes KLSH-së dhe Kuvendit të Shqipërisë dhe ky i fundit ka ngritur një mekanizëm për kontrollin e Institucioneve të pavarura. Si konkluzion mund të konstatojmë me kënaqësi-përfundoi z.Leskaj- që si rezultat i përpjekjeve të përbashkëta, kemi aktualisht një marrëdhënie më të mirë dhe më të konsoliduar me Kuvendin e Shqipërisë.

Më pas e mori fjalën z. Alastair Swarbrick, i cili falënderoi z.Leskaj për hapjen e institucionit dhe vlerësoi kontributin personal të z.Leskaj për arritjen e këtij bashkëpunimi produktiv. SIGMA do të vijojë të bashkëpunojë me KLSH-në në dy fusha kryesore :

- Në implementimin e buxhetit të shtetit;
- Planifikimin e auditimeve individuale, në bazë risku.

Kryetari i KLSH-së e konfirmoi bashkëpunimin në këto dy fusha kyçe me shume interes dhe theksoi se sipas sugjerimeve të SIGMA, KLSH po rrit numrin e auditimeve financiare.

Në fund e mori fjalën, z.Joop Vrolijk, i cili ka punuar për më shumë se 10 vjet me KLSH-në dhe vlerësoi shumë ndryshimin që ka sjellë z.Leskaj në institucion, i cili e hapi institucionin dhe e modernizoi atë, duke e sjellë punën audituese në përputhje me standartet e INTOSAI-t. Zoti Vrolijk vlerësoi shumë edhe rritjen e kapaciteteve audituese në KLSH.

Në fund të takimit z. Swarbrick dhe z.Vrolijk i uruan Zotit Leskaj suksese në karrierën e tij profesionale dhe në jetën private.

Në datën 13 dhjetor, z. Alastair Swarbrick me ftesë të Kryetarit të KLSH-së, bëri një prezantim për audituesit e KLSH-së, në sallën “Lech Kaczynski”.

Zoti Swarbrick e filloi prezantimin e tij me një hyrje të shkurtër rreth historikut të SIGMA dhe misionit dhe partnerët e tij.

SIGMA është një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Evropian. Objektivi kryesor i saj është të forcojë themelet për përmirësimin e qeverisjes publike dhe kështu të mbështesë zhvillimin socio-ekonomik nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të sektorit publik, përmirësimit të qeverisjes horizontale dhe përmirësimit të hartimit dhe zbatimit të reformave të administratës publike, duke përfshirë prioritizimin, renditjen dhe buxhetimin e duhur. SIGMA bashkëpunon me partnerët për forcimin e sistemeve të qeverisjes publike dhe kapaciteteve të administratës publike për 25 vjet.

Misioni i SIGMA është të punojë me vendet që negociojnë për t'u bashkuar me Bashkimin Evropian (BE) për të promovuar dhe forcuar sistemet e qeverisjes publike dhe kapacitetet e njerëzve që punojnë në këto qeveri. Ata i ndihmojnë vendet në tranzicion të përmbushin aspiratat e tyre për një ekonomi të tregut të lirë, një demokraci të qëndrueshme dhe sundim të ligjit dhe t'i ndihmojnë ata të demonstrojnë gatishmërinë e tyre për t'u bashkuar me BE ose për të krijuar një marrëdhënie më të afërt me BE-në, nëpërmjet lëvizjes së lirë dhe tregtisë. SIGMA financohet nga Bashkimi Evropian dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.

Në fund të prezantimit, audituesit e pranishëm i adresuan pyetje z. Swarbrick.

KLSH dhe IDM organizojnë Konferencën Kombëtare "Për një autoritet Kombëtar Anti korrupsion të gjithëpranuar dhe mirëvendosur në sistemin e qeverisjes"

Në datën 14 dhjetor 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) organizuan në ambientet e Kontrollit të Lartë të shtetit Konferencën Kombëtare me temë: *"Për një autoritet Kombëtar anti-korrupsion të gjithëpranuar dhe mirëvendosur në sistemin e qeverisjes".*

Ideja për organizimin e këtij aktiviteti të përbashkët u mbështet nga produktet e punës së tyre si: raporti i Auditimit të performacës mbi *"Strategjinë Antikorruspion"nga KLSH* dhe studimi i IDM-së *"Ulja e Ndikimit të Politikës mbi Agjencitë Anti-korrupsion "*.

Fjalën përshëndetëse në fillim të aktivitetit e mbajti në emër të Kryetarit të KLSH-së, z.Bujar Leskaj, Drejtori i Përgjithshëm i KLSH-së, zj.Lindita Milo (Lati), e cila theksoi "... Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, politik dhe social është synimi kryesor i çdo vendi, për më tepër kjo bëhet dhe më e rëndësishme në shtetet me demokraci të brishtë dhe me institucione në zhvillim. Krahas të tjerave, korrupsioni është një nga pengesat kryesore për arritjen e këtij

synimi. “Korrupsioni shkatërron vendet e punës dhe pengon zhvillimin, i kushton ekonomisë së botës miliarda dollarë çdo vit. I ngujon të varfrit në varfëri, përderisa qeveritë e korruptuara anembanë botës vjedhin buxhetin e shtetit dhe parandalojnë që njerëzit e devotshëm që punojnë me djersë dhe me ndershmëri të fitojnë nga frytet e punës së tyre. Korrupsioni vjedh investimet që duhej të shkonin në shkolla dhe spitale për aq kohë sa të korruptuarit u shmangen taksave që duhen paguar.”

Duke iu referuar raportit përfundimtar të auditimit të performancës mbi “Strategjinë anti-korrupsion të qeverisë shqiptare”, zonja Milo konkludoi që kjo strategji është e dështuar në masën më të madhe (objektivi A.11 si dhe përgjithësisht Strategjia Anti-korrupsion dhe Plani i Veprimit për ta vënë në jetë atë), dhe për të siguruar implementimin e një nisme kaq jetike për vendin e për të eliminuar në vijimësi riskun e transferimit të KKK nga njëri institucion në tjetrin, KLSH rekomandon krijimin e një Agjencie Kombëtare Antikorrupsion. Kjo agjenci sugjerohet të jetë nën varësinë e Kryeministrit dhe përgjegjëse për rihartimin, rizbatimin dhe monitorimin e mëtejshëm të SNKK dhe PV, duke marrë fillimisht dakordësinë e Kuvendit për dokumentet strategjikë në formën e një Ligji të posaçëm.

Më pas e mori fjalën, z.Sotiraq Hroni, Drejtor Ekzekutiv i IDM. Zoti Hroni, falënderoi fillimisht z.Leskaj për hapjen e KLSH-së dhe veçanërisht bashkëpunimin me shoqërinë civile, fryt i të cilit ishte edhe aktiviteti i sotëm. Bashkëpunimi KLSH-IDM është një nga shembujt më të mirë të bashkëpunimit mes OSHC dhe institucioneve shtetërore. Zoti Hroni duke folur për strategjinë anti-korrupsion dhe për Zyrën Kombëtare të antikorrupsionit që është pjesë e Ministrisë së Drejtësisë theksoi që këtu ka konflikt të hapur interesi sepse qeveria nuk mund të kontrolloje vetveten. Kjo zyrë duhet të jetë e pavarur në kuptimin e vërtetë të fjalës si të gjitha institucionet e tjera të pavarura ,sepse vetëm pavarësia siguron cilësi.

Zoti Rinald Muça, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Peformancës prezantoi rezultatet e auditimit të performancës mbi “Strategjinë anti-korrupsion të qeverisë shqiptare”. Zoti Muça paraqiti objektivat e auditimit, kontekstin në të cilin u zhvillua auditimi, periudhën e auditimit, subjektet e audituara dhe veçanërisht mesazhet e auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet. Një nga rekomandimet kryesore të KLSH-së ishte krijimi i Agjencisë Kombëtare kundër korrupsionit, me qëllim që të sigurohet implementimi i strategjisë me eficiencë dhe efektivitet.

Zoti Mario Mariani, përfaqësues i Delegacionit të BE-së në Tiranë, në fillim të fjalës së tij evidentoi faktin e njohur që 80% e shqiptarëve konfirmojnë që ndeshin

elementë të korrupsionit në jetën e tyre të përditshme. Delegacioni i BE-së në Tiranë dhe Komisioni Europian i kanë kushtuar rëndësi të veçantë këtij fenomeni dhe reforma në drejtësi do të ndihmojë në mënyrë të dukshme në luftën kundër korrupsionit. Miratimi së fundmi nga Kuvendi i Shqipërisë i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Emërimeve në drejtësi tregon që reforma po konsolidohet. Zoti Mariani, theksoi gjithashtu- se implementimi i strategjisë antikorrupsion po monitorohet nga institucionet e BE-së.

Në Konferencë e morën fjalën edhe z.Boris Divjak, anëtar i Bordit të Drejtorëve të Transparency International; znj.Rovena Sulstarova, IDM, e cila u fokusua në krijimin e një Autoriteti antikorrupsion legjitim dhe të gjithëpranuar; deputeti i Kuvendit të Shqipërisë, z.Genc Pollo, Kryetar i Komisionit të Integrimit Europian, "Sfidat e sistemit aktual dhe implikimet e alternativave të reja"; z.Flori Karaj nga Inspektorati i Lartë i Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të interesit.

Në përfundim pati pyetje dhe debate nga të pranishmit, veçanërisht mbi statusin e Agjencisë Antikorrupsion.

Në takim morën pjesë përveç personaliteteve që drejtuan panelin, përfaqësues të KLSH-së, IDM, Ministrisë së Drejtësisë, PNUD, USAID, përfaqësues të medias, etj.

Përfaqësuesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit marrin pjesë në takimin shpjegues të organizuar nga Komisioni Evropian për Kapitullin 32, "Kontrolli Financiar"

Proceset e integrimit në Bashkimin Evropian kanë mbritur në momentin e listimit e të shpjegimit të të gjithë kuadrit ligjor dhe rregullativ të BE-së, të cilat duhet të jenë pjesë funksionale e sistemeve dhe institucioneve të Shqipërisë.

Në këtë kontekst në datën 5 Dhjetor 2018, në Bruksel, u organizua nga Komisioni Evropian, DG NEAR takimi shpjegues në lidhje me Kapitullin 32, i cili konsiston në:

-Kontrollin financiar të brendshëm publik, në gjithë komponentët e tij, me fokus në kuadrin ligjor dhe standardet e pranuara në nivel ndërkombëtar, i cili përbëhet nga COSO-Kontrolli i brendshëm dhe kuadri i integruar; Udhëzimi i INTOSAI-t për Qeverisjen e mirë; dhe Auditi i Brendshëm.

- Auditimi i Jashtëm Publik, me fokus në pavarësinë institucionale, funksionale dhe financiare të Kontrollit të Lartë të Shtetit, cilësia dhe impakti i aktivitetit auditues në zbatim të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t.
- Mbrojtja e financave të Bashkimit Evropian, me fokus në eficiencën e funksionimit të Inspektimit Financiar në Shqipëri.

-Mbrojtja e Euros nga spekulimi/falsifikimi (vepër jo penale), me fokus veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë në këtë aspekt.

Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua në këtë tryezë nga Drejtor i Përgjithshëm, znj. Lindita Milo dhe Kryeauditues znj. Valbona Gaxha. Prezantimi i aspekteve kryesore të standardeve që duhet të jenë pjesë e

realitetit Shqiptar si dhe në zbatim nga KLSH, si auditues i jashtëm publik, u referuan nga Z. Raymond Hill, përfaqësues i Komisionit Evropian, DG Budget.

Z.Hill, nënvizoi se kohët e fundit kishte bërë një takim në Zyrat e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe kishte konstatuar "zhvillime sinjifikative", ndryshime thellësisht cilësore dhe në zbatim të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t. Qartësisht u shpreh mbi pritshmëritë e Komisionit Evropian nga Shqipëria në lidhje me auditimin e jashtëm publik, të cilat lidhen me: Kuadrin kushtetues dhe ligjor: i cili duhet të garantojë plotësisht pavarësinë reale funksionale, organizative dhe financiare të KLSH-së; zhvillimet institucionale në linjë me planin e Zhvillimit Strategjik; Punën audituese në përmbushje të standardeve të INTOSAI-t; dhe kapacitete të mjaftueshme administrative.

Në fjalën e përfaqësuesve të KLSH, u vlerësua detajimi i aspekteve kyçe të funksionimit të KLSH-së, të cilat lidhen me trinomin Pavarësi, cilësi pune dhe impakt real për një qeverisje më të mirë dhe me eficiencë të parasë publike. Në analizë të pritshmërisë, u informuan Përfaqësuesit e Komisionit Evropian se KLSH, bazuar në vlerësimin e pavarësisë funksionale dhe financiare nga procesi i Peer review nga homologët austriakë ka adresuar në Parlamentin Shqiptar disa amendime të ligjit bazë të KLSH-së.

Gjithashtu u theksua se aktiviteti vjetor i KLSH-së bazohet në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022, i cili është hartuar në të njëjtën linjë me zhvillimet strategjike të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t. Për më tepër kjo strategji dhe Plani i Veprimit është vlerësuar dhe ka marrë komente nga SIGMA. Fundi i vitit 2018 do të mundësojë krahasimin e treguesve të vitit të parë të zbatimit të kësaj strategjia në mënyrë konkrete për objektivat e përcaktuara, ku u cilësua rritja e numrit të auditimeve financiare në zbatim të standardeve apo rritja e numrit të Auditimeve të Perfomancës, etj.

Në adresimin e përmirësimit të cilësisë së punës audituese, pavarësisht se KLSH ka ndërtuar sistemin e kontrollit dhe të sigurimit të cilësisë, ka në vëmendje faktin se përmirësimi real i cilësisë së punës është i lidhur ngushtësisht me cilësinë në çdo moment të çdo audituesi të veçantë. Ky proces nuk mund të realizohet në mënyrë të menjëhershme pasi auditimi është një praktike pune e lidhur ngushtësisht me mentalitetin e punës ndër vite. Prandaj, përmirësimi i cilësisë në zbatim të plotë të standardeve të nivelit të 4-t kërkon jo vetëm trajnime intensive por edhe ballafaqime serioze dhe konkrete nga njësite publike të audituara me synimin e kuptimit dhe identifikimit të problematikave për një mirë qeverisje si në nivelin qendror ashtu edhe vendor. KLSH e konsideron cilësinë e punës audituese të

lidhur edhe me nivelin e impaktit të gjetjeve dhe rekomandimeve adresuara njësive publike për të rritur përgjegjshmërinë dhe eficiencën e përdorimit të fondeve buxhetore.

Në lidhje me dy aspektet e mësipërme në përgjigje të pyetjes së bërë nga KLSH për instrumentet dhe praktikat më të mira që do të mund të rekomandoheshin për të përmirësuar impaktin e punës audituese të saj, Z. Hill theksoi domosdoshmërinë e bashkëpunimit të ngushtë me Njësinë e Harmonizimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, e cila duhet të luajë rolin e udhëheqjes metodike të gjithë njësive publike për realizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik dhe auditimin e brendshëm, pasi eficienca e gjithë sistemit varet nga cilësia e funksionimit të kësaj njësie dhe bashkëpunimit me KLSH-në për të qenë në të njëjtin front për të ndaluar abuzimin dhe keqmenaxhimin e parasë publike

Vizitë Studimore e KLSH-së në SAI-n e Malit të Zi

Në datat 17 dhe 18 dhjetor 2018, një delegacion i Kontrollit të Lartë të Shtetit zhvilloi një vizitë studimore pranë Institucionit Shtetëror të Auditimit të Malit të Zi (DRI). Delegacioni në fjalë, kishte në përbërje të tij, si auditues të vjetër dhe me eksperiencë në fushën e auditimit, po ashtu edhe auditues të rinj, të cilët sapo kanë nisur rrugën e gjatë të perfeksionimit të ketij profesioni, por me një të ardhme premtuese në këtë fushë.

Takimi u çel në datën 17 dhjetor 2018, në sallën e konferencave të Hotelit "Ramada", nga z. Zoran Jeliç, Anëtar i Senatit të DRI. Pas fjalës përshëndetëse të Z. Jeliç, fjalën e mori znj. Marija Zugiç, Drejtore e Departamentit të Marrëdhënieve me Jashtë, e cila si një audituese me shumë përvojë në këtë fushë, bëri prezantimin me temë "Bashkëpunimi mes DRI-së dhe Parlamentit të Malit të Zi". Ky prezantim ishte me shumë interes për audituesit e KLSH-së dhe ndezi një seancë diskutimesh, përpara se të vinte rradha e z. Drashko Novakoviç, për të prezantuar punimin e tij me temë "Zbatimi i rekomandimeve të përfshira në raportin e auditimit". Në fund të fjalës së z. Novakoviç, audituesit shqiptarë dhe homologët e tyre malazezë zhvilluan një diskutim mbi përpilimin e raporteve përfundimtare të auditimit, duke bërë edhe një përmbledhje të të përbashkëtave dhe të dallimeve që ka ky proces në të dy vendet.

Më pas ishte rradha e prezantimit të përgatitur nga përfaqësuesit e KLSH-së. Për audituesit shqiptarë, referoi z. Jonild Hoxha, Auditues i Lartë në KLSH, lidhur me temën "Metodologjia e Auditimit të Investimeve në KLSH". E veçanta e prezantimit të Z. Hoxha, ishte se në fund të projektit të tij ai kishte përfshirë disa prova fotografike, të marra gjatë auditimeve në të cilat ai kishte qenë pjesë e grupeve të punës. Për këto të fundit, audituesit

malazez shprehën shumë interes, madje u ndalën me diskutime të gjata për secilën nga fotot, duke u përpjekur të kuptonin sa më shumë mbi gjetjet e bëra. Në këto kushte, në një situatë shumë pozitive u mbyll dita e parë e aktivitetit. Për të përshëndetur audituesit shqiptarë, nderoi me praninë e tij z. Milan Daboviç, President i Senatit të DRI-së dhe z. Nikola Kovaçeviç, Anëtar i Senatit të DRI-së. Audituesit e KLSH-së patën mundësinë që të diskutonin me Presidentin Daboviç mbi mënyrën e organizimit të DRI-së.

Të nesërmen, në datën 18 dhjetor 2018, aktiviteti nisi nën drejtimin e Anëtarit të Senatit të DRI-së, z. Nikola Kovaçeviç. Zoti Veselin Miloviç, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Shtetit në DRI prezantoi temën "Raporti i Auditimit sipas llojit të auditimit". Pas tij ishte rradha e znj. Violeta Kovaçeviç, Drejtuese e Departamentit të Auditimit të Partive Politike që prezantoi temën "Auditimi i raporteve financiare vjetore të entiteteve politike".
Në këtë vizitë studimore morën pjesë: znj. Nerënxa Llapashtica, z. Genci Kokaj, z. Jonild Hoxha, z. Aleksandër Papadhimitri, znj. Armanda Begaj, z. Dorino Meçe dhe z. Reinis Xhelili.

Takim i Kryetari të KLSH-së, z.Bujar Leskaj me stafin e institucionit në përfundim të mandatit të tij

Në datën 8 janar 2019, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj në përfundim të mandatit të tij shtatë vjeçar në krye të institucionit organizoi në sallën Lech Kaczynski të Kontrollit të Lartë të Shtetit një takim me stafin e KLSH-së.

Zoti Leskaj falënderoi fillimisht drejtuesit dhe audituesit e KLSH-së për punën e përbashkët të realizuar në këto shtatë vjet, duke nënvizuar se *" ne kemi pasur si busull orientuese mandatin tonë kushtetues të sanksionuar në Nenet 161-165 të Kushtetutës së Shqipërisë, por edhe standardet tona ndërkombëtare të auditimit ISSAI, të cilat të japin siguri të mos gabosh kurrë në elementet thelbësore të pavarësisë dhe cilësisë së punës sonë audituese".*

Zoti Leskaj bëri një bilanc të punës 7 vjeçare të institucionit, duku iu referuar platformës strategjike për zhvillimin e KLSH-së që paraqiti përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë në 14 Dhjetor 2011, në cilësinë e kandidatit të nominuar nga Presidenti i Republikës për pozicionin e Kryetarit të KLSH-së dhe bëri analizën e tetë objektivave kryesore, si respektimi rigoroz i standardeve ndërkombëtare të auditimit; kthimi i vëmendjes tek auditimi i performancës, krahas rritjes se eficiencës së auditimit financiar; realizimi i sinergjizimit të politikave dhe veprimeve me organet e tjera shtetërore të kontrollit, luftës dhe parandalimit të korrupsionit; intensifikimi i konsultimeve me Komisionin

për Ekonominë dhe Financa për përafrimet strategjike të KLSH 2012-2018; intensifikimi i bashkëpunimit me ekspertët universitarë dhe akademike të auditimit të financave publike, si dhe me organizatat profesionale të fushës; intensifikimi i bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare INTOSAI dhe EUROSAI, me institucionet e larta të auditimit të vendeve të BE-së, të vendeve të rajonit dhe në veçanti me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës si dhe përmirësimi i transparencës në marrëdhëniet me publikun, nëpërmjet një partneriteti të gjerë me median dhe me organizatat jo-fitimprurëse që luftojnë korrupsionin.

Konstatohet me kënaqësi që të gjitha këto objektiva janë realizuar :

- pas shtatë vitesh, institucioni ka një vizion të mirë-përcaktuar se ku dëshiron të arrijë në një vit, tre vjet apo dhe në pesë vitet e ardhshme. Me kapacitetet e tij, ai përgatiti Strategjinë e re të Zhvillimit të KLSH-së 2018-2022, e cila u përgjigjet kërkesave të ISSAI-ve dhe është mbështetur në udhëzuesit metodologjikë të publikuar për këtë qëllim nga organizatat ndërkombëtare profesionale dhe Nisma për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI).
- lufta kundër korrupsionit dhe abuzimit me pronën shtetërore si një qëllim madhor për përmirësimin e qeverisjes publike. Për periudhën janar 2012-tetor 2018, KLSH ka dërguar pranë organit të Prokurorisë 300 kallëzime penale për 953 nëpunës dhe ish-nëpunës të administratës shtetërore. KLSH në 7 vitet e fundit, 2012-2018, ka adresuar çdo javë një Kallëzim Penal, për zyrtarët e nivelit të ulët, të mesëm dhe të lartë, të konstatuar me shkelje të rënda nga auditimet e KLSH, apo e shprehur ndryshe 1 kallëzim për çdo 3 auditime.
- Treguesi i realizimi të auditimeve në harkun kohor të viteve 2012-2018 rezulton në 1095 auditime;
- Dëmi i zbuluar për periudhën 2012-2018 arrin vlerën 2,689 miliardë euro.
- Auditimet e performancës janë parë si një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Një filozofi pune që konsideron se auditimi nuk është një qëllim në vetvete, por në radhë të parë një instrument parandalimi, instrument korrigjimi dhe këshillimi për institucionin që auditohet. Gjatë vitit 2017, janë realizuar 15 auditime performance në reformat qeveritare, në aspekte të rëndësishme të financave publike, në sistemin e prokurimit publik, sistemin arsimor, projektet mjedisore, si dhe në shërbimet publike.
- Në funksion të objektivit të institucionit, për të bërë pjesë të praktikave të tij audituese dhe Auditimet e Teknologjisë së Informacionit, gjatë vitit 2015 u krijua Drejtoria e Auditimit të TI-së si pjesë e Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.
- Gjatë viteve 2012-2018 jemi përpjekur të krijojmë sinergji për mirëqeverisjen, duke bashkëpunuar në sistem me

institucionet e tjera shtetërore. Në vitet 2012-2018, KLSH ka nënshkruar 57 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 30 me OJF, 17 me institucione homologe dhe të tjera me institucione shtetërore dhe universitete publike. Bashkë-punimet me Profesoratin e Universi-teteve dhe Organizatat Profesionale të fushës gjatë këtyre viteve, ka maksimizuar kontributin e tyre në Revistën Shkencore të KLSH-së, Konferencat Shkencore, trajnimet, rekrutimin e stafit, pjesëmarrjen e ekspertëve të shoqërisë civile në auditimet e KLSH, rishikimet mes kolegëve për të vlerësuar performancën e KLSH, etj.

– Gjatë periudhës 2012-2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka nënshkruar 17 marrëveshje bashkëpunimi me SAI-t homologe të: Austrisë, Polonisë, Kroacisë, Sllovenisë,Turqisë, Kosovës, Bullgarisë, Çekisë, Malit të Zi, Bosnje Hercegovinës, Maqedonisë, Kuvajtit, Hungarisë, Qipros, Moldavisë, Ukrainës dhe Rumanisë, duke plotësuar hartën rajonale të partneritetit me thuajse të gjitha SAI-et e vendeve të rajonit, ku natyrisht e para është ajo me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Këto marrëveshje partneriteti janë konkretizuar në fusha të tilla si, shkëmbimi i informacionit, trajnime,veprimtari të përbashkëta audituese rajonale, etj.

Duke vlerësuar misionin e tij si agjent i publikut dhe i Kuvendit, për përdorimin me ekonomicitet efektivitet dhe eficiencë të burimeve dhe fondeve publike, KLSH në shtatë vitet e fundit, ka synuar forcimin e besimit të qytetarit dhe publikut në tërësi, nëpërmjet njohjes më nga afër të veprimtarisë së tij, auditimeve dhe rezultateve të tyre, si dhe partneritetet që ka krijuar brenda dhe jashtë vendit për të përmirësuar qeverisjen publike, duke u përpjekur të luftojë në thellësi korrup-sionin.

Mbështetur në moton e Kongresit të IX-të të EUROSAI-t, zhvilluar në Holandë, “Kur është hera e fundit që ke bërë diçka për herë të parë?”, zoti Leskaj evidentoi 10 risitë e KLSH-së në vitet 2012-2018, të cilat më parë as nuk ravijëzoheshin, ndërsa tani janë bërë të prekshme për të gjithë :

- Ligji i Ri i KLSH-së
- Auditimet e Performancës
- Auditimet IT
- Kallëzimet penale
- Botimet e KLSH-së
- Revista Kërkimore-Shkencore “Auditimi Publik”

- Muaji i Hapur
- Konferencat Shkencore Vjetore të KLSH-së
- Bashkëpunimi me OJF-të
- Godina e re e KLSH-së dhe Muzeu i KLSH-së

Kryetari i KLSH-së, z.Leskaj informoi audituesit e KLSH-së për Vendimin e delegimit të kompetencave të Kryetarit tek Zv/Kryetari i KLSH, znj. Lindita Milo, duke filluar nga data 8 janar 2019, pas botimit në Fletoren Zyrtare të RSH me nr.193, të Vendimit të Kryetarit të KLSH me nr. 244, datë 22.12.2018, sipas të cilit delegohet ushtrimi i detyrës dhe përgjegjësive shtetërore të titullarit të institucionit përgjatë fazës kalimtare e tranzitore nga përfundimi i mandatit kushtetues të Kryetarit të KLSH (datë 23 dhjetor 2018) deri në emërimin nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të Kryetarit të ri të KLSH-së, tek Zv/Kryetari i KLSH, znj. Lindita Milo (Lati).

Zoti Leskaj duke i uruar suksese zj.Milo bëri edhe një përmbledhje të CV së saj, e cila ka përfunduar studimet universitare në profilin Financë- kontabilitet, mban titullin shkencor "Profesor" si dhe gradën shkencore "Doktor" në Kontabilitet (1996) nga Universiteti i Tiranës dhe Ph.D. në Ekonomiks (2001) nga "Staffordshire University", Britania e Madhe.

Në vitet 2006-2016, zj.Milo ka qenë Kryetare e Autoritetit Shqiptar të Konkurencës, që nga viti 1990 e në vijim Lektore pranë Departamentit të Kontabilitet, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës. Zonja Milo në vitet 2004-2010 ka qenë anëtare e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, Bashkëpunëtore e jashtme e IEKA që në vitet e para të themelimit të profesionit të auditimit të jashtëm. Autore e disa teksteve, monografive, artikujve dhe punimeve të tjera shkencore në fushën e kontabilitetit, konkurencës, auditimit, etj.

Kryetari i KLSH-së e përmbylli fjalën e tij *...."Ky rrugëtim i yni, shtatë vite pas nisjes, duket tani më i sigurt dhe më i qartë në detyra, objektiva të vëna e plane zbatimi. Kjo qartësi e siguri është në radhë të parë fryt i punës suaj të ndershme e profesionale, për të cilën ju falenderoj!"*

Mbi bazën e treguesve të plotësuar të performancës së një SAI, eksperiencës së fituar, besimit në vlerën e parimeve që mbrojmë dhe misionit qe kryejmë, të sigurtë në ndihmën dhe mbështetjen e Kuvendit, të Institucioneve të tjera publike dhe të shoqërisë civile e qytetarëve, të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t si dhe SAI-ve partnere, duke e parë me besim të plotë punën audituese në të ardhmen".

Zhvillohen analizat e punës së Departamenteve të Auditimit dhe të strukturave mbështetëse në KLSH për vitin 2018

Në datën 24 Janar 2019, në sallën "Gene Dodaro", në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Departamenti Metodologjisë, Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë zhvilloi Analizën e Veprimtarisë për vitin 2018, duke shënuar hapjen e këtij aktiviteti në nivel Institucional.

Departamenti Metodologjisë, Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit në KLSH përcjell dhe siguron koordinimin dhe kombinimin më të mirë të funksioneve për

zhvillimin institucional duke vendosur në një lidhje të ndërsjellë të tre elementëve të ndërtimit të kapaciteteve dhe progresit të qëndrueshëm:

- Standardet dhe Metodologjitë si themeli mbi të cilin ngrihet dhe zhvillohet veprimtaria audituese;
- Trajnimi dhe Edukimi Profesional- si instrument për transmetimin dhe ndarjen e njohurive mbi Standardet dhe Metodologjitë;
- Sigurimi i Cilësisë -si vlerësues dhe monitorues i performancës, zbatimit të Standardeve dhe impaktit të zhvillimit professional.

Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit dhe Drejtoria e Standarteve dhe Sigurimit si struktura funksionale të këtij Departamenti ofrojnë siguri për aplikimin e kërkesave të cilësuara në ISSAI 40 sipas të cilit ..” *SAI duhet të ofrojë një shërbim ekselent dhe cilësor. Si pjesë e menaxhimit të cilësisë..SAI duhet të vendosë politika, procedura të hartuara për t’i dhënë siguri të arsyeshme se ka burime të mjaftueshme me kompetencën, aftësitë dhe angazhimin ndaj parimeve të etikës të nevojshme për:*

I. Kryerjen e punës në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore në fuqi;
II. T’i mundësuar SAI-t të përgatisë raporte që janë të përshtatshme për rrethanat.

Mbi këtë bazë, veprimtaria e Departamentit për vitin 2018 u zhvillua nën këndvështrimin analitik të elementëve të një Analize SWOT, duke vlerësuar arritjet dhe njohur fuqitë tona, duke identifikuar dobësitë e shfaqura gjatë punës, si dhe duke fokusuar vëmendjen në mundësitë që ofron zhvillimi por vlerësuar njëkohësisht dhe kërcënimet e risqet.

Analiza npërmjet PMF do të shërbejë për të kontribuar në përmirësimin e kapaciteteve të KLSH-së, përmes matjes së performancës dhe identifikimit të mundësive për të forcuar dhe monitoruar performancën e SAI-t.

Politika e zhvillimit profesional në KLSH ka vlerësuar nevojën për krijimin e vlerave të qëndrueshme, duke aplikuar një proces sistematik të mësimit profesional dhe etik duke inkurajuar dhe mbështetur një ambient zhvillimi të vazhdueshëm dhe fleksibël, të aftë për t’u përballur me situata të ndryshme,sfidat dhe rreziqet e kohës.

Implementimi i suksesshëm i Programit të Zhvillimit Profesional të Stafit te KLSH për vitin 2018, sipas synimeve të projektuara në kërkesat e Vendimit të Kryetarit të KLSH nr.230, datë 31.12.2017, mundësoi që çdo auditues në KLSH përgjatë kësaj periudhe të arrijë objektivat dhe realizojë indikatorët themelorë që nxisin forcimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimit.

Gjatë vitit 2018, karakteristikë është se janë alternuar në mënyrë të harmonishme të dy opsionet e mundshme, sipas vendit të kryerjes së seancave të konsolidimit të njohurive:

- Seminare dhe trajnime të zhvilluara në institucionin e KLSH-së me lektorë vendas dhe të huaj;

- Seminare dhe trajnime të zhvilluara në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë pranë SAI-ve dhe Gjykatave të Auditimit.

Në fund të vitit 2018, audituesit e KLSH kishin siguruar një mesatare prej 29 ditë trajnimi/ auditues, duke shënjestruar nivelin më të lartë të këtij treguesi përgjatë gjithë zhvillimit të këtij institucioni ndër vite, që nga krijimi i tij. Kualifikimet janë orientuar drejt njohjes së thelluar dhe zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Kuadrit të Praktikave Profesionale Ndërkombëtare të Auditimit Publik, duke i konsideruar si avantazh krahasues në rritjen e cilësisë së angazhimeve vijuese.

Një sfidë e madhe me të cilën përballen të gjitha SAI-et është ofrimi i vazhdueshëm i auditimeve me cilësi të lartë, e cila ndikon në reputacionin dhe besueshmërinë e tyre si dhe aftësinë e tyre për të përmbushur me sukses mandatin.

Detyrë parësore e Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë është kryerja e kontrolleve në të nxehtë të dosjeve të auditimit përpara evadimit të tyre. Kështu është bërë mundur shqyrtimi dhe dhënia e mendimeve për rreth 150 dosje të auditimeve, në disa raste edhe nga dy herë për të verifikuar reflektimin e vërejtjeve dhe sugjerimeve për Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin. Duhet theksuar se në vitin 2018, në aspektin e kuadrit rregullativ u kërkua konsolidimi i plotë i zbatimit të Rregullores së Procedurave të Auditimit, i cili duhet konsideruar si një nga fuqitë (Strengths), me ndikim në përmirësimin e cilësisë së auditimit. Por është konstatuar se zbatimi i plotë i kësaj Rregulloreje ka hasur në disa vështirësi, të cilat janë evidentuar gjatë praktikës së punës sonë dhe në mënyrë më të detajuar do të jepen në raportin për kontrollin e cilësisë në të ftohtë të dosjeve të auditimit të vitit 2018.

Që një sistem i kontrollit të cilësisë të jetë efektiv, ai duhet të jetë pjesë e strategjisë, kulturës, politikave, procedurave të përcaktuara për veprimtarinë audituese. Pikërisht, parimi bazë që përcaktohet në ISSAI 40 - Kontrolli i Cilësisë së SAI-ve është: *"Institucioni duhet të hartojë një proces monitorimi që i jep atij siguri të mjaftueshme që politikat dhe procedurat në lidhje me sistemin e kontrollit të cilësisë janë të duhurat, të rëndësishme dhe operojnë në mënyrë efektive."*

Krahas këtyre, kontrolli dhe sigurimi i cilësisë së auditimit i shërben KLSH për të evidentuar mangësitë dhe marrjen e masave efektive për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë audituese, si një nga sfidat kryesore të aktivitetit në të ardhmen.

Rezultatet e veprimtarisë audituese në një shkallë të konsiderueshme varen nga zbatimi në kohë dhe sipas standardeve të

procedurave të auditimit, të përcaktuara në Rregulloren përkatëse. Nën këndvështrimin të zhvillojmë e përmirësojmë mbi çfarë kemi ndërtuar pozitivisht mbështetur në pikat tona më të forta dhe duke konsideruar mundësitë që ofron e ardhmja, në fund të analizës u përcaktuan edhe objektivat kryesore ku do të mbështetet puna e Departamentit të Metodologjisë, Standarteve dhe Sigurimit të Cilësisë për vitin 2019.

Në datën 25 janar 2019 u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore (DAIQ). Kjo analizë u hartua nën dritën e njohjes dhe vetëvlerësimit të Kornizës së Matjes së Performancës si dhe analizës SWOT me qëllim evidentimin e fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve që prekin punën audituese brenda Departamentit në veçanti por edhe KLSH-së në përgjithësi. Korniza e Matjes së Performancës konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për menaxhimin, matjen, identifikimin dhe raportimin e performancës së aktivitetit të vet, me qëllim përmirësimet e mëtejshme, për arritjen e objektivave e synuara, si më poshtë vijon:

Për vitin 2018 DAIQ, sipas planit vjetor të auditimeve, të miratuar nga Kryetari KLSH kishte të parashikuar për të kryer 29 auditime, të cilat janë realizuar 100%. Konkretisht: në 13 subjekte janë kryer auditime me objekt përputhshmërinë, në 4 subjekte janë kryer auditime me objekte të përzierë financiare dhe përputhshmërie, në 9 subjekte janë kryer auditime me objekt financiare, në 2 subjekte janë kryer auditive tematike dhe në 2 raste është kryer zbatimit i rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2017 dhe 4 mujorit të parë të vitit 2018.

Bazuar në metodologjinë e riskut dhe materialitetit, me këto 29 auditime janë audituar fonde buxhetore në vlerën totale rreth 34,000,000 mijë lekë, kryesisht: fondet për "Pagat e personelit" zënë rreth 13,300,000 mijë lekë ose 40%; fondet për "Mallra dhe shërbime të tjera" zënë 11,900,000 mijë lekë ose 36%; "Fondet për investime" zënë rreth 4,000,000 mijë lekë ose 12% të totalit të fondeve të audituara; etj.

Në këto auditimi, në zbatim të standardeve të auditimit financiar dhe auditimit të përputhshmërisë, janë audituar pasqyrat financiare dhe përputhshmëria e përdorimit të fondeve publike për të cilat janë dhënë sipas rastit, veçmas opinione për auditimet financiare dhe veçmas opinione për auditimet e përputhshmërisë.

Më pas u vunë në dukje problematikat e konstatuara në auditimet financiare dhe të përputhshmërisë, rekomandimet e lëna për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore, etj.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH dhe objektivat e vitit 2019 mbyllën analizën e këtij Departamenti.

Në datën 25 janar 2019 Departameti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit të Kontrollit të Lartë të Shtetit zhvilloi Analizën e veprimtarisë së vitit 2018. Analiza u zhvillua duke u mbështetur në modelin e vlerësimit të realizimit të objektivave sipas analizës SWOT për arritjen e objektivave strategjik të KLSH 2018-2021, si dhe të objektivave dhe treguesve të planit vjetor 2018 me synimin e rritjes së cilësisë dhe programimit sa më objektiv e premtues të objektivave të vitit 2019. Periudha e veprimtarisë së Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit gjatë vitet 2018 është karakterizuar nga rritja e cilësisë dhe modernizimi i kapaciteteve audituese, tejkalimin i numrit të auditimeve në masën 130%, ka sjellë gjithashtu edhe një standardizim të cilësishëm të programeve të auditimit të mbështetura thellësisht në dy shtyllat kryesore: së pari, në përvetësimin dhe zbatimin cilësor të standardeve të auditimit dhe së dyti në ndjekjen e risqeve të identifikuara më parë, veçanërisht në identifikimin e risqeve të reja gjatë procesit të auditimeve, sintezë dhe produkt ky i forcimit dhe modernizimit të kapaciteteve nga trajnimet, zgjerimi i bashkëpunimit të KLSH me SAI-t e vendeve të Bashkimit Europian, por edhe nga përgjithësimi, shkëmbimi dhe përvetësimi i eksperiencave më të mira brenda vetë stafit të KLSH-së.

Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit për vitin 2018 ka realizuar planin e auditimeve 100%, si dhe ka kryer dhe ka në proces 5 auditime për vitin 2019, duke kryer dhe evaduar 25 auditime, nga këto kemi: 8 auditime në ZVRPP, 7 auditime në ALUIZN-et, 6 auditime në ente mjedisore nga të cilat: (3 auditime ne Drejtori Rajonale Mjedisi, 2 në AKZM dhe AdZM dhe 1 auditim në DR Isnspektoriatit të mjedisit); 1 auditim në AT Pronave Tiranë si dhe 2 auditime Zbatimi i Departamenti ka rekomanduar dhe 6 masa për përmirësim ligjor, ku theksojmë se vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Aluizni-t, 4 masa janë reflektuar plotësisht, duke i shoqëruar ato me ndryshime e plotësime ligjore me VKM, ndërsa në ZVRPP kemi rekomanduar, të cilat janë reflektuar në Ligjin e ri të Kadastrës.

Më tej u evidentuan disa shifra, lidhur me auditimet e realizuara si : 510 masa organizative, 53 masa zhdëmtimi dhe 70 masa disiplinore nga të cilat 40 masa “largim nga puna”, 30 masa “vërejte deri në largim nga puna”, janë kallëzuar penalisht 32 punonjës të këtyre institucioneve përfshi edhe drejtuesit e tyre, si dhe në 2 raste është përcjellë materiali për vlerësim nga prokuroria si indice për kallëzim penal.

Së fundmi u diskutua lidhur me Objektivat e vitit 2019 për këtë Departament.

Analizat vijuan me Departamentet e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, duke u bazuar në këto drejtime:

- Statistikat vjetore;
- Analiza SWOT (fuqive/dobësitë/mundë-sitë/kërcënimet);
- Kërkesat e Instrumentit të matjes së Performancës (PFM).

Pjesëmarrës në këtë analizë, përveç drejtuesve dhe audituesve të departamentit, ishin të pranishëm zv/Kryetar znj. Lindita Milo dhe Drejtori i Përgjithshëm znj. Manjola Naço.

Analiza vjetore filloi me fjalën hyrëse te Drejtorit te Departamentit znj. Yllka Pulashi, e cila vijoi edhe me përmbledhjen e veprimtarisë audituese, duke u përqendruar kryesisht në statistikat vjetore për plotësimin e programit vjetor të auditimit, rezultatet e tyre të shprehura në rekomandime për përmirësime e ndryshime ligjore, masat organizative, ato administrative dhe disiplinore, masat për shpërblimin e dëmit së bashku me vlerën e tyre, rastet dhe numri i kallëzimeve penale. Gjithashtu u paraqit analiza e punës një vjeçare të Departamentit duke u analizuar sipas elementeve të Analizës SWOT (fuqive/dobësitë/mundësitë/ kërcënimet) dhe instrumenteve të Matjes së Performancës.

Gjithashtu znj. Pulashi u ndal edhe në veprimtarinë e audituesve të Departamentit në drejtim të analizës dhe shqyrtimit të kërkesë-ankesave, pjesëmarrje në trajnime, cilësinë e auditimit, prezencën e audituesve në median e shkruar, plani e auditimit për vitin 2019 si dhe objektivat kryesore qe duhet të përmbushen për realizimin e planit dhe të veprimtarisë audituese për vitin 2019.

Në vazhdim fjalën e mori Drejtoresha e Përgjithshme znj. Manjola Naço, e cila ndër të tjera vendosi theksin në objektivat dhe sfidat që na presin në vitin 2019, në veçanti në kryerjen e auditimeve financiare dhe të përputhshmërisë në zbatim të manualeve përkatëse dhe në përgatitjen e letrave të punës sipas manualeve përkatëse, dokumente këto që janë në fazën e konsolidimit. Në fjalën e saj zv/ Kryetare znj. Lindita Milo vuri theksin në kujdesin që duhet të tregojmë në plotësimin e letrave te punës gjatë procesit të auditimit, si dhe ne përmbushjen e objektivave dhe realizimin e auditimeve për vitin 2019 ne frymën e një ekipi të vetëm, duke respektuar rregulloren e Procedurave të Auditimit.

Drejtori i Drejtorisë së Investimeve të Huaja, z. Xhoxhaj në fjalën e tij theksoi angazhimin që duhet të këtë çdo audites në punën e tij, në veçanti audituesit e rinj të cilët duhet të kombinojnë punën me audituesit më me eksperience, duke qenë nën mbikëqyrjen e këtyre të fundit.

Sipas programit vjetor të auditimit për vitin 2018, Departamenti ka pasur si objektiv realizimin dhe përmbushjen e 29 auditimeve gjithsej, 20 auditime në shoqërive publike dhe 9 auditime të projekteve me financime të huaja. Në fund të vitit rezulton se numri i auditimeve të realizuara dhe të evaduara është 28 auditime gjithsej si dhe është përfunduar puna audituese në terren për tre auditime. Auditimet e evaduara i përkasin këtyre fushave: 17 auditime në shoqëritë dhe entet publike, 5 auditime në fushën e projekteve me financime të huaja, 3 auditime mbi zbatimin e rekomandimeve dhe 2 auditime tematike. Auditimet e kryera gjatë vitit 2018 janë kryesisht auditime përputhshmërie, ligjshmërie dhe rregullshmërie, si dhe auditime financiare. Nga auditimet e kryera 10 janë auditime përputhshmërie, 13 janë auditime ligjshmërie dhe rregullshmërie dhe 3 janë auditime financiare dhe dy tematike.

Për auditimet e ushtruara në vitin 2018 i janë drejtuar organit te akuzës 4 kallëzime penale, për 5 drejtues apo administrator të shoqërive dhe 4 indicie për kallëzim penal.

Gjatë vitit 2018 departamentit i janë bashkuar 8 audites të rinj te cilët përtej trajnimeve te ndjekura, janë angazhuar edhe ne auditime nën mbikëqyrjen e auditueve më me përvojë, me qëllim shkëmbimin e eksperiencës por edhe përmbushjen me sa më shumë arritje të auditimeve.

Në përfundim, znj. Yllka Pulashi, prezantoi objektivat kryesore të Departamentit për vitin 2019.

Në datën 31 janar 2019, Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë (DKBMJ) zhvilloi analizën vjetore të punës për vitin 2018. Në analizën e kësaj Drejtorie morën pjesë punonjësit e DKBMJ, Zv/Kryetari i KLSH-së, zj.Lindita Milo (Lati); Sekretari i Përgjithshëm, zj.Luljeta Nano dhe Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në KLSH, z.Artur Hasanbelliu.

Një panoramë të përgjithshme të punës së Drejtorisë e bëri zj.Irena Islami, Drejtore e DKBMJ. Zonja Islami iu referua fillimisht implementimit të "Strategjisë së komunikimit të KLSH-së 2017-2019", nëpërmjet monitorimit të implementimit të kësaj strategjie, i cili është realizuar nga DKBMJ në bashkëpunim me departamentet e auditimit. Plani i Veprimit thekson rolin fondamental të KLSH për të përcjellë më fort dhe qartë mesazhet kryesore të auditimeve dhe të

propozimeve të KLSH-së për përmirësimin e administrimit të Buxhetit të Shtetit në mediat tradicionale, në gazetat dhe revistat kryesore dhe u ndal në rezultatet e monitorimit të implementimit të strategjisë së komunikimit për periudhën raportuese sipas objektivave.

Zonja Islami u përqëndrua në botimet e KLSH-së për vitin 2018 dhe në aktivitetet që lidhen me rritjen e transparencës së veprimtarisë audituese. Gjatë vitit 2018, KLSH ka realizuar 17 botime dhe kolona e botimeve të KLSH-së ka arritur në 100 tituj.



Gjatë shtatë viteve të fundit KLSH ka nënshkruar 57 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 30 me OJF, 17 me institucione homologe dhe të tjerat me institucione shtetërore dhe Universitete Publike.

Një nga aktivitetet që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës ka qenë organizimi nga KLSH i Muajit të Hapur për Qytetarët për të tretin vit radhazi, në datat 25 Tetor-14 Dhjetor 2018. Nisur tre vite më parë si një Jave e Hapur për KLSH, në dy vitet e fundit është kthyer në traditën e Muajit të Hapur për qytetaret mbështetur dhe në Strategjinë e Komunikimit të KLSH 2017-2019. Gjatë muajit të hapur u zhvilluan 54 aktivitete të ndryshme. KLSH gjatë vitit 2018 ka forcuar bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë. Me synimin e institucionalizimit të marrëdhënieve të KLSH me Kuvendin e Shqipërisë , Kryetari i KLSH ka miratuar me shkresën nr. 34/39, datë 30.06.2018 "Udhëzuesin për institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin", dokument i cili përbën një platformë udhërrëfyese për sigurimin e vazhdimësisë së marrëdhënieve të mira midis dy institucioneve.

Për një monitorim sa më efektiv të veprimtarisë së institucioneve kushtetuese Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar në janar 2019 Manualin e monitorimit vjetor dhe periodik të këtyre institucioneve. Gjatë vitit 2018, KLSH ka vijuar traditën e mirë të zhvillimit të Konferencave Shkencore. Konferenca VI-të Shkencore e KLSH-së në bashkëpunim me SAI-n e Kuvajtit, u zhvillua në datat 9-11 prill 2018 në Kuvajt. Konferenca kishte si temë kryesore "Auditimi me Bazë Risku". Në datën 14 dhjetor 2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) organizuan në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit Konferencën Kombëtare me temë: "Për një autoritet Kombëtar anti-korrupsion të gjithëpranuar dhe mirëvendosur në sistemin e qeverisjes".

Më pas e mori fjalën zj.Alma Shehu, e cila u përqendrua në një nga veprimtaritë kryesore të Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, organizimi i aktiviteteve në bashkëpunim me SAI-t dhe institucionet e tjera homologe, brenda dhe jashtë vendit. 138 nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë vitit 2018 morën pjesë në 51 aktivitete të zhvilluara jashtë vendit, si

trajnime, workshope, konferenca, grupe pune të EUROSAI-t dhe INTOSAI-t, internshipe në Gjykatën Europiane të Audituesve dhe fellowship-e në Zyrën e Kontrollorit të Përgjithshëm të GAO-s. Zonja Shehu u shpreh edhe në lidhje me projektin e binjakëzimit, "Forcimi i kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm", i cili u financua nga BE. Gjatë 28 muajve të implementimit të projektit të binjakëzimit janë zhvilluar 99 misione, në të cilat u përfshinë 65 ekspertë polakë, kroatë, holandezë, estonezë dhe portugezë me një numër total 1053 ditë/ njerëz. Në takimet, trajnimet e zhvilluara me ekspertët dhe vizitat studimore u përfshinë rreth 100 drejtues dhe auditues të KLSH dhe për periudhën mars 2016-30 prill 2018 u realizuan 1980 ditë/njerëz (trajnime, misione, auditime pilot, vizita studimore, etj). Në përfundim të diskutimeve, zj.Islami bëri analizën SWOT dhe nga kjo analizë u evidentuan, pikat e forta, pikat e dobëta, oportunitetet dhe kërcënimet. Bazuar në këtë analizë u përcaktuan edhe sfidat për 2019:

Takimin e mbylli zj.Lindita Milo, Zv/Kryetare e KLSH-së, e cila vlerësoi bashkëpunimin e KLSH-së me ECA dhe GAO-n, marrëdhëniet me shoqërinë civile, si edhe konsolidimin e kapaciteteve audituese të institucionit, nëpërmjet vijimit të bashkëpunimit me SAI-t homologe dhe aplikimit për projekte të reja me BE-në, USAID, PNUD, etj.

Në datën 4 shkurt 2019 u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së së Informacionit (DATI). Kjo analizë u hartua nën dritën e njohjes dhe vetëvlerësimit të Kornizës së Matjes së Performancës si dhe analizës SWOT me qëllim evidentimin e fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve që prekin punën audituese brenda Departamentit në veçanti por edhe KLSH-së në përgjithësi. Korniza e Matjes së Performancës konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për menaxhimin, matjen, identifikimin dhe raportimin e performancës së aktivitetit të vetë, me qëllim përmirësimet e mëtejshme, për arritjen e objektivave e synuara.

Auditimin e TI në KLSH mbështetet në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit si dhe Legjislacionin dhe Standartet Shqiptare të fushës.

Gjatë vitit 2018, në bashkëpunim me specialistët e Projektit IPA, Drejtoria e Auditimit TI konsolidoi Manualin Aktiv të TI në gjuhën shqipe. Pas miratimit nga titullari, ky Manual po përdoret në çdo auditim të TI.

Për vitin 2018 DATI, sipas planit vjetor të auditimeve, të miratuar nga Kryetari KLSH kishte parashikuar të kryente 6 auditime, të cilat janë realizuar 100%. Konkretisht: në 6 subjekte janë kryer auditime të sistemeve të teknologjisë së informacionit,

dhe në 1 rast është kryer auditim tematik, në 4 subjekte mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna gjatë vitit 2017 dhe 4 mujorit të parë të vitit 2018.

Në këto auditime janë zbuluar 120 gjetje dhe janë rekomanduar masat respektive për përmirësimin e gjendjes.

Gjatë vitit 2018 vijoi dhe u thellua më tej tendenca e rritjes së numrit të auditimeve dhe e gjetjeve përkatëse, si më poshtë:

Rezultatet e punës audituese u prezantuan në 4 prezantime të vecanta gjatë analizës. Në funksion të dhënies së suportit mbi elemente të Teknologjisë së Informacionit në auditimet financiare e të përputhshmërisë audites të Departamentitsë kanë marë pjesë në 5 auditime të grupeve të departamenteve të tjera.

Gjatë vitit 2018 në përmbushje të objektivit strategjik si dhe rekomandimit të kuvendit, struktura e audititimit të teknologjisë së informacionit në KLSH e përbërë nga 8 audites pësoi ndryshim në dy faza:

- Ndarjen nga Departamenti i Auditimit të Investimeve të Huaja dhe daljen si drejtori në varësi direkte nga Drejtori i Përgjithshëm.
- Krijimin e Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit

Në fund u përcaktuan dhe u diskutuan objektivat e Departamentit të Auditimit TI për vitin 2019.

Po në datën 4 shkurt 2019 u zhvillua analiza vjetore e Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit (DABSH). Në këtë analizë morën pjesë zv. Kryetari, znj. Lindita Lati dhe Drejtoresha e Përgjithshme, znj. Manjola Naço. Drejtori i Departamentit, z. Azmi Stringa mbajti fjalën hapëse ku paraqiti arritjet edhe problematikat kryesore të identifikuara gjatë auditimeve të realizuara gjatë vitit 2018, rekomandimet e lëna dhe shkallën e ndjekjes së tyre.

Për vitin 2018, grupet e auditimit të këtij departamenti kanë ushtruar auditime në 24 subjekte, nga të cilat 23 auditime sipas planit vjetor dhe 1 auditim i trashëguar ne proces nga plani i vitit të mëparshëm. Sipas natyrës së auditimeve, në 10 subjekte janë kryer auditime të përputhshmërisë të aktivitetit, në 4 subjekte janë kryer auditime tematike të përputhshmërisë së aktivitetit, në 8 subjekte janë kryer auditime të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë dhe në 2 subjekte janë kryer auditime të përputhshmërisë dhe financiar të aktivitetit.

Në përfundim të auditimeve, në zbatim të standardeve të auditimit financiar dhe auditimit të përputhshmërisë, pas auditimit të pasqyrave financiare dhe përputhshmërinë e përdorimit të fondeve publike janë dhënë sipas rastit, opinione për auditimet financiare dhe veçmas opinione për auditimet e përputhshmërisë. Gjatë vitit 2018 u vu në fokus dhe realizimi i auditimeve financiare me asistencën e specialistëve të NIK-ut polak, kjo dhe në kuadër të projektit të binjakëzimit i financuar me fondet IPA 2013. Auditimet financiare pilot të zgjedhura ishin subjektet ISSH dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë (aparati). Në MFE opinioni ka

rezultuar i kundërt si për pasqyrat financiare ashtu edhe për përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor; dhe në ISSH opinioni ka rezultuar i kualifikuar për përputhshmërinë dhe refuzim opinioni për pasqyrat financiare. Në total, janë dhënë opinione në 12 auditime, ku bazuar në evidencat e auditimit dhe gjykimin profesional të grupeve të auditimit sipas llojit janë dhënë 4 opinione të kualifikuara, 8 opinione të kundërt, 1 refuzim opinioni dhe 1 opinion i pakualifikuar. Për vitin 2018 në auditimet e kryera janë lënë gjithsej 519 rekomandime për përmirësimin e gjendjes dhe problematikave të konstatuara, krahasuar me 409 rekomandime që ishin dhënë një vit më parë. Për përmirësimin e akteve ligjore dhe nënligjore janë bërë 18 rekomandime, 249 masa organizative, masat për shpërblim dëmi ekonomik të shkaktuara, të konstatuara gjatë auditimeve të vitit 2018 janë në shumën 2,287,634 mijë lekë, 14 masa administrative, 138 masa disiplinore dhe masat për eliminimin e efekteve negative të shkaktuara, të konstatuara gjatë auditimeve të vitit 2018 janë në shumën159,805,535 mijë lekë, dhe 2 indicie për kallëzim penal.

DABSH është përgjegjës për përgatitjen e raportit "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2017", ku për herë të parë është formuluar dhe opinioni i pavarur i KLSH bazuar në standardet ndërkombëtare të auditimit. Në përfundim të auditimit, rezultoi se për disa zëra buxhetorë, përfshirë nivelin e deficitit dhe borxhit publik, për shkak të rëndësisë dhe përhapjes së çështjeve të përmendura në këtë raport, ka devijime materiale (sasiore dhe cilësore) në drejtim të hartimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit jo në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Procesi i ekzekutimit të buxhetit të shtetit nëpërmjet sistemit të thesarit nga të gjitha hallkat, rezulton me thyerje të përhapura të zbatimit të kontrolleve dhe masave parandaluese, detektuese, dhe korrigjuese që do të garantonin disiplinimin fiskal të sektorit publik. Procesi i buxhetimit, rishikimit, ekzekutimit, monitorimit dhe raportimit të tij rezulton të jetë akomodues dhe legjitimues ndaj shkeljeve të disiplinës fiskale nga entet publike, duke mundësuar marrjen e angazhimeve financiare pa fonde në dispozicion si dhe krijimin e detyrimeve të prapambetura. Detyrimet e prapambetura dhe stoku në rritje i rimbursimit të TVSH nuk reflektohen në treguesit e konsoliduar fiskal, treguesin e deficitit, dhe treguesin e borxhit publik, duke mos dhënë një pamje të drejtë të aktivitetit financiar publik për vitin 2017. KLSH ka konstatuar që shumë nga masat dhe përmirësimet e akteve ligjore dhe nënligjore të hartuara me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura, eliminimin e mundësive për mos raportimin në kohë të shpenzimeve, dhe marrjen e angazhimeve

financiare pa fonde buxhetore, në bashkëpunim dhe me FMN, kanë rezultuar joefikase dhe të pazbatuara. Masat administrative për disiplinimin e menaxhimit financiar publik, të përcaktuara në ligj, kanë qenë në disproporcion me numrin e shkeljeve të kryera nga entet publike.

Në vijim, takimin e përshëndeti zv. Kryetari, znj. Lindita Lati, ku theksoi rëndësinë dhe kontributin e DABSH në përmbushjen e misionit të KLSH gjatë vitit 2018 dhe në vijim. Drejtori Përgjithshëm, Zj. Manjola Naço, në fjalën e saj tha që viti 2018 ka qenë një vit, në të cilin standardi i punës është rritur ndjeshëm dhe si rrjedhojë kjo përbën një sfidë për vitin 2019 duke e vënë DABSH përpara përgjegjësisë për të ruajtur minimalisht të njëjtin standard pune dhe rezultatesh. Për të bërë të mundur këtë, duhet një angazhim maksimal i audituesve të Departamentit, ku secili të kontribuojë me rezultate dhe jo të bazohemi në punën e një grupi të vogël audituesish.

Më pas analiza vjetore vijoj me prezantimin nga audituesit e disa prej auditimeve kryesore të kryera nga DABSH gjatë vitit 2018.

Gjatë analizës u diskutuan dhe objektivat për të vitin 2019, që duhet të jenë në vëmendje të çdo audituesi të këtij departamenti.

Në datën 4 shkurt 2019, Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore zhvilloi analizën vjetore të punës për vitin 2018, referuar aktivitetit auditues të Departamentit për këtë periudhë. Në analizë morën pjesë Zv/Kryetarja e KLSH-së, znj. Lindita Milo dhe Drejtori i Përgjithshëm, znj. Manjola Naço.

Në analizën e Departamentit u pasqyrua realizimi i planit të vitit 2018, gjetjet nga auditimet dhe u përcaktuan objektivat për vitin 2019. Gjithashtu, u pasqyrua se eksperienca e fituar dhe zhvillimet institucionale kanë konfirmuar se procesi i modernizimit të institucionit të auditimit të jashtëm publik kontribuon për një qeverisje efektive dhe është një vlerë e shtuar në sistemin e institucioneve publike.

Gjatë vitit 2018 me Vendimin e Kryetarit KLSH ishin planifikuar 32 auditime, ndërsa janë realizuar dhe evaduar 39 auditime, pra 7 auditime mbi planin vjetor. Ku 12 auditime "Financiare dhe të Përputhshmërisë" (i kombinuar); 18 auditime "Mbi të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare"; 6 auditime "Përputhshmërie; 3 auditime Tematike.

Janë rekomanduar 496 masa organizative dhe 591 masa disiplinore dhe administrative nga të cilat 187 masa disiplinore për punonjës që janë pjesë e shërbimit civil (me status nëpunësi civil), 159 masa për punonjës për të cilët

marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e punës dhe 245 masa administrative, prej të cilave në 20 subjekte janë rekomanduar 141 masa administrative në kompetencë të APP, e cila ndaj tyre ka vendosur gjoba në vlerën 18,790,000 lekë.

Masa me dëm ekonomik, si dhe për të ardhurat e munguara ose shpenzimet jo në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit janë në shumën 15,342 milion lekë, nga të cilat shuma 719,239 mijë lekë i përket dëmit ekonomik dhe shuma 14,077 milion lekë të ardhura të munguara dhe shpenzime jo në përputhje me 3-E.

Gjatë vitit 2018 në bashkëpunim me Departamentin Juridik janë përgatitur dhe dërguar në organin e prokurorisë 8 kallëzime penale, për 36 persona, 8 Indice për kallëzim penal dhe 1 vlerësim për kallëzim penal.

Gjatë analizës u identifikuan edhe objektivat për të ardhmen, të cilat janë në një linjë me objektivat e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2018-2022, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me pritshmërinë e larta të qytetarëve, në forcimin e kapaciteteve audituese dhe të metodologjisë së auditimit që është faktor kyç në nxitjen e përdorimit me efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet të fondeve publike, për një qeverisje të mirë, nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike.

KLSH merr pjesë në worshopin e zhvilluar mbi "kontributi social dhe transparenca e auditimeve ne sektorin publik"

Në datat 7 dhe 8 shkurt 2019, u zhvillua në Budapest të Hungarisë një workshop me fokus mbi rolin e shoqërisë në veprimtarinë e SAI-t dhe transparencën e auditimeve në sektorin publik, ku u angazhuan përfaqësuesit e shtatë institucioneve të auditimit shtetëror evropian. Qëllimi i anëtarëve të grupit të projektit ishte që tëkontribuojnë dhe bëjnë aktivitetin e tyre të dobishëm për shoqërinë sa më shumë që të jetë e mundur, për të ndarë praktikat e tyre të mira përkatëse me njëri-tjetrin dhe për të zhvilluar kapacitetet e tyre në këtë fushë në mënyrë inovative. KLSH mori pjesë në worshopin e zhvilluar mbi "kontributi social dhe transparenca e auditimeve ne sektorin publik", si pjesë e Grupit Ndërkombëtar te Projektit të EUROSAI-t.

Këto seminar profesionale përshëndeti Presidenti i SAO, z. László Domokos dhe ekspertët e SAI-ve mbajtën prezantimet profesionale për praktikat e tyre të mira në kontributin social. Pjesëmarrës dhe kontribues në këtë panel ishte dhe Kontrolli i Lartë të Shtetit, ku në rastin studimor të prezantuar u konsideruan të rëndësishme aspekte të tilla si, organizimi i muajit të hapur ku qytetarët informohen mbi aktivitetin e KLSH, kontributi i audituesve të KLSH me shkrime mbi auditimin publik në shtypin e përditshëm, niveli i zbatimit te rekomandimeve nga angazhimet, prezenca ne mediat e shkruara dhe elektronike e gjetjeve dhe rekomandimeve te KLSH, vlerësimi i

ankesave dhe kërkesave të qytetarëve, sondazhet dhe matja e perceptimit publik mbi rolin e SAI në mirëqeverisje, konferencat shkencore ndërkombëtare dhe përthithja e mendimit te akademikeve dhe botes universitare, etj. Rasti i studimit i prezantuar u ndoq me shume interesim dhe me pyetje te shumta nga pjesëmarrësit ne panel.

Ky seminar ishte në vijim të proceseve të filluara në vitin 2017, ku Kongresi i 10-të i Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) miratoi Planin e ri Strategjik 2017-2023 të EUROSAI. Një element kryesor i këtij plani është rritja e kapacitetit të reagimit ndaj sfidave dhe mundësive të reja, si dhe mbështetja në zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve audituese. Duke shprehur angazhimin e saj, Zyra e Auditimit te Hungarisë SAO-ja krijoi grupin e projektit të kontributit shoqëror për të përmbushur këtë objektiv, i cili buron nga standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI 12, ISSAI 20), duke synuar përdorimin e mjeteve të ndryshme, dhe duke kërkuar përgjigjen ndaj pyetjes se çfarë mjetesh objektive mund të përdoren për të monitoruar rolin shoqëror të auditimeve të financave publike në nivelet e shfrytëzimit.

Një nga objektivat kryesore të projektit është të zhvillohet një udhëzues praktik i zbatueshëm në praktikë për institucionet e auditimit shtetëror të vendeve anëtare të EUROSAI, bazuar në metodologjinë uniforme ndërkombëtare mbi shfrytëzimin shoqëror të auditimeve shtetërore (financave publike). Prandaj, gjate dy ditëve te seminarit u diskutua dhe u punua per redaktimin e ketij udhëzuesi ndërkombëtar, i përpiluar nga anëtarët e grupit të projektit.

Pjesëmarrësit diskutuan dhe kaluan çdo kapitull të këtij manuali, duke futur modifikimet dhe plotësimet e kërkuara. Sapo të përfundojë puna e redaktimit, dokumenti i përmirësuar dhe i finalizuar do te publikohet. Gjatë punës së bashku, anëtarët e grupit u përgjigjën në 75 pyetje kryesore dhe gjate workshopit pjesëmarrësit diskutuan mbi rastet e institucioneve të tyre të auditimit shtetëror.

